

REVISTË SHKENCËRE DHE KULTURORE

Zani i Naltë

Themeluar më 1923 - Viti II (XVI) - Nr. 5 (158) ISSN: 2305-655X

SHKENCË ISLAME | SOCIOLOGJ | PSIKOLOGJ | LETËRSI | HISTORI | MORAL | LITERATURË KOMBËTARE



90 vjet
"Zani i Naltë"



NUMRI
ISSUE **5** 2013

Botues:
Komuniteti Mysliman i Shqipërisë

Zani i Naltë

Revistë shkencore dhe kulturore

VITI II (XVI) 2013 NR. 5 (158)

Merret me shkenca islame, sociologji, filozofi, psikologji,
histori, gjuhësi, letërsi, moral dhe literaturë kombëtare

www.kmsh.al
www.zaninalte.al

Tiranë 2013

Revistë shkencore dhe kulturore

Zani i Naltë

Organ i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë

Themeluar në tetor 1923

Rifilluar në tetor 2012 VITI II (XVI), tetor, nëntor, dhjetor 2013, nr. 5 (158)

Nën kujdesin: H. Selim Muça

Kryeredaktor & Drejtor: Dok. Genti Kruja

Bordi editorial: H. Bujar Spahiu
M.A. Ali Zaimi
Dr. Ferdinand Gjana
Prof. Dr. Qazim Qazimi
Prof. Dr. Ayhan Tekines
Prof. Dr. Njazi Kazazi
Prof. Dr. Hajri Shehu
Dr. Bayram Karci
Dok. Ramadan Çipuri
Dok. Skender Bruçaj
M.A. Dorian Demetja
M.A. Elton Karaj

Redaktor: M.A. Andrin Rasha

Fushat: Shkencat Islame
Tefsir
Hadith
Fikh
Sociologji
Filozofi
Gjuhësi
Letërsi
Psikologji
Histori
Kulturë
Art, etj.

Realizimi grafik: Bledar Xama
Shpëtim Bashmili

Fotoja në kopertinë: Xhamia e Ballijes, Elbasan

**KOMUNITETI MYSLIMAN
I SHQIPËRISË:**

**Rr. George W. Bush, Nr. 50,
Tiranë - Shqipëri
mail: info@zaninalte.al**



**web: www.kmsh.al
www.zaninalte.al**

Përmbajtja

Me rastin e 90 vjetorit të themelimit të revistës “ZANI I NALTË”

1. Tematika e revistës “Zani i Naltë” (1923-1939)
- (Ali Musa Basha).....5
2. Zani i Naltë” për problemet e edukimit
- Prof. Dr. Vehbi Hoti - Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër.....14

Studime

3. Feja në syrin e një intelektual
- Prof. Dr. Bedri Bylyku, Tiranë.....20
4. Roli i ulemasë në rrjedhat shoqërore politike të periudhës së shpalljes së pavarësisë - Prof. As. Dr. Fahrush Rexhepi
- Fakulteti Studimeve Islame - Prishtinë.....29
5. Me e nda mendjen, o atlet i Krishtit, o hero kombëtar!
- M.S. Fatos Koplaku - Universiteti i Michiganit, Ann Arbor, SHBA.....35

Shkenca Islame

6. Shkronjat e Kur’anit dhe shqiptimi i tyre - 1 -
- M.A. Elton Karaj - Universiteti Bedër, Tiranë.....50
7. ISLAMI SI FE E MËSHIRËS UNIVERSALE -
- Muhammed Fet’hullah Gylen.....60

Sociologji

8. Dhuna në familje: Një fenomen paralizues për familjen dhe shoqërinë shqiptare
- Dok. Ana Uka (Bulku) - Universiteti BEDËR, Tiranë.....64
9. ...vizitoni të sëmurët, ...
- Ilir Akshija, M.D., M.Sc. - Spitali Univ. “Nënë Tereza”, Tiranë.....72

Gjuhë-Letërsi

10. Gjuha shqipe dhe shtetformimi në veprat e dijetarëve islam
- Doc. Dr. Ismet Osmani
- Universiteti “Shën Çirili dhe Metodi”, Shkup.....81

Histori

11. Institucionet fetare gjatë mbretërimit të Ahmet Zogut:

Një vështrim të legjislacionit të kohës (1928-1939)

- **Prof. Dr. Valentina Duka - Universiteti i Tiranës**.....85

12. Mbi rishkrimin dhe rishikimin e historisë së Shqipërisë:

- **Nuredin Nazarko, Korçë**.....92

Personalitete

13 Hafëz Ibrahim Dalliu dhe kontributi i tij në fushën e jurisprudencës islame
(Me vështrim të veçantë në veprën: “LIBRI I SË FALMES”)

- **H. Resul Rexhepi - Bashkësia Islame e Kosovës, Prishtinë**.....102

14. H. Ibrahim Dalliu një nga 100 personalitetet shqiptare të kulturës islame.....109

Abstracts in English

15. Abstraktet në anglisht.....113



Me rastin e 90 vjetorit të revistës “ZANI I NALTË”

Tematika e revistës “Zani i Naltë” - 1923-1939

(Ali Musa Basha)

Abstrakt

Shekulli i XX-të konsiderohet si fillimi i rregullt i periodikut islam shqiptar. Atë e gjejmë të gjallojë që me krijimin e shtetit shqiptar dhe mund të konsiderohet se mori fizionominë e u institucionalizua me formimin e Komunitetit Mysliman Shqiptar. Këtij komuniteti qysh me themelimin e tij, duke vënë nën vartësi institucione arsimore e fetare, nga njëra anë, dhe duke u gjendur para kërkesave të grupeve të intelektualëve, si dhe të teologëve myslimanë nga ana tjetër, krabas botimit të literaturës fetare, që shërbente për kualifikimin e kuadrit fetar, iu bë domosdoshmëri botimi i një organi të mirëfilltë fetar, që do të bëhej tribuna e mendimit islam shqiptar dhe epiqendra e shtypit mysliman jo vetëm në Shqipëri, por sidomos për vitet e para, edhe në vende të tjera ku gjendeshin myslimanë shqiptarë. Kjo domosdoshmëri u kthye në detyrë imediate me vendimet e Kongresit të Parë Mysliman, të mbajtur në shkurtin e vitit 1923 dhe kështu, në tetor të po atij viti doli nr. 1 i revistës “Zani i Naltë”, e cila vazhdoi deri në fillim të vitit 1939, pra rreth 16 vjet.

Është vendi të përmendim se “Zani i Naltë” nuk ka qenë periodiku i parë islam në gjuhën shqipe. Fill pas Shpalljes së Pavarësisë, në vitin 1913 në Shkodër u botua gazeta “Sedai Milet” (Zëri i Kombit), që dilte pjesërisht në gjuhën shqipe dhe pjesërisht në turqisht, por me kalimin e kohës kjo gjendje ishte tejkaluar. Tani ishin rritur shumë edhe kërkesat në drejtim të përmbajtjes së këtij lloji shtypi, sigurisht, duke u bazuar në ndjenjën fetaro-atdhetare, duhej bërë përjashtimi i gjuhëve të huaja në botim, pra tani duhej jo vetëm botim më cilësor,

por edhe vetëm shqip. Qenë këto nga shkaqet kryesore, që botuesi e mbylli vetë këtë gazetë që në 1914. Gjithashtu, duhet të pohojmë se myslimanët e Vaterbarysë të SHBA nxorën nëpërmjet shoqërisë fetare islame të kësaj qendre revistën fetare “Shqipëria”, që qarkulloi vetëm 1 numër dhe nuk vazhdoi më. Në këtë revistë gjejmë artikuj ku qysh në atë kohë spikat se shqiptarët e mërguar në Amerikë i ruajnë të pacenuara jo vetëm ndjenjat e zakonet kombëtare, por edhe ato fetare. Po kështu, gjejmë artikuj vlerësues për Kur’anin dhe rolin e tij në shoqërinë njerëzore.

Një gazetë tjetër islame në gjuhën shqipe, që filloi në këto kohë qe titulluar “Reforma” dhe doli në Gjirokastrë, në tetor 1921 dhe vazhdoi të dalë deri në vitin 1923. Gazeta “Reforma” ka qenë organ dyjavor, por edhe kjo nuk ka pasur jetë të gjatë. Përveç lëndës fetare, aty u botuan edhe artikuj me karakter letrar, shoqëror dhe politik, duke u bërë kështu edhe tribunë për një numër të konsiderueshëm intelektualësh. Përveç temave me karakter fetar si dhe të atyre që trajtonin me dashamirësi problemet e tarikateve, ajo trajtoi me tolerancë edhe problemin e konsolidimit të shoqërisë shqiptare. Nga gazeta “Reforma” gjatë periudhës 1921–1923 u botuan vetëm 8 numra.

Është rastësi, por në tetor të 1923, kur Komuniteti Mysliman në Tiranë filloi të botojë “Zanin e Naltë”, në Shkodër u botua “Udha e s’vërtetës”, kryeredaktor i së cilës qe i mirënjohuri Hoxha Kadri Prishtina, kryetar i Komitetit për Mbrojtjen e Kosovës. Qysh në numrin e parë kryeredaktori paraqiti në mënyrë koncize programin e revistës, ku përmbledheshin: mësim i parimeve të thjeshta të fesë islame për t’i shpëtuar njerëzit nga shkatërrimi i plotë; për të ngjallë në zemrat e tyre ndjenjat e bashkimit; për të jetuar tok në shoqërinë bashkëkohore. Gjithashtu aty kërkohej që të aktivizoheshin të gjithë dijetarët shqiptarë për t’iu bërë gjymtyrë të dobishme jetës kombëtare e shoqërore, se kështu, – theksohej në atë program, – do t’i japim një impuls zhvillimit mendor të të gjithë popullit. Aty nuk lihej pa përmendur se problemet do të shtriheshin edhe në fushë të filozofisë, sociologjisë e politikës. Edhe kjo revistë nuk pati jetë të gjatë, ajo doli vetëm 3 numra.

Ndërsa gjithçka që u botua para “Zanit të Naltë” dhe në kohën e daljes së tij, patën jetë të shkurtër, kjo nuk ndodhi me revistë të cilën e kemi bërë objekt e po flasim. Qysh në numrin e parë kjo revistë, nëpërmjet programit që shpall, ia bën të qartë lexuesit të vet qëllimin: 1) *Me bashkue në një trup të vetëm, të fortë e të qëndrueshëm popullin musliman shqiptar;* 2) *Me përmirësue gjendjen e vakufëve, të xhamiave, të mesxhideve, të medreseve, të teqeve e të institucioneve të tjera të muslimanizmit;* 3) *Me i zbulue popullit musliman shqiptar të vërtetat e besimit në një mënyrë të thjeshtë e të pandërlueme, duka ia ngrosun zemrën me dashnin për këtë të vërtetë;* 4) *Sipas Statutit me plotësue vllaznimit ndërmjet të gjithë elementëve në Shqipëri dhe* 5) *Me këto mjete, mandej me forcue edhe themelet e një politike thjesht kombëtare në shtetin tonë.* Edhe sot po të themelohej në vendin tonë ndonjë revistë që të kishte këtë qëllim, mendoj se nuk do dilej jashtë këtij kuadri programor.

Për të zbatuar programin e shpallur, revista grumbulloi rreth vetes një staf bashkëpunëtorësh të kualifikuar, jo vetëm për problemet e çështjet fetare, por edhe për ato kombëtare e ndërmjet tyre mund të përmendim Hafiz Ali Korçën, Mehdi e Mit’hat Frashërin (Lumo Skëndon), Nebil Çikën e të tjerë dhe ky grup bashkëpunëtorësh erdhi gjithnjë duke u forcuar e freskuar, duke aktivizuar nga teologët, por edhe nga intelektualët më të përmendur të kohës. Meritë e redaksisë së kësaj reviste, duke filluar që nga drejtori i saj i parë, Ismail Maçi nga Tiranë, e në vazhdim Hafiz Isa Domni nga Shkodra, Shyqyri Myftiu nga Peqini (vetëm për pak kohë) e Haki Sharofi nga

Dibra, nuk është se u aktivizuan vetë për të shkruar apo përkthyer artikuj të rëndësishëm teologjikë e me përmbajtje morali atdhetar, përkundrazi, ata pak u dalluan në këtë drejtim, por meritë, ata kanë se përcaktuan temat kryesore, që do të rriheshin në faqet e saj dhe për këto tema zgjodhën dhe u lanë dorë të lirë njerëzve nga më kompetentët e kohës, të cilët temat i trajtuan me një origjinalitet, thjeshtësi e logjikë të mahnitshme. Gjithashtu ata kanë meritë për debatet e diskutimet që lejuan në revistën e tyre, si për çështjet fetare, por edhe për ato kombëtare. Ata, duke vënë në jetë programin e revistës, nuk qëndruan asnjëherë indiferentë për gjithçka ndodhte në vendin tonë, pra si për çështjet fetare, ashtu dhe për ato politike, morale, shoqërore etj. Po kështu, redaksia ua kishte lënë derën të hapur edhe të rinjve myslimanë që herë pas here provonin penat e tyre dhe qysh në numrin 2 të revistës shohim të botuar një poezi përshëndetëse nga i riu i asaj kohe, z. Ramadan Dema. Nuk duhet lënë pa përmendur se bashkëpunëtorët e revistës nuk ishin vetëm nga Tirana, ata sipas aftësive e cilësive që posedonin, kishin edhe një përhapje gjeografike nga i gjithë vendi.

Është më se e natyrshme që, si revistë fetare që ishte, të trajtonte, në radhë të parë, probleme të një spektri të gjerë, të cilat kishin lidhje me fenë në përgjithësi e me atë islame në veçanti, por, sigurish, pa lënë pas dore çështje të tjera që ishin në programin e saj.

Dihet se nga veçantitë e fesë islame është edhe parimi i qenies së saj e përhershme dhe e përgjithshme, pra për çdo kohë e për çdo vend dhe, me këto

dy veti që ka Islami, është e natyrshme që mësimet e tij janë të vlefshme përgjithmonë dhe për çdo vend. Duke e parë në këtë prizëm, shumë lehtë mund të arrijmë në përfundim se gjithçka është botuar në të, sidomos në lidhje me fenë islame e me moralin, që ajo predikon është e vlefshme në çdo kohë, por ne në rastin e temës sonë, nuk kemi pasur parasysh vetëm këto veti. Në artikujt e botuar në të gjejmë komente të Kur'anit, hadithe të Hz. Muhamedit (a.s.), ngjarje të rëndësishme nga historia islame e të tjerë shkrime të këtyllë të përafërt, karakteristikë e të cilave është se në të gjitha rastet çështjet jo vetëm që trajtohen me kompetencat e teologëve të pjekur, por ato kanë arritur një pikë shpjegimi logjik që, pavarësisht nga niveli i intelektit të atij që i studion, po të niset me bon sens, jo vetëm që do të vlerësojë patjetër punën e bërë, por e ka të vështirë të gjejë pjesë që duhen hequr apo, që duhen redaktuar shkencërisht. Kështu, p.sh., Hafiz Ali Korça, bashkëpunëtor shumë aktiv, boton në disa numra me radhë komente nga sure të ndryshme të Kur'anit. Komentimet që ai i ka bërë Kur'anit në atë kohë, janë konsideruar të vlefshme edhe në kohët e mëvonshme deri në ditët e sotme.

Sikurse e përmendëm, revista aktivizoi kuadrot më të njohur të fesë islame, përfshirë në ta edhe pjesëtarë përfaqësues të tarikateve të ndryshme të islamit, të cilët në “Zanin e Naltë” gjenin tribunën ku shpallnin e mbronin publikisht mendimet e idetë e tarikateve që përfaqësonin. Ndër ta gjejmë pena të baballarëve bektashinj, shehlerëve kadirinj, rrufai, halvetij, tixhanij e të tjerë, me një fjalë nga teologët e intelektualët

më në zë të këtyre tarikateve në vendin tonë, siç qenë p.sh. Ferit Vokopola, sheh Muharrem Mitrovica e të tjerë me radhë.

Këtu vlen të përmendet debati, që u zhvillua në vitin 1937–1938 e që u botua i plotë në “Zanin e Naltë” nga klerikët e lartë bektashinj, si të ndjerët Selman Xhemal, Baba Ali Myrteza Kruja, Musa Qazim Baba nga Psalla e Thesalisë në Greqi e të tjerë ndaj revistës “Drita”, që kishte botuar një artikull të përkthyer ku pretendohet se bektashizmi jo vetëm nuk konsiderohet sekt i Islamit, por edhe mësimet e tij pretendoheshin se janë katërçipërisht kundra fesë Islame. Edhe sikur këtë debat të vetëm të marrim si shembull, do të arrijmë në përfundimin se tematika e “Zanit të Naltë” është aktuale edhe pse ngjarjet historike kanë linjën, apo spiralen e vet të përsëritjes. A nuk po pretendohet edhe sot e njëjta gjë nga njerëz që s’dinë se ç’është as Islami e as Bektashizmi?

Tematika e trajtuar në këtë revistë, e konsideruar edhe tani si bashkëkohore, mund të ndahet në tri grupe, sigurisht kjo lloj ndarjeje, megjithëse subjektive, bëhet për të parashtruar më drejt temat e trajtuara në këtë revistë:

1. Në të do të gjejmë artikuj të mirëfilltë fetarë të cilët në çdo numër zinin vendin kryesor. Në këtë grup do të futnim edhe rubrikat e rregullta, që ishin si një llogaridhënie e Komunitetit para besimtarëve myslimanë, e që bënin fjalë për të ardhurat e shpenzimet, si dhe për gjendjen e vakufëve të Shqipërisë, të dhëna me detaje për çdo rreth. Kjo tregon edhe se drejtuesit e atyre kohëve të Komuniteti Mysliman kanë komunikuar sidomos me popullin.

2. Në revistë do të gjejmë artikuj

që kultivojnë atdhedashurinë, të bazuar në fe, por të aktualizuar me gjendjen që kalonte vendi ynë në atë kohë. Pra një lloj përgjigjeje e mbajtjeje përgjegjësi për situatën e vendit tonë.

3. Artikuj moralë e shoqërorë. Këta lloj artikujsh kishin lidhje me trajtimin, që u bënte feja çështjeve të moralit dhe të shoqërisë, si dhe gjëra të ndryshme, si kritika, informacione nga bota etj.

Tani le t’i shohim një nga një këto grupe duke i ilustruar:

1) Është e natyrshme që në çdo revistë fetare vendin kryesor do ta zënë artikujt fetarë. Duke pasur parasysh se parimet bazë të fesë islame, të nxjerra nga Kur’ani e tradita profetike e Hz. Muhamedit (a.s.), si dhe nga historia islame, nuk kanë lëvizur që kur janë shpallur para 1400 vjetësh, sikurse e cekëm më parë, arrihet në përfundimin logjik se ato shkrime janë të vlefshme në çdo kohë. Këtu duhet pasur parasysh se niveli cilësor i çdo shkrimi, apo predikimi duhet përgatitur e analizuar në lidhje me nivelin e lexuesit që i drejtohet. Ndryshe mund të diskutosh me një intelektual, ndryshe me një qytetar të thjeshtë, e ndryshe me një fshatar, ose student dhe ndryshe do ta ndërtosh debatin me një afetar. Të para në këtë prizëm shkrimet për të cilat po flasim, mund të redaktohen në përshtatje me qëllimin tonë, por në asnjë mënyrë duke ndryshuar parimet, të cilat vetëm mund të pasurohen me argumente të reja. Sot p.sh. kanë shumë aktualë artikujt, apo predikimet e Hafiz Ismet Dibrës, të përmbledhur në kolonën: “A ka dyshim në qenien e Zotit?”, që kanë vazhduar në disa numra të “Zanit të Naltë”, sepse sot, sikurse dhe në kohën kur

është shkruar ky material a mbajtur ky predikim, është përsëri çështje kryesore e parimore diskutimi, që bëhet ndërmjet idealistëve e materialistëve, apo më mirë ndërmjet teistëve e ateistëve për ekzistencën e Zotit. Sigurisht për trajtimin e një teme të tillë argumente variojnë nga më të thjeshtat, që sillen për popullin deri tek ata më bashkëkohoret, të cilat kombinohen edhe me mendimet e shkencëtarëve e të filozofëve të shquar idealistë. Në kohën kur janë bërë këto predikime, aty nga mesi i viteve 30-të, patën filluar të depërtojnë me vrull në vendin tonë idetë ateiste, sikurse qenë bërë të modës në mbarë Evropën.

Po kështu mund të themi edhe për Haxhi Vehbi Dibrën, i njohur si komentatori më kompetent, që ka nxjerrë vendi ynë, kolos i mendimit islam shqiptar, se komentimet e interpretimet, që ai i ka bërë Kur'anit, janë me të vërtetë të paimagjinueshme. Mjafton të themi se vetëm për kuptimin e sures "Fatiha", e mbiquajtura "Hapja" apo "Çelja", sepse është kaptina e parë me të cilën fillon Kur'ani dhe ka vetëm 6 fjali me 4-5 radhë gjithsej, ka dhënë shpjegime rreth 150 faqe të botuara në "Zanin e Naltë" dhe që i ka ribotuar të përmbledhura në libër të veçantë Imam Vehbi Ismaili në Nju Jork.

Në "Zanin e Naltë" gjenden edhe shumë artikuj të tjerë që dëshmojnë për një thesar të paçmueshëm kulturor, nëpërmjet të cilit vihet në dukje niveli i mendimit teologjik shqiptar gjatë periudhës së Pavarësisë. Pra, në këtë fushë në "Zanin e Naltë" janë botuar një tufë artikujsh perla, të hartuar nga hoxhallarët-teologë shqiptarë nga më të përgatiturit që njohim deri sot. Punë të

mirë për ruajtjen e një pjese të tyre, ka bërë Imam Vehbi Ismaili i cili, pasi i ka nxjerrë nga "Zani i Naltë", i ka ribotuar në libra të veçantë, duke u dhënë bashkatdhetarëve të vet mësimë shumë të larta të Islamit. Njëkohësisht nuk duhet lënë pa vënë në dukje edhe puna voluminoze cilësore e Haki Sharofit, i cili një pjesë të madhe të tyre i ka bërë të botueshme me asistencën e tij në predikimet që kanë bërë autorët, me shënimet që ka mbajtur dhe me botimin e tyre si reporter në revistë. Sidoqoftë në këtë drejtim ka ende shumë për t'u thënë nga ana e studiuesve, sidomos, për t'u bërë nga ana e Komunitetit Mysliman për t'i rivënë edhe njëherë në dorë të besimtarëve myslimanë këto materiale të çmuara. Në ato shkrime është mendimi më i kualifikuar i një brezi teologësh e specialistësh nga më të aftit, mendimet e të cilëve tashmë janë bërë pjesë përbërëse e kulturës kombëtare islame. Teologët e asaj kohe, krahas gjuhëve orientale e studimeve të thella teologjike që zotëronin, ishin marrë dhe kishin arritur rezultate edhe në studimin e filozofëve të Greqisë së lashtë, prandaj në studimet e tyre, krahas argumentimeve kur'anore dhe të traditës profetike, duke cituar autorët më të njohur gjatë shekujve të botës islame, në trajtimin e temave që zbërthenin fushin edhe logjikën. Prandaj edhe sot, çdo lexuesi që i bie në dorë rastësisht ndonjë numër i saj, e lexon me ëndje e kënaqësi të madhe. Si mund të lihen mënjanë nga ana e studiuesve, por edhe e besimtarëve teza të tilla si: "Mbi trupin dhe shpirtin", të cilat tek këta teologë kolosë gjejnë shpjegime e interpretime të arsyeshme në kuadrin etik dhe të filozofisë islame?

Kështu kemi predikime interesante si “Njeriu dhe feja”, “Kozmografia tej kaosit”, “Pavdekësia e njeriut”, “Njeriu dhe gjithësia”, “Edukata moderne” etj., etj, shkrime, predikime, ndonjëherë edhe ndonjë përkthim, të mbajtura nga të paharruarit H. Ali Korça, sheh Qazim Hoxha e të tjerë. Prandaj me të drejtë në këtë revistë mbrohet teza se “Zani i Naltë” është e vetmja fletore që përkrah e përhap filozofinë e fesë islame, sepse landa e saj është thelbi i Kur’anit, palsa e hadithit, dhe ajka e fjalëve të zotënive të mëdhenj”.

Me themelimin e Komunitetit Mysliman Shqiptar, dolën në pah edhe një sërë problemesh që në një formë a në një tjetër kishin lidhje me të ardhmen e këtij Komuniteti, pra kishin lidhje me reformat që duheshin bërë. Për këtë revista hapi një rubrikë të veçantë ku përfshiheshin diskutimet dhe polemika për problemet që shqetësonin besimtarët në atë kohë. Të tilla ishin problemet sfiduese emergjente që duheshin zgjidhur me kompetencë e largpamësi. Ndër këto probleme ishte ai i arsimimit dhe i edukimit laik e fetar, i mësimit të fesë në shkollat shtetërore, i statusit të gruas shqiptare në shoqëri etj.

Po përmendim, sa për ilustrim, vetëm njërin ndër këto probleme që u diskutua në atë kohë dhe që pasqyrohen në faqet e “Zanit të Naltë”, ku morën pjesë aktive shumë klerikë dhe dhanë mendime të vlefshme, pra është fjala për organizimin e rrjetit arsimor. Deri në atë kohë kishte një numër të pakufizuar medresesh, që as kontrolloheshin e as ndihmoheshin dot, nuk kishin programe dhe gjithçka aplikoheshin sipas metodave të dikurshme, subjektive që

tashmë ishin tejkaluar. Ndër teologët e shquar, që mori pjesë në këtë debat ka qenë dhe ish-senatori Sali Vuçiterni, i cili ishte i mendimit për ta riorganizuar këtë arsim mbi baza centralizmi, duke themeluar Medresenë e Përgjithshme në Tiranë. Me këtë mendim ai ndeshë në rezistencën e disave, ku për më tepër, vazhdimësinë e gjendjes së trashëguar e mbronin me këmbëngulje, sepse u prekeshin interesat e veta. Kjo ishte një nga sfidat që shtrohej atëherë para Komunitetit e që u zgjidh me sukses.

2) Artikujt që kultivojnë atdhedashurinë i gjejmë më vete, por edhe të gërshtuara me mësimet e Islamit. Kështu, qysh ndër numrat e parë, janar 1924, Hafiz Ali Korça replikën me shkrimet e kohës se, *Ç’është nacionalizma*, sa për ilustrim po sjellim një shembull nga shkrimi me titull *“Muslimanizma dhe nasionalizma”* se si zhvillohej polemika:

Nacionalistët... shqiptarë, s’qenkan fetarë, aspak atdhetarë. Të tjerët i konsiderojnë nacionalistët të pafë.

*Dimi e vatani dy binjakë janë
Që të dy një rrënjë dhe një burim kanë
Ç’derd ka për atdhenë, kush ka flakur fenë?!*

*Përditë vagabondi e ndërron këmbenë
Nacionalist jam unë, por fetar si duhet
Le të thotë bota ashtu si t’i thubet.*

Mjafton të përmendim se si mësues të atdhedashurisë në “Zanin e Naltë” militonin firma të mirënjohura për atdhedashurinë e tyre, siç ishin Mehdi e Mit’hat Frashëri. Por, njëkohësisht ata ishin të njohur edhe për mendimet, që shfaqnin në faqet e revistës në lidhje me çështje të tjera si p.sh. me respektin

që duhet të tregohet ndaj fesë. Kështu Mit'hat Frashëri ka shkruar: “Një fe lartësohet, nderohet dhe respektohet me lartësi, me nderim dhe me respektin që ka ai popull për vetvete”.

Sot në vendin tonë është problem mbarëkombëtar çështja e refugjatëve. Edhe në atë kohë kjo temë ka zënë vend të rëndësishëm në faqet e kësaj reviste, e trajtuar me mjeshtëri nga intelektualët, kolosët e njohur të patriotizmit, të kulturës e të mendimit shqiptar që u cituan më lart.

Por këtë temë në poezi e ka trajtuar me ngrohtësi e mallëngjim edhe H. Ali Korça, me rastin e bombardimit që serbët i bënë Drenicës ditën e Bajramit (Vini re: Drenica në ato kohë, Drenica sot - në 1999¹) në “Vajtimit e atdheut” e shoqëruar me refrenin “Qani vëllezër Kosovën, qani / Për gjëmëzëzën ca ditë zi mbani! / Ja disa nga vargjet e spikatura të kësaj poezie:

*Qytetërimi ku është, vallë?
Përse Europa nuk iu sheh hallë?!
Si s'po dëgjohet topi i shkrretë?!
Si s'shibet flaka që del mbi retë?!
Si nuk dëgjohet rënkimi i shpirtit
... Kjo politikë racë mbaruese
Përditë grin plaka, pleq, trima, nuse
Kjo politikë lugate, shtrigë
Dhe për dinake kuçedër e ligë...*

A nuk ka nota aktualiteti kjo poezi?

Revista u bë boshti kryesor i përhapjes së dijeve dhe i mendimeve islame. Diapazoni i tematikës që ajo trajtoi ka qenë i gjerë. Në të u rrahën çështje doktrinare, të atdhedashurisë, të politikës së kohës, çështje sociale, kulturore, ekonomike etj., etj.

1. Viti 1999, shënim i redaksisë.

Ajo që në numrat e parë e shtroi drejt, nevojën për një kulturë islame me karakteristika e tradita shqiptare me një qëllim të vetëm: “Që vendi ynë të mos binte në grackën e organizimit të mbrapshtë të shoqërisë moderne e të mos bëhej pre e kësaj shoqërie”, por nuk mund të lihet pa u evidentuar edhe domosdoshmëria e ecjes së vendit tonë me kohët moderne dhe kjo konsiderohej si pjesë përbërëse e Islamit, i cili gjithmonë është në evoluim pozitiv dhe për këtë revista i referohej Kur'anit të shenjtë se rruga e dijes së shëndoshë duhej kërkuar me çdo mjet, por duke pasur kujdes anët negative të zhvillimit, se “ne jemi vend evropian dhe si i tillë duhet të marrim nga qytetërimi botëror gjithçka të mirë dhe të lëmë gjithçka të keqe”.

Në faqet e revistës gjejmë mendime të tilla, p.sh.: “Qytetërimi i vërtetë formohet prej vetive të qëruara e ndjenjave të larta si dhe të shpirtbardhësisë ... Ne mjeshtritë duhet t'i ndryshojmë, por shpirtin, moralin e zakonet e mira duhet t'i ruajmë si më mirë, se çdo popull që mundohet të ndërrojë shpirtin e moralin, vdes përjetë dhe për këtë historia na sjell shembuj të shumtë”.

Në revistë gjejmë tema shkencore të vulgarizuara ku shpjegohet se zënia e diellit dhe e hënës nuk kanë të bëjnë me fenë dhe, për më tepër, këto fenomene shpjegohen të bazuara edhe në mësimet e fesë islame. Nuk duhet lënë pa përmendur se atdhedashuria mësohet edhe në bazë të predikimeve të mirëfillta fetare, siç janë p.sh. hutbet apo predikimet e ditëve të premtë. Të tilla, për tema të rëndësishme shoqërore

ka shumë dhe të përgatitura shumë mirë, të gatshme për t'u përdorur nga predikuesit e rretheve të ndryshme të vendit. Në këtë drejtim herë pas here në revistë botoheshin udhëzime e programe të detajuara për imamët apo predikuesit e rretheve.

Për situatën që po i përgatitej botës edhe revista "Zani i Naltë" nuk ka qëndruar indiferente duke botuar shkrime si "Komunizma dhe feja", apo njoftimet për aktet e dhunshme, që po ushtroheshin në ato kohë kundër fesë në Bashkimin Sovjetik. Por nuk lihen jashtë tematikës edhe "Fashistët dhe farmasonët". Njëkohësisht tregon se ç'bëhet me fenë në përgjithësi në botë, kështu p.sh. mësojmë se kleri ortodoks grek qysh në vitin 1924, për t'i dalë përpara të papriturave, ka kërkuar që mësuesit e shkollave laike, pavarësisht nga lënda që do të jepnin në shkollë, duhet të ishin vetë patjetër besimtarë.

3) Artikuj për çështje morale e shoqërore. Në këto lloj artikujsh përfshiheshin mësimet morale sipas fesë islame, por edhe çështje të tjera shoqërore që shfaqeshin në vendin tonë, të para po me syrin e predikimeve islame. gjithashtu, këtu inkludohen edhe rubrika të shpeshta me të dhëna historike rreth së kaluarës së vendit tonë, rreth përhapjes së Islamit tek ne, rreth problemeve të kësaj feje nëpër botë. Të gjitha këto e të tjera botoheshin për të edukuar besimtarët myslimanë me moralin e saj, sipas motos të gjithë myslimanët janë vëllezër. Në këtë prizëm duhet parë edhe informacioni që jepet për mbi një miliard myslimanë, që atëherë jetonin në botë. Ka shkrime për luftërat e tyre çlirimtare, siç ishin në atë kohë lufta, që zhvillohej në Indi

kundër kolonizatorëve etj., etj. Këto lloj informacionesh siguroheshin nga lajmet, që vilesnin e përktheheshin nga shtypi i kohës.

Qysh në vitin 1926 Lumo Skëndo, nëpërmjet artikullit "Një lutje këndonjësvë", u kërkon besimtarëve myslimanë, që të ndihmojnë revistën duke dorëzuar shkrime, përfshirë ilahi, vjersha, ngjarje të mbajtura shënim etj., të cilat mund të gjenden nëpër biblioteka personale, apo nëpër xhamia, teqe, tyrbe etj., se të gjitha këto lloj shkrimesh kanë rëndësi të madhe, prandaj në radhë të parë të kujdesemi, që të mos humbin se "janë pjesë e historisë dhe kulturës së popullit tonë". Po të njëjtën gjë bën më vonë edhe H. Sharofi, i cili, pasi njofton lexuesit e revistës për zbulimin e Mevludit të Hafiz Ali Rizait në Shkodër, i shkruar me alfabet osman, kërkon ndihmën e tyre që të ndihmojnë në këtë drejtim për zbulimin e materialeve të tjera me vlerë të kësaj kategorie, që mund t'i kenë nëpër shtëpi etj.

Në këtë rubrikë do të futeshin edhe mendimet e shprehura për zhvillimin e qytetërimit islam, përhapjen e tij dhe shkrime të tjera të cilat venë në dukje rëndësinë e demokracisë sipas fesë islame. Këto ilustrohen me shembuj të qytetërimit islam dhe sidomos të shprehjes së demokracisë nga periudha e Hazreti Muhamedit (a.s.), Hz. Omerit, Hz. Aliut, Imam Jusufit, Omer Abdul Azizit etj., etj. Të gjitha këto lloj shkrimesh kishin për qëllim që të formonin njëllloj fronti apo barrikade kundër ideve komuniste, që gradualisht po depërtonin edhe në Shqipëri.

Nuk duhet lënë pa përmendur se

krahas evidentimit të tolerancës islame, në revistën “Zani i Naltë” u botuan edhe replika të detyruara, kur shtypi i konfesioneve të tjera bënte sulme direkte ndaj Islamit. Kështu mund të përmendim “Një replikë të detyruar” ndaj “Hyllit të Dritës”, që kishte përkthyer e botuar një shkrim në të cilin sulmohej Kur’ani. Po në këtë kuadër mund të përmendim një shkrim kritik nga H. Ali Kraja (rreth 40 faqesh) për një “Histori Islame” të përkthyer nga italishtja prej Hysejn Xhahid Beut. Në këtë shkrim kritik Hafiz Ali Kraja mban qëndrim ndaj shpifjeve e sajimeve të autorit të këtij libri.

Po në këtë ndarje mund të përsihen edhe artikuj të ndryshëm, morali i të cilëve del sapo i lexon. Kështu mund të përmendim artikulli “Me qa e me qeshe”. Në të autori H. Ali Korça, bën aluzion për prishjen e gjuhës shqipe si rezultat i përdorimit vend e pavend të fjalëve të huaja. Ndër të tjera ai shkruan se në një letër prej 40 radhësh që kishte marrë, vetëm një fjalë kishte gjetur shqip, ndërsa të tjerat ishin frëngjisht, latinisht, anglisht, gjermanisht, greqisht dhe sllavisht, disa turqisht, 2 arabisht dhe vetëm 1 fjalë persisht. Këtu autori shpreh edhe tendencën e atyre që huazonin vend e pavend fjalë të huaja, sidomos nga Perëndimi dhe se nga cilat vende i huazonin. Në fund të artikullit pyet: “Po Samiu e Naimi a nuk dinin gjuhë e fjalë të huaja?!”

Edhe Lumo Skëndoja me shkrimet e veta thumbon njerëzit që krijojnë shqetësime në shoqërinë e kohës. Kështu mund të përmendim tek shkrimi “Edep, jahu”, shqetësimet që sillnin në atë kohë në tregun e Tiranës njerëzit që frekuentonin pijetoret.

Gjithçka që paraqita në këtë material është konstatuar me një sy që mund të hedhësh revistës “Zani i Naltë”. Por duke u nisur se kjo revistë pati për bashkëpunëtorë njerëz shumë të kualifikuar në lëmin e teologjisë e të moralit të fesë islame, vepra e të cilëve pati rezultate të mëdha në edukimin fetar në atë kohë, njëkohësisht shërbeu për rrënjosjen e ndjenjave atdhetare e kulturore ndër lexuesit e saj, shpjegoi e zhvilloi më tej moralin e qytetërimit islam dhe ndihmoi me të gjitha shkrimet e veta në qytetërimin e vendit, nga njëra anë dhe gjendjen e sotme të vendit tonë, kur sulmet ndaj doktrinës islame janë ngritur në potencë, nga brenda e nga jashtë, kur ndihet shumë mungesa e kuadrove të kualifikuar e me përvojë të fesë islame, jam i mendimit se në këtë revistë mund të zgjidhen e të nxirren shkrime, sikurse bëhet me ribotime librash të mirë dhe këto shkrime po të ribotoheshin herë pas here, do të bënin të njëjtin shërbim që kanë bërë kur janë botuar për herë që parë dhe prej tyre do të përfitonin, sidomos besimtarët e rinj që janë të etur për këtë lloj literature.²

2. Artikull i botuar në gazetën “Drita Islame”, nr. 23 (154), dhjetor 1998, fq. 1 dhe 4 me rastin e 75 vjetorit të themelimit të revistës “Zani i Naltë”. Zoti e mëshiroftë autorin z. Ali Bashën.

“Zani i Naltë” për problemet e edukimit

Prof. Dr. Vehbi Hoti
Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër

Abstrakt

“Zani i Naltë” duke qenë edhe revistë fetare që merrej edhe me filozofi, moral, literaturë kombëtare dhe sociologji ajo e tëra, si të thuash këmbë e krye, i përkushtohet problemeve të edukimit.

Fillimisht, e pakët në faqe, e ngushtë në tematikë dhe e ngushtë në trajtimin e problemeve, gradualisht, sidomos në vitet '30, revista konsolidohet, përvijon disa rubrika të qëndrueshme duke trajtuar problemet më themelore të besimit islam, të filozofisë së kohës dhe të edukimit e të formimit të njeriut.

Në mjaft artikuj e rubrika si në ato: “Ç’urdhëron Kur’ani” dhe “Thelbi i Kur’anit”, “Mesazhet e Hazreti Muhametit”, dhe “Si lindi islamizmi”, “Drita e Perëndisë dhe filozofia” dhe “Idealizmi e materializmi” etj., trajtohen problemet themelore të edukimit fetar dhe parimet e përgjithshme të edukimit e të formimit të njeriut.

Në të tjera si: “Arsimi dhe koha” dhe “Faqja e fëmijëve”, “Ç’është e vërteta” dhe “Si ndryshon mentaliteti”, “Ç’duhet të bajmë” dhe “Për shkencën”, “Njeriu dhe gjithësia” dhe “Ç’është skepticizmi, pesimizmi e ateizmi”, “Rregulla për të nxanë” dhe “Rregulla për t’u sjellë mirë” etj., trajtohen problemet specifike të edukimit dhe të komponentëve të veçantë të tij, të faktorëve, të metodave e të mjeteve të edukimit dhe të rolit të diturisë në përparimin e njerëzimit etj.

Duke trajtuar problemet filozofike teologjike e morale, mësimore e edukative, revista shpreh synimin e

saj për ta bashkuar popullin tonë në rrugë të qytetërimit me popujt e tjerë që me kohë kanë zhvilluar pavarësinë e vetëqeverimitin e vet.

Për këtë ajo merr para lexuesve angazhimin e madh qytetar se do të këmbëngulë në ngritjen e rindërtimin e **“disa institucioneve ma me rëndësi të shtetit, si fjala vjen Drejtësia dhe Arsimi, tue i dhanë këtyre një trajtë perëndimore”**.

Me qartësi parashtrohen parimet edukative me vlera mbarënjerëzore dhe gjithëkohore, parime universale të zhvillimit, të edukimit dhe të vetedukimit me synimin themelor për ta bërë shqiptarin një njeri, në kuptimin e plotë të fjalës.



Si shtylla themelore të këtij zhvillimi trajtohen rrënjosja e besimit tek Zoti dhe lufta këmbëngulëse për përvetësimin e diturisë.

Vlerësimi i diturisë, i të mësuarit dhe i shkollës frymëzohet nga porosia e Pejgamberit, Muhametid (a.s.): *“Kërkojeni diturinë nga djepi deri në varr”*.

Mbi këtë bazë të mësuarit dhe përvetësimi i diturisë trajtohen si detyra të domosdoshme për çdo mysliman dhe myslimane. Dituria konsiderohet si një faktor me peshë të veçantë në përsosjen shpirtërore të njeriut dhe në përgatitjen jetësore të tij. Dituria, - shkruan revista - është drita e shpirtit që zhduk injorancën dhe e ngre lart njeriun, është dhuratë e të diturit e armë kundër armikut. Ajo rregullon mendjen, ndreq sjelljen dhe forcon fenë. Zotërimi i diturisë vlerësohet si një kapital i madh për njeriun, madje një kapital i lehtë në të mbajtur por i rëndë në vlefte, kapital që përherë sjell fitim e kurrë nuk

preket nga krizat, e nuk rrezikohet prej kusarësh.

Zotërimi i këtij kapitali të veçantë nuk trajtohet si një qëllim më vete, për smirë e karrierë, por si një armë për ta vënë në shërbim të popullit e të shoqërisë, përparimit të vendit e të mbarë e të mbarë njerëzisë.

Me këtë frymë e me këtë këndvështrim të diturisë e të rolit të saj në jetën individuale, shoqërore e shtetërore, trajtohen, në disa numra të revistës, rregullat për punën e shkollës e të nxënësve, u parashtrohet kërkesa këmbëngulëse: *“Këndoni, shkruani, mësoni”*. Një vend të gjerë në revistë zënë problemet e edukatës morale.

Kërkohet zbatimi i një kodi të tërë rregullash e normash morale, të edukatës qytetare e të sjelljes së kulturuar. Morali e parimet morale që trajtohen përfshijnë të gjitha sferat e jetës, ato e shoqërojnë njeriun në shtëpi, në shkollë, në rrugë e gjer në varr. Njëpërmjet tyre synohet

t'i hapet rruga së mirës e të ndalet nga e keqja, synohet që myslimani të jetë shembull i gjallë i ndershmërisë dhe i përsosjes, shembull në plotësimin e zotimeve të marra dhe në kryerjen e detyrave të tij, të jetë i ndershëm dhe i drejtë, bujar dhe i mëshirshëm, të luftojë besëtytnitë e fanatizmit, gënjeshtren, bixhozin dhe alkoolin.

Gjerësisht trajtohen rregullat e sjelljes së kulturës në familje, me farefisën, me fqinjët, në shkollë, me të rriturit etj. Duke u mbështetur në porosinë e Profetit, këshillohet që njerëzit të përpiqen me përfitim nga pesë gjëra: *me përfituar nga jeta para se të vijë vdekja, me përfituar nga shëndeti para se ta kapë sëmundja, me përfituar nga koha e lirë para se ajo të ketë humbur, me përfituar nga rinia para se të vijë pleqëria dhe nga pasuria para se të vijë varfëria*. Por gjithnjë me ndershmëri dhe drejtësi.

Me mjaft interes është rubrika “Këshillat e filozofëve”, ku parashtrohet një kod i tërë edukativ e moral që përfshin tërë aspektet e jetës si p.sh. për ruajtjen dhe respektimin e pronës: “Mos prek aty ku nuk ke vue”, “Mos mbjell pemë në tokën e huaj”; për gjetjen e vlerësimit e së vërtetës: “Çdo e mirë vjen prej së vërtetës”, “Njihe të vërtetën prej kujdo që e dëgjon”, “Thuaj përherë të vërtetën”; për vlerësimin e mësimin e të diturisë: “Kërko dijen sado larg që të jetë”, “Mos të kesh turp me mësuar” dhe “Mos e kalo jetën në padituri”, “Është i madh ai që di me çmue diturinë”; për rregullat e normat e jetës së përditshme: “Përgatitu për pleqëri kur je i ri”, “Punët e dimrit mos lër për verë”, “Mos fol çka s’di dhe mos puno ç’ka s’je i zoti”, “Mos u bashko me ato që nuk dinë me çmuar

vetveten”, “Mos u gëzo për të keqen e tjetrit” etj., etj. Një vlerësim i veçantë i bëhet rolit të mësuesit dhe të edukatorit. Puna e tyre cilësohet si një mjeshtri e shenjtë. Në këtë funksion një vend të veçantë u rezervohet predikuesve, ulemave dhe dijetarëve të cilët konsiderohen si “mjekë të sëmundjeve morale e shoqërore”.

Për të kaluar nga errësira në dritë e në kulturë, për t’u pajisur me virtyte të larta dhe për të gdhendur shpirtin shtrohet si domosdoshmëri përfitimi nga këshillat e ndihma e ulemave dhe e dijetarëve. “Ashtu si një shi i butë, - shkruan revista – që ban që lulet e pemët të kënelen me një bukuri të posaçme, ashtu dhe fjalët e një predikuesi lëmojnë, mbushin me gëzim e me fllad shpirtin e një njeriu. Dalëngadalë zgjohen tek ai fuqitë mendore dhe veset e këqija fillojnë me zhdok gjurmët e shëmtueme prej shpirtit të tij”. Gjerësisht zberthen detyrat e predikuesve për të ndriçuar mendjen e popullit me dituri, për t’i mësuar atij parimet e sakta të fesë dhe për t’i dhënë një edukatë të shëndoshë qytetare dhe shoqërore.

Revista e ka një angazhim konstant në fushën e edukimit patriotik, në formimin e ndërgjegjes kombëtare, në bashkimin dhe vëllazërimin e popullit tonë. Kredon e vet patriotike redaksia e shpalli haptazi para lexuesve të vet duke theksuar se: “Na të Zanit të Nalt kemi le shqiptarë, jemi rritur shqiptarë dhe do të vdesim shqiptarë”.

Feja islame dhe edukimi i njerëzve me frymën e saj trajtohen të lidhura ngushtë me ndjenjat kombëtare, me frymën atdhetare dhe përgjegjësinë qytetare për të punuar për zhvillimin e

përparimin e kombit shqiptar. Në një sërë artikujsh theksohet se nga mësimet kur'anore dhe mesazhet e Pejgamberit (a.s.): “Del detyra që na shtrëngon të përpiqemi për të mbrojtur kombësinë tonë. Nëse do të mohojmë kombësinë tonë, jemi përgjegjës sepse rrëzojmë një qëllim që ka caktuar vetë Perëndia. Po ta mohojmë kombësinë dëftojmë se nuk duam të na njofi bota... Mohimi i kombësisë bahet tue mohue zakonet e mira kombëtare, që formojnë cilësitë karakteristike të shqiptarit”.

Disa intelektualë ateistë në vitet '30 shpallën alternativën “O Fe, o Atdhe” dhe shkruanin se në qoftë se e duam Shqipërinë, duhet t'i japim shqelmin fesë. Revista i konsideron këto mendime trillime, “me plot gojën gënjeshtër”, propagandë komuniste e bolshevike dhe duke treguar një tolerancë shembullore, u bënë thirrje të gjithëve për të bashkëpunuar për përparimin e naltësimin e atdheut sepse, “Po të punojmë për komb e shtet – me vullnet të fortë e pa u mërzitë, me zemër të pastër e me ndërgjegje të kullueme, të jemi të sigurt se ndihmën dhe përkrahjen e Perëndisë do ta kemi me vete dhe do ta jetojmë të lumtur, sado që jemi një popull i vogël, mjafton që të veprojmë me rregull, ndërgjegje e energji”.

Është kjo frymë atdhetare, që në raste festash kombëtare e shtetërore, revista lëshonte lutjen: “O Zot i madhnueshëm për hatër të Kur'anit e të Resul'ullahut, përparojë atdheun tonë në çdo pikëpamje e sidomos në dituri” dhe në festat kryesore të besimtarëve myslimanë uronte që “Perëndia e vërtetë dhashtë që mot për mot i kremtofsim këto ditë të shenjta edhe ma me gëzim

të atdheut tonë të dashtun nën hijen e flamurit kombëtar e nën drejtimin atnuer të Naltmadhnisë së Tij, Zogu I, Mbret i shqiptarëve”.

Duke komentuar porosinë kur'anore se të gjithë njerëzit janë të barabartë dhe vëllezër ndaj njëri tjetrit, në shumë artikuj i kushtohet vëmendje e veçantë sigurimit të unitetit kombëtar, bashkimit e vëllazërimit të gjithë shqiptarëve pa dallim feje. Revista shpall se **“Në pikëpamje kombëtare nuk kanë kuptim fjalët musliman e kristian. Të gjithë janë vëllazën”**. Dhe se **“Islami urdhëron vëllaznim me bashkëkombësit joislamë”**. Argumentohet me shembuj e fakte nga realiteti historik shqiptar, se feja ka qenë një mjet i bashkimit të elementëve të ndryshëm, që përbëjnë kombin dhe se ajo përfaqëson një institut që përpiqet ta lartësojë njeriun në të gjitha pikëpamjet.

Qëndrimi ndaj atdheut dhe edukimi patriotik trajtohen në një plan të gjerë politik, shoqëror, moral dhe ekonomik.

Ndër kërkesat më themelore morale dhe fetare që shtrohen para çdo njeriu është ruajtja e amaneteve, si gjëra që nuk ka të drejtë kurrkush t'i cenojë apo t'i tjetërsojë. Në krye të këtyre amaneteve vendosen atdheu, feja e qytetërimi.

“Atdheu – shkruan revista – ashtë amanet në dorën tonë, na e kanë lanë të parët për ta ruajtur e për me ua dorëzuar fëmijëve tanë”.

Për ta ruajtur atdheun jepen shumë këshilla e porosi. Para së gjithave shtrohet detyra për të njohur armiqtë e atdheut dhe për t'u ruajtur nga rreziku i tyre.

Rrezikshmëri për atdheun paraqesin si armiqtë e jashtëm, ashtu

edhe ato të brendshëm. Theksohet se armiqtë e jashtëm janë në shesh, duken e shihen, se janë të gjithë ato shtete që presin rastin me cynue të drejtën e kombit shqiptar, të gjithë ato që me vepra e propagandë pengojnë zhvillimin politik dhe ekonomik të kombit tonë e përgatisin dekadencën tonë kombëtare.

Siarmiqtë brendshëm konsiderohen të gjithë ato që vihen në shërbim të të huajve e pengojnë interesat kombëtare, që tradhtojnë ligjet e shtetit, që thithin gjakun e vëllezërve me spekulime, që shkaktojnë grindje e përçarje në mes vëllezërve bashkëkombës, që cenojnë lirinë e nderin e tjetrit, ata që nuk kanë dhimbje e mëshirë për të varfrit, ata që përmes karrierës së tyre nuk përpiqen për përparimin publik. Si detyrë e madhe patriotike shtrohet rritja e prodhimit dhe e mirëqenies, shtimi i kapitalit të përgjithshëm kombëtar. Theksohet se çdo komb në botë ka shkëlqyer kur ka qenë i pasur dhe kur ka siguruar nevojat e veta, kur ka normalizuar e ekuilibruar deficitin tregtar se “Kombet që fitojnë gjashtë dhe prishin shtatë shpejt a vonë janë vorfnue”.

Këto amanete në radhë të parë amaneti i atdheut shihen si ndër detyrat kryesore për t’iu transmetuar brezit të ri nga tërë sistemi i edukimit sidomos nga familja në punën edukative me fëmijët e vet.

Një vend me shumë rëndësi në revistë zë problemi i familjes dhe i rolit të saj edukativ i detyrave dhe i përgjegjësisë të saj në çdo fushë. Kësaj i kushtohen shumë artikuj, veçanërisht rubrikat “Ç’duhet të bajmë”, “Edukatë morale”, “Këshillat e filozofëve” etj.

Në këto rubrika e artikuj zërthehen mësimet kur’anore për familjen, baza ekonomike, shoqërore e shpirtërore e krijimit të saj, kushtet e jetesës e të harmonisë bashkëshortore dhe marrëdhëniet e ndërsjella prindër fëmijë. “Lumturia e një shteti – shkruan revista – bazohet në lumturinë e familjeve dhe lumturia e familjes mbështetet në harmoninë e pjesëtarëve të saj”.

Gjerësisht trajtohet roli i nënës si edukatore e natyrshme e fëmijës duke u mbështetur në fjalët vërtet profetike të Pejgamberit, Muhamedit (a.s.) se, “Xheneti është nën këmbët e nënave”.

Me të drejtë theksohet se edukimi i fëmijës fillon që në barkun e nënës, se ai është pasqyra e saj, se nëna është ajo, që do të vendosi gurin e parë të edukatës së fëmijës, e pastaj do t’ia dorëzojë shkollës dhe shoqërisë për të ngritur ndërtesën edukative.

Nga nëna kërkohet që t’i japë fëmijës bazat e para të formimit të një trupi të shëndoshë, të një mendje të hollë dhe të një karakteri të fortë. “Nana – shkruan revista – duhet me i dhanë e me siguruar atdheut e mbretit ushtarë besnikë, të fortë, të shëndoshë e të fuqishëm”.

Artikujt që trajtojnë problemet e edukatës familjare dallohen për qartësi e kompetencë pedagogjike, për njohje të saktë të nivelit të familjes shqiptare, të mangësive, të dobësive si dhe të nevojave të saj, për përcaktimin e drejtë të detyrave të prindërve, e sidomos të nënës në edukimin e fëmijëve dhe të marrëdhënies reciproke.

Dashuria prindërore trajtohet si një nga ndjenjat më të pastra e më të

thella njerëzore, që nuk mbështetet në interes por buron nga zemra e shpirti, dashuri që e shoqëron njeriun gjithë jetën, se fëmija dhe kur plaket e bëhet gati të vdesë ofshan “O nanë”. Mësimet e nënës mbeten tërë jetën, ato formojnë një pjesë të karakterit të fëmijës. Me humanizmin dhe përkushtimin e saj, me të folurit e saj të ëmbël, ajo do t’i mësojë fëmijës të mirën dhe të keqen, do t’i forcojë shpirtin dhe vullnetin, do t’i ngjallë shpresën dhe dashurinë, do t’i rrënjosë guximin dhe kurajën.

Duke parashtruar këto qëllime të edukatës familjare shtrohet detyra për ta ngritur nënën shqiptare në nivelin e plotësimit të saj me kompetencë dhe cilësi. Me të drejtë pohohet se nënat përpiqen shumë por arrijnë pak.

Arsyeja kryesore qëndronte në faktin se nënat kishin shumë të meta, boshllëqe e mangësi në realizimin e misionit të tyre fisnik edukativ. Dhe jo për fajin e tyre por sepse shumë pak kujdes ishte treguar në radhë të parë për arsimimin edhe edukimin e tyre.

Në këtë kuadër, revista bën përpjekje serioze për të evidentuar të metat e mangësitë dhe për të përcaktuar rrugët e kapërcimit të tyre.

Këto të meta e dobësi shihen në nivelin tepër të ulët arsimor e kulturor të gruas shqiptare, në mungesën e theksuar të njohurive higjieno-sanitare e mjekësore, në ndikimet e mëdha të fanatizmit e të konservatorizmit, të patriarkalizmit e të tutelës në jetën dhe edukatën familjare, në mungesën e njohurive mbi ekonominë shtëpiake dhe miradministrimin e saj. Jeta e mbyllur shtëpiake dhe mungesa e mjeteve më elementare për dëfrimin dhe kulturimin

bënin që nënat shqiptare ta kalonin kohën kot, ta vrasin atë me biseda tërkuzë e të panevojshme.

Për të dalë nga kjo situatë, sugjerohet e rekomandohet marrja e një sërë masash. Para së gjithave shtrohet kërkesa për të rritur shkallën e arsimimit të femrës shqiptare për tu mësuar nënave shqiptare mësim e këndim, llogari dhe ekonomi shtëpiake. Kërkohej organizimi i punës për t’i pajisur nënat me bazat fillestare të kulturës pedagogjike dhe me një rreth njohurish higjieno-sanitare e profilaksie mjekësore. Shtrohet nevoja e luftës kundër praktikave të gabuara edukative të një mase të gjerë të nënave, të mbështetura në paragjykimet dhe në konceptet mbi “Syrin e keq”, xhindët, lugetërit dhe figura të tjera..

Për të gjitha këto probleme revista paraqet një tematikë të gjerë për biseda, kurse, seminare e konferenca, që i sheh si të domosdoshme për t’u organizuar me nënat, duke kërkuar angazhimin e specialistëve më të mirë e më të përgatitur të të gjitha fushave. Mbi këtë bazë i bëhet thirrje Komunitetit Mysliman për të hartuar një program të gjerë e serioz pune në mënyrë që t’i jepet një drejtim i sigurt përgatitjes dhe edukimit të gruas myslimane.

Nga sa arritëm të parashtrojmë sfera e problemeve edukative, që ka trajtuar revista “Zani i Naltë” është tepër e gjerë. E gjithë kjo problematikë ka synuar në vënien në jetë të porosive kur’anore, e para të cilave është: edukoni dhe gjithnjë e përherë edukoni.¹

1. Artikull i botuar në gazetën “Drita Islame”, nr. 23 (154), dhjetor 1998, fq. 2 dhe 4.

Feja në syrin e një intelektual

Prof. Dr. Bedri Bylyku

Abstrakt

Njeriu intelektual nuk është përcaktuar për të qenë vetëm specialist ose master në punën e tij, por është krijuar i përsosur dhe me udhëheqje për të zgjidhur problemet e kësaj bote kaotike, kryesisht në vendin e tij, duke filluar nga familja, fisi, krabina dhe atdheu ku është lindur dhe do shuhet.

Por njeriu, në kohën e sotme, aktualisht, në shumicën dërrmuese është i okupuar me vetveten dhe për të ardhmen e tij. Për këtë qëllim ai i nënshtrohet obligimeve shoqërore në kuadër të solidaritetit të bashkësisë. Eksperienca konfirmon se me kalimin e kohës ky njeri transformohet në narcis të vetmuar.

Njeriu modern përjetoi dy parime liberaliste, si individualizmin dhe pluralizmin, që u përfshinë natyrshëm në ndërtimin e idesë religjioze. Secili që dëshiron të analizojë ndodhitë ose ngjarjet fetare do të përplasat me një katrahurë të autoritarizmit dhe individualizmit brenda pluralitetit si religjioz, ashtu dhe fraksioneve dhe grupimeve. Sot, për këtë arsye, religjioni në shumë raste është bërë maska e qëndrimeve dhe lëvizjeve jo religjioze. Lëvizjet jo religjioze janë të larmishme. Po ashtu të dhënat shkencore dhe teknologjia nga njëra anë, ato mitologjike tradicionale nga ana tjetër, ja humbën ndjesinë dhe aktualitetin kohor dhe hapësinor, sepse religjioni mund të kuptohet vetëm nëpërmjet religjiozes dhe religjionit, pra subjekti dhe objekti duhet të jenë religjioze, që do të thotë se subjekti duhet ta përjetojë fetaren. Subjekti që nuk është fetar e vret ose e mbyt objektin religjioz të cilin e hulumton.

Diskutimet apologjetike dhe juridike të fesë, janë bërë disiplina që përjetohej sot si përkujtime. Atëherë a duhet njohur esenca e religjionit dhe pse, a, kemi nevojë?

Religjioni ose feja nuk është dije abstrakte, përkundrazi është koncept konkret dhe organik i jetës personale dhe botës përreth. Tradita e Islamit, fenë ose religjionin e konsideron si dhuratë hyjnore. Është mbinatyrore për shkak se burimin e ka në Zotin, është mirëqenëse për shkak se vjen si rezultat i mëshirës

hyjnore, që ka për qëllim vendosjen e aleancës me njeriun si krijesë me intelekt, e vetme e krijesës hyjnore; është i lirë për shkak se buron prej lirisë së pakufishme të Zotit dhe është jo e huazuar sepse nuk jepet me qëllim që të kthehet, por me butësi të ngjall besnikërinë, mirësinë dhe dashurinë ndaj Zotit, pra njeriu që pranon para Zotit fenë e Tij

karakterizohet nga nënshtrimi absolut ndaj Zotit të madhëruar. Feja i nevojitet njeriut, që ai të zbulojë konceptin e qenësisë personale dhe të historisë botërore, që të mund të ndërlidhë konceptin personal me atë të rendit botëror.

Unë mendoj, -thotë Dostojevski-, se nëpërmjet fesë, nëpërmjet njohjes (gnosis-it) do të mundësohet zbulimi i sekretit të personit tim, do të më bëhet e qartë kush jam unë, prej nga kam ardhur; shpresoj se do të arrij ta kuptoj misterin e botës, me të cilin unë jam lidhur në një mënyrë të drejtpërdrejtë por të pakuptueshme për mua. Nëse nuk e kuptoj dot rendin dhe sistemin ekzistencial të botës, atëherë prezenca ime do të jetë pa kuptim, e dëshpëruar dhe nuk do ta di se për çfarë arsye jetoj.

Vlerësimi për religjionin do të thotë që subjekti të cilit i komunikohet shpallja, sipas Dostojevskit, është një klithmë që diku me zë e diku pa zë dëgjohe në të gjitha traditat fetare. Që nga humanizmi dhe renesanca, fetarët jetojnë brenda një shkëputje vullkanore ndërmjet kulturës dhe traditës, anës shpirtërore dhe religjioze, kulturës dhe modernes, si një paradigmë “sui generis” e botës bashkëkohore.

Kjo disharmoni është përcjellë me kriza të shumta të identitetit që çdo individ dhe grup fetar e ka përjetuar në trajta të ndryshme.

Vendosja e ndërlidhjes së debatit ndërmjet teologjisë ose filozofisë së religjionit dhe si pasojë e ortopraktikës fetare do të paraqesë esencën dhe identifikimin real të fesë në shoqërinë aktuale njerëzore.

Ndërsa nga ana tjetër do të dekontekstualizohet çdo element

multiplikativ i identifikimit real të religjionit dhe kështu religjioni do ketë mundësi të japë ndjenjën dhe emocionin fetar, do ketë vendin e vet në kornizat e kulturës botërore.

Duhet nënvizuar fakti se shprehja religjioze nuk është e formuluar sipas shembullit të gjuhës utilitare linguistike, por ajo bën fjalë për një relacion të hapur dhe sistematik ndërmjet ortopraktikës fetare me dukuri hapësinore, kohore, shqisore, përfshirë dije analitike, intelektuale e cila përbën strukturën e zgjedhjes paraprake të përfshirjes së dijes fetare dhe patjetër me përmasa ndjesore transcendentale pa të cilën çdo praktikë dhe intelektualizëm religjioz do të ishte jofetar. Për këtë duhet patjetër që intelektualit të njohë sa më thellë Kur'anin e madhëruar që të ndjekë bazën e sjelljes së homo religjiozitetit sipas shpalljes së fundit. Fuqia Krijuese urdhëron: “Me emrin e All-llahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit! Pasha Kohën. Me të vërtetë njeriu është në humbje. Përveç atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, i këshillojnë njëri-tjetrit të vërtetën e i këshillojnë njëri-tjetrit durimin.” Kjo sure¹ e Kur'anit sqaron se njeriu me duart e veta e përgatit lumturinë dhe shkatërrimin e tij. Njeriu nuk shpëton prej përgjegjësisë nëse e fajëson kohën, shekullin, hapësirën. Duket e qartë se fisnikëria është në njeriun e ditur e jo në kohën. Për t'u qartësuar mund të shprehemi se egoizmi është në natyrën e njeriut, kështu që në përpjekjen për të përmbushur dëshirat e veta, do t'u bjerë në qafë dëshirave të të tjerëve, pra do të krijojë konflikte. E vetmja disiplinë frenuese është feja. Vetëm kjo siguron

1. Kur'an, Asr, 103: 1-3.

harmoninë. Njerëzit që besojnë në mënyrë të vetëdijshme, janë gjithmonë më të virtytshmit. Morali fetar është edhe moral filozofik. Duke pasur parasysh interesat egoiste nuk është e mundur që praktikisht, ndërgjegjia e njeriut të arrijë të dallojë si duhet të keqen nga e mira.

Njeriu nuk shpëton prej përgjegjësisë nëse ja dedikon kohës, shekullit, hapësirës. Disa pretendojnë se edhe morali, ashtu si feja s'është i nevojshëm; mjafton ndërgjegjia e njeriut. Ka pasur shumë intelektualë, sidomos në shekullin e kaluar, por edhe disa shekuj më parë, të cilët për të evituar dekadencën e shoqërisë, sidomos për të evituar luftën midis shteteve pa arsye, ose me pretendime raciste, fetare, ekonomike etj., janë munduar të predikojnë moralin, por kjo tentativë nuk pati sukses, gjë që edhe sot shihet mjaft qartë, që e bardha lexohet e zezë dhe e kundërta. Kjo vërteton se ndërgjegjia e njeriut nuk arrin të dallojë sa duhet të keqen nga e mira, kur njeriu ecën në rrugën e interesave egoiste. E vetmja zgjidhje është, se vetëm feja është ajo që përcakton vlerën e një morali, të mbështetur mbi ndërgjegjen.

Nuk mohohet fakti që njerëz afetarë të jenë të virtytshëm, por edhe edukata e tyre është pasojë e ndikimeve të mjedisit me tradita fetare, të ngulitura në shekuj e të ruajtura prej brezave. Sikur afetarët të rriteshin në mjedise sterile, tek ata nuk do të gjenim asnjë virtyt. Mendoj se lidhjen e fesë me çështjen kombëtare, që po trajtohet me kulturë e transparencë në këtë periudhë, konfirmon për rolin e saj të madh në këtë aspekt edhe për 100 vjeçarin e kaluar të vendit tonë, si dhe

hedh poshtë pretendimet e atyre që nën maskën e ruajtjes së interesave të kombit, shpreheshin se gjoja pluralizmi fetar në Shqipëri na qenka një rrezik i madh, prandaj fetë duheshin mënjanuar, kurse Shqipëria është shembulli i kontinentit, ku fetë e ndryshme kuptohen midis tyre dhe se mendojnë për atdhedashuri pa dallim feje, pra fillimisht ne jemi shqiptarë dhe pastaj jemi besimtarë në fetë tona.

Unë si intelektual, me profesion mjek, me ndikim për të besuar nga prindërit dhe me kujtimet e moshës së vogël, u inkuadrova në ambiente besimtarësh të cilët kuptoheshin midis tyre se ishin të papërgatitur, prandaj këto njerëz kishin dëshirë të kontribuonin por në radhë të parë duhet të mësonin, sepse tani pas gati 25 vitesh unë pohoj se më ka ruajtur Zoti i madhëruar sepse qëllimi ka qenë i mirë.

Qëllimi kryesor ishte që të mirëpriteshin të arsimuarit, njerëzit e diplomuar teologë sepse ndihej mungesa e kuadrit për faktin se vetëm në vendin tonë, qeveria moniste i shpalli luftë besimeve fetare, duke shkatërruar institucionet fetare dhe duke persekutuar kuadrot e saj, si në asnjë vend të botës sonë. Kjo ndodhi e tmerrshme, bëri që në Shqipëri të lulëzojë hakmarrja, gjakmarrja, lufta midis njerëzve, që kishin ideale të ndryshme, me një egoizëm malinj, deri aty sa u vunë përballë prindërit me fëmijët, u shtua frika, mosbesimi dhe njerëzit u çoroditën, fëmijët dhe brezi i ri pa dashje u ndikuan mjaft, gjë që mendimet, idealet e tyre u karakterizuan me karakteristikat më të këqija. Kjo u pa nga emigracioni, nga pjesëmarrja

në veprime të panjohura më parë si prostitucioni, droga, huliganizmi, rilindja e gjakmarrjes etj.

Për të luftuar këto pasoja, duhet një punë e madhe dhe sidomos nxitja, propaganda, që njerëzit në përgjithësi të lexojnë për Islamin, sepse unë jam i bindur se ai që është i bindur për të mësuar, bëhet me të vërtetë i përsosur dhe merr rrugën e virtytit. Unë gëzoj shumë për mundësitë e krijuara nga Komuniteti Mysliman me botimet nga sektori përkatës dhe nga kuadrot që janë përzgjedhur.

Unë personalisht kam deklaruar gjithmonë se jam mjek dhe nuk jam teolog, por kur mendoj për tolerancën fetare, që me të vërtetë na karakterizon dhe na nderon në botën e kulturuar, ku ne nuk dalloheshim nga besimi sepse festojmë së bashku, me vizita, gostira, lidhje martesore të shumta dhe me tarikatet asistojmë në përgatitje të ashureve, këmbime me të afërmit, Sulltan Nevruzin, ditën e pranverës, etj. Të gjitha këto festime bëheshin pa shpjegime fetare por do të thosha më tepër si festa tradicionale. Pra aspektet e ndryshme të rrugës islame të jetës synojnë të gjitha së bashku të prodhojnë individin e nderuar dhe moralisht të ndershëm.

Kur Gyleni² flet për formimin e studentëve “të dedikuar për të jetuar në përputhje me cilësitë njerëzore dhe vlerat morale”, të cilat “zbukurojnë botën e tyre të jashtme me të gjitha llojet e virtyteve”, ai është duke propozuar një kod etik universal nga këndvështrimi i një myslimani që ka mësuar prej

Islamit. Në të njëjtën mënyrë, është e qartë që ai nuk i konsideron virtytet, cilësitë njerëzore dhe vlerat morale të jenë pronë ekskluzive e myslimanëve, ashtu siç studentët jomyslimanë janë të mirëpritur në shkolla dhe nuk është bërë asnjë përpjekje për t'i konvertuar. Nëse Islami është parë si një udhë për përsosjen morale, tasavufi (misticizmi) ose mistika islame mund të konsiderohet si një zhvillim i natyrshëm dhe i pashmangshëm brenda traditës islame. Gyleni mbron tezën që dënimi i sufizmit, dimensionit shpirtëror, është njëllë si të kundërshtosh vetë besimin islam ose thelbin e Islamit.

Ndër simpoziumet³ e organizuara, ku kam qenë pjesëmarrës është pranuar se pesë shekujt e parë të Islamit ishin periudha e kërkimeve dhe dijetarëve të shumtë. Po ashtu përgjatë kësaj periudhe kishte një liri shumë të madhe të mendimit, gjë që vërtetë se në një atmosferë të tillë mund të lindin dijetarë dhe mendimtarë të mëdhenj.

Intelektualët, që nuk janë njohur me Kur'anin shpesh shprehen për dogmatizmin e Islamit. Por e vërteta është se në Islam nuk ka dogmatizëm, sepse dogmatizëm do të thotë të kopjosh ose të pranosh diçka qorrazi pa i lënë hapësirë mendimit të lirë. Kur'ani nënvizon që të gjithë duhet sipas aftësisë mendore të tyre, ta vlerësojnë, pra mendimi ose vlerësimi është i pavarur. Kjo bazohet, ashtu si ligjet e natyrës, që nuk ndryshojnë kurrë, po ashtu nuk ndryshojnë aspektet kryesore, ose thelbësore të natyrës njerëzore dhe

2. M. Fethullah Gylen; Ese, perspektiva, opinione, Prizmi. Tiranë: 103 – 104.

3. Islamic cultural symposium, Islamic education in the west; 27 – 29 / 8 / 1999, Brussels.

prandaj fetë që i janë adresuar njerëzimit kanë parime të pandryshueshme dhe vlera të përhershme.

Kështu standarde të tilla morale, siç janë sinqeriteti, ndershmëria, dashuria, dhembshuria, respekti për prindërit dhe të moshuarit, ndihma, etj. janë vlera të pranuar botërisht. Po kështu evitimi i alkoolit, kumarit, tradhtisë bashkëshortore, si dhe prostitucioni, vjedhja dhe rrugët e padrejta si korrupsioni aktiv e pasiv janë pranuar përgjithësisht.

Marrja në konsideratë e standardeve dhe vlerave të tilla, duke i kthyer në ligje nuk është dogmatizëm. Por si dhe në gjithë besimet e tjera, ashtu edhe në Islam janë shfaqur disa qëndrime dogmatike, si p.sh. zahirizmi, që u shfaq gjatë periudhës së kalifit të katërt si rezultat i ekstremizmit, që më vonë u bë shkak për vehabizmin. Kjo dukuri vjen ngaqë mendja e njeriut ndryshon dhe e drejta për ta pranuar ose jo varet nga vlerësimi i njerëzve, e mira përqafohet gjithmonë nga shumica.

Ndërsa teokracia dhe tirania në Islam nuk mund të kritikohet sepse në Islam nuk ka hierarki klerikale zyrtare ose një sistem klerikal.

Fundamentalizmi nuk ka asnjë të përbashkët me Islamin, pavarësisht se disa i konsiderojnë lëvizjet Iraniane dhe Saudite si të këtilla. Këto versione të veçanta të këtyre vendeve rrjedhin nga sektet, që i pasojnë. Shumica e myslimanëve nuk i pranojnë ato veprime, prandaj ky është qartësuar, duke e cilësuar si konfuzion konceptual.

Problem me rëndësi për ta shpjeguar është edhe roli i femrës dhe të drejtat e gruas. Kur'ani dhe parimet kur'anore

nuk i trajtojnë burrin dhe gruan si krijesa të veçuara. Ndërsa në botën perëndimore, për arsye të koncepteve, që kanë predominuar njerëzit, e shohin çështjen nga ekstremet dhe në këtë mënyrë prishin mirëkuptimin ose balancën. Në fakt duhet konsideruar se gruaja dhe burri duhet të jenë si dy pamje të një të vërtete, pavarësisht se ata kanë ndryshime fizike dhe psikologjike. Por në rast se do jepet mendimi për të drejtat e femrës, ato nuk do vlerësohen njëllë në rast se nuk mendohet edhe për burrin. Shumë herë, koncepti i meshkujve për femrën, është shkaku kryesor i dis-harmonisë së çiftit, për arsye se mashkulli shpesh herë nga tradita vlerësohet, duke i dhënë kompetenca të shumta për të vendosur pothuajse për të gjitha problemet e jetesës. Por në shoqëritë Islame duhet të dallohet fakti që, Islami ka bërë ndryshime tradicionale, ose është ndikuar nga ligjet e shoqërive joislame. Në atmosferën sociale të shoqërive islame ku Islami nuk është njollosur, femrat myslimane janë plotësisht pjesëmarrëse në jetën e përditshme. Kështu gjatë periudhës së parë të Islamit, bashkëshortja e Profetit (a.s.), Aishja (r.a.), udhëhoqi ushtri. Ajo ishte dijetare fetare dhe e vështronte çdo njeri me respekt dhe debatonte sipas problemeve me krerët e shoqërisë. Femrat faleshin në xhami së bashku me meshkujt. Sot p.sh. kjo traditë ruhet në Qabe dhe në xhamitë e Xhakartës, por nuk shihet në vende të tjera islame (në të cilat vendfajla e grave është në mahfil, që ndodhet në katin e dytë të xhamive). Kjo paraqitje nuk ka rëndësi por duhet kuptuar shkaku, ose arsyeja, sepse Kur'ani e sheh çdo individ, si

një tip më vete në krahasim me tipat e tjerë, pra i rëndësishëm është burimi i ndjenjave dhe burimi i edukimit për këto paraqitje, më qartë çdo njeri ka mendjen e tij dhe interpretimi është personal dhe demokratik.

Kuptohet kur këto individë përkrahen për të mirën e kësaj paraqitje dhe është në të mirë të jetës shoqërore, kuptohet që këto individë do bashkohen dhe nuk do t'i bëjnë ndikim për keq anëtarëve të tjerë të shoqërisë.

Pra ky parim, që nuk i shfrytëzojnë të drejtat dhe liritë e tyre për të dëmtuar të tjerët, por shohin interesin e të tjerëve me ndërgjegje njëjloj si interesin personal, duhet të përkrahet e të zhvillohet individualisht. Përndryshe ata që vepron në ndryshe, duke parë vetëm interesin personal, e duke dëmtuar të tjerët do të gjykohen si shtypës dhe të shtypur, mizorë dhe viktima të mizorisë. Ky veprim, që bazohet në shprehjen “bëj si të them unë dhe mos shiko se ç'bëj unë” është fatkeqësisht prezent në shumë vende e sidomos mes politikanëve, që kërkojnë votat gjatë zgjedhjeve.

Karakteristika e njerëzores ose humanizmi në besimin tonë, është dashuria, ose trëndafili i zemrës, që kurrë nuk vyshket dhe e shprehur më konkretisht, dashuria është muzika më magjike dhe më e bukur që të qetëson mendjen. Lidhja e fortë e anëtarëve të familjes, e shoqërisë dhe popullit është për shkak të dashurisë, prandaj çdo njeri duhet të ofrojë ndihmën e vërtetë dhe mbështetjen për të tjerët në respekt të dashurisë, që gjendet në thelbin e ekzistencës, si një ligj natyror.

Profeti ynë (a.s.) thotë: “Ndihmoni vëllain tuaj nëse ai është një shtypës

ose viktimë ... Ju mund ta ndihmoni shtypësin nëse bëni të mundur që ai të ndalojë shtypjen ndaj të tjerëve”. Është e mundur të tregohet mëshirë për një tiran nëse ai ndalon veprimet e padrejta.

Shumë intelektualë vendas ose të shteteve të ndryshme, kur informohen për ngjarje terroriste nga media ose TV, gjithmonë ngrenë dyshime se ekzekutuesit e këtyre akteve vijnë nga radhët tona dhe me të drejtë ne myslimanët duhet të alarmohemi dhe duhet përgjigjur, sepse më e pakta që mund të themi është se “Islami nuk njihet nga të gjithë”.

Në të vërtetë, në Islamin e predikuar nga Kur'ani, terrori nuk ekziston dhe terrorizmi, vrasja dënohet shumë ashpër, por duhet kuptuar dhe duhet bërë dallimi midis Islamit si besim dhe besimtarit ose myslimanit, sepse myslimani i vërtetë, i cili është i sinqertë në besim dhe praktikë duhet veçuar nga myslimani hipokrit, i cili paraqitet por nuk vepron si i tillë.⁴

Prandaj Islami nuk ka asnjë lidhje qoftë fetare, qoftë praktike me terrorizmin. Asnjë mysliman i vërtetë nuk duhet të vrasë një krijesë njerëzore, asnjë mysliman nuk duhet të vetëvritet sepse Islami nuk e pranon terrorin. Në Islam, vrasja e një njeriu është një akt i barabartë, për nga rëndësia, me mosbesimin.

Por sot Islami, si dhe për probleme të tjera nuk është kuptuar saktë. Islami gjithmonë ka respektuar idetë e ndryshme dhe kjo duhet kuptuar për të pasur një vlerësim të saktë.

Me keqardhje po them që, në vendet ku jetojnë myslimanët, disa udhëheqës fetarë dhe myslimanë mynafikë

4. Gazeta “Zaman”, 22 mars – 1 prill, 2004.

(hipokritë) nuk kanë armë tjetër në duar veç interpretimit fundamentalist të tyre për Islamin. Këto shfrytëzojnë këto luftëra me incidente për interesat e tyre. Nga Islami këto metoda kundërshtohen me forcë dhe dënohen, sepse për arritjen e besimit nuk duhet të përdoren asnjëherë metoda të rreme.

Islami dhe myslimanët e vërtetë janë të ndërgjegjshëm se pëlqimi i Zotit nuk mund të fitohet duke vrarë njerëz. Në vazhdim rregullat e Islamit janë të qarta; individët nuk mund të shpallin luftë, po ashtu një organizatë ose grupim nuk mund të deklarojnë luftë sepse lufta shpallet nga shteti. Ndryshe ky është një akt terrori. Lufta që bëhet nga dëshira personale të disa njerëzve kuptohet që realizohet nga njerëz të korruptuar, ose banditë. Kjo është kundër frymës së Islamit. Normat e paqes dhe të luftës në Islam janë parashtruar qartë.

Nëse kjo është kundër Islamit, atëherë pse bota Islame nuk i përgjigjet? Përvoja e besimtarëve në këtë botë, pavarësisht kontinenteve shprehen se në botën e sotme ka vende ku jetojnë myslimanë dhe se realisht një botë Islame nuk ekziston. Në disa vende ka më shumë myslimanë dhe në disa të tjera më pak. Myslimanët e kanë ristrukturuar traditën Islame në përputhje me idetë e tyre. Për shembull, gjatë muajit të madhëruar të Ramazanit rrugët dhe pemët anash tyre zbukurohen si ato të vendeve të krishtera gjatë Pashkëve (si Dubai dhe Athina), ose p.sh. nuk lejohet ngrënia gjatë ditës në vende të hapura etj. ose nuk tregtohen pije alkoolike. Nga këto dhe shumë të dhëna të tjera rezultojnë se Islami është një mënyrë jetese dhe një kulturë, që nuk ndiqet

vetëm si një besim. Myslimanët në vende të ndryshme e kanë strukturuar traditën Islame në përputhje me idetë e tyre.

Kushti i domosdoshëm në Islam është besimi “i vërtetë” dhe jeta në përputhje me të, prandaj myslimanët duhet të marrin përgjegjësi të natyrshme në Islam. Dihet që shoqëri me koncept filozofik të këtyllë në vendet Islame nuk ekziston. Në këto pozita nuk ka probabilitet për të kontribuar tamam për ekuilibrin e botës në të ardhmen e afërt. Nuk është diskutuar nga organizatorët ose drejtuesit për këtë vizion dhe pavarësisht se nuk mund të mohohet, një ndriçim, që duket në ditët e sotme.

Në këtë fenomen e shohim nëpër konferenca, tek drejtuesit, ose nga parlamentet e tyre me anë të TV. Për çështje serioze e të rëndësishme ka vizione dhe dis-harmoni mjaft të qarta.

Myslimanët, pra, me këtë status nuk mund të zgjidhin as problemet e tyre dhe as të botës. Ndoshta mund ta arrijnë këtë gjë në të ardhmen.

Arsyet apo shkaqet e kësaj gjendjeje janë me sa duket, ngaqë nuk janë të bashkuar dhe nuk përbëjnë botën Islame, pra sot Islami është individual.

Myslimanët duke qenë në vende ose shtete të ndryshme janë të ndarë nga njëri tjetri. Në këtë pozitë çdo mysliman, ose drejtues i një shteti ndjek rrugën apo vijën e bashkëpunimit sipas interesit të vendit ose interesit personal.

Kuptohet që kjo mënyrë jetese në “Islam” nuk jep rezultat për të qenë në pozita të avancuara, ose pararojë për të zgjidhur problemet e përbashkëta, p.sh. për problemet e teknologjisë moderne, për ta kuptuar universin më

mirë në përputhje me Kur'anin, për ta interpretuar të ardhmen dhe për të krijuar projekte dhe për t'i konkretizuar vendit të ardhmen. Pra aktualisht këto vende importojnë aparatura me teknologji të lartë nga vendet e tjera, duke pasur burime financiare nga pasuritë nëntokësore, që nuk janë të përjetshme. Impakti rezulton se duke mos pasur një bashkim me mirëkuptim, gjithsecili vepron individualisht dhe kjo lloj demokracie, ku çdo mysliman ose disa myslimanë kanë bindjet e tyre personale, dëshmon se nuk ka konceptim Islam të mbështetur me besimin në Kur'an dhe i testuar nga studiues të kualifikuar në mënyrë të përsëritur. Pra përgjigja më e drejtë, mund të deklarohet që sot është mbizotëruese një kulturë myslimane se sa një kulturë islame.

Për vendin tonë, kuptohet që vendi ynë me shumicë myslimane, me tolerancë fetare për t'u marrë shembull, ka devijuar në pikëpamjet elementare; tani emrat e të lindurve këto dekada s'janë myslimanë, zakonet për t'u zbatuar si synetllëku, larja e xhenazes, falja e xhenazes etj., nuk po respektohen, po ashtu mungesa e ndihmës për njerëzit në nevojë, të moshës së tretë, ose në raste fatkeqësish nuk ekzistojnë për arsye se "zekati" nuk zbatohet, etj.. Këto dëshmojnë që edhe ne duhet të alarmohemi, pavarësisht arritjeve që kemi në krahasim me kohën e monizmit.

Dhe sigurisht, të gjitha këto kanë nevojë për rishikim dhe rinovim nga njerëzit e edukuar në fushat e tyre, sipas rregullave përkatëse.

Mungesa e edukimit për besim gjithëpërfshirës të popullsisë myslimane,

ka qenë e theksuar në kohën e monizmit, por është e pamjaftueshme edhe në kohën e sotme, ku ka influencuar ose ka dhe shtrirje apo dimensione të tjera.

Aktualisht nga të dhënat e medias së shkruar dhe asaj elektronike jepen të dhëna për vrasje brenda familjes, përdorim droge, rrëmbime njerëzish për qëllim trafikimi, prostitucion, korrupsion, gjakmarrje etj., të cilat nuk kanë ekzistuar thujtë plotësisht ose kanë qenë të rastësishme, por sigurisht kanë ardhur edhe si pasojë se këto njerëz e kanë mohuar besimin dhe si pasojë e përvojës botërore, këto shtohen ose forcohen në mënyrë të atillë që rrezikojnë sigurinë e njeriut dhe në këto kondita duhet shtuar më shumë ndikimi i edukatës për probleme sociale, që të evitohet organizimi i njerëzve keqbërës ose terroristë.

Sot fatkeqësisht, merren si shembull i terrorizmit, në shumë vende të botës, njerëz që flijohen për të vranë të tjerë, madje dhe më keq që vrasin dhe njerëz të pafajshëm, përfshirë të gjitha moshat. Kështu është i njohur krimi monstruoz i Usama bin Ladenit. Ky bandit jo vetëm që ka nxirë pamjen e ndritur të Islamit, por ka krijuar dhe figurën më të njollosur të myslimanit; pavarësisht se ky bandit ka zëvendësuar logjikën islame me ndjenjat dhe dëshirat e tij, sepse ai me bashkëpunëtorët e tij, si dhe edukatorët e tij, janë përgjegjës për këtë kriminel dhe bashkëpunëtorët. Prandaj duhet luftuar koncepti ekstrem, si dhe duhet të predominojë sqarimi që njeriu i tillë dënohet dhe si përcaktohet sipas Kur'anit vendi në xhehenem (ferr) përjetësisht. Çdo krim, sidomos i këtij lloji, duhet shfrytëzuar për të nxjerrë

në pah sidomos të njerëzve, që nuk e njohin Islamin, se këto individë mostra nuk kanë asgjë të përbashkët me Islamin dhe se këto mund të quhen kriminelë të njerëzimit dhe duhet të izoloohen përjetësisht. Nga e keqja njeriu duhet të preokupohet për të gjetur shkakun në mënyrë që këto dukuri anormale të kurohen.

Të gjithë ata janë fëmijët tanë, por pse disa prej tyre marrin rrugë të shtrembër? Pse ka nga ata që rebelohen kundër vlerave njerëzore? Këta të gjithë janë rritur në mes nesh, kjo dëshmon se mënyra e sistemit edukativ ka mangësi dhe për këtë arsye, në mënyrë që këto dobësi të eliminohen duhet të studiohen shkaqet për t'i eliminuar.

Më qartë nuk ka qenë i mirë edukimi në të gjitha hallkat e tij dhe duke mos i dhënë prioritetin e duhur disa gjenerata kanë humbur, disa të tjerë janë rrënuar dhe shkatërruar. Rinia e pakënaqur ka humbur perspektivën, papunësia nga ana tjetër bën që këta abuzohen, manipulohen, drogohen dhe shfrytëzohen me pretekstin e disa idealeve deri edhe si vrasës. Kështu që formohen grupe terroriste, duke etiketuar veprimet ndryshe. Në emër të këtyre “idealeve” të çmendura shumë njerëz janë vrarë për të larë hesapet. Nuk duhet menduar se akoma nuk jemi keq, sepse numri ose shpeshësia nuk është e lartë, sepse ky koncept është i gabuar dhe nuk duhet që shoqëria ta pranojë këtë si pjesë të jetës sonë të përditshme. Kjo situatë mund të ishte evituar me

anë të edukimit, por edhe me ligjet dhe rregullat e shtetit, që duhet të zbatohen.

Por kryesore mendojmë se është që e vërteta duhet mësuar menjëherë. Për myslimanët duhet bërë e qartë se ata nuk mund të jenë terroristë, por duhen qartësuar dhe ta kuptojnë që bërja keq nuk vlerësohet e madhe apo e vogël, por për këtë paguhet në këtë botë si dhe në botën tjetër.

Kur’ani i Madhëruar thotë që: “... vrasja e një njeriu është e njëjtë me vrasjen e të gjithë njerëzve”. Nëse ky është një parim themelor i fesë islame, ai duhet të mësohet në shkollë ose nga familja.

Si konkluzion për sa është shkruar, rezulton se shkenca mund të gjejë themele të fuqishme e të sigurta të Islami, si religjion që nuk ka prirje për kundërshtim, që nuk i ngre prita arsyes, nuk e kufizon imagjinatën e njerëzve e nuk ka nevojë për martirë, idhuj, mistere e sofistikime metafizike, por vetëm për pajtim e harmoni midis religjionit dhe arsyes.

Çdo kurs tjetër mund ta shmangë shkencën e teknologjinë drejt ateizmit dhe materializmit, gjë që tashmë është realitet i kohëve moderne dhe zhveshja e mëtejshme nga vlerat morale e spirituale mbjell instrumentet e shkatërrimit që fuqizojnë faktorët e vetasgjësimit.

Përfundimisht dua të theksoj se, dija shkencore pa fe shpie në ateizëm e agnosticizëm, kurse dija fetare pa ndriçim intelektual të mendjes shpie në fanatizëm, prapambetje, degradim e inferioritet.

Roli i ulemasë në rrjedhat shoqërore politike të periudhës së shpalljes së pavarësisë

Prof. Dr. Assc. Fahrush Rexhepi
Fakulteti i Studimeve Islame-Prishtinë

Abstrakt

Historia e kombit shqiptar nuk spikat vetëm lashtësinë e tij, por ajo paraqet edhe jetën dhe zhvillimin e tij, peripecitë e tij nëpërmjet të cilave ai është detyruar të kalojë gjatë shekujve. Janë rreziqet që është dashur t'i kapërcejë populli shqiptar në luftë për të mbrojtur veten dhe për të përparuar në rrugën e zhvillimit, janë veprat e mëdha materiale dhe kulturore, që kanë krijuar bijtë e tij më të mirë dhe ua kanë lënë trashëgim pasardhësve të tyre.

Kontributi i fesë dhe i ulemasë shqiptare në proceset historike, kulturore dhe politike të Shqipërisë dhe kombit shqiptar do të kujtohet më mirë dhe më drejt vetëm pasi të kemi një pasqyrë sa më të qartë të realitetit shoqëror, politik, fetar, arsimor e kulturor në trojet gjithëshqiptare, në periudha të caktuara të pushtimit të truallit të tyre.

Gjatë zhvillimit historik të kombeve të botës e midis tyre edhe të zhvillimit historik të kombit shqiptar, krahas faktorëve të tjerë, një rol të veçantë dhe me rëndësi kanë luajtur edhe personalitetet e shquara historike, qofshin ato shkencore, kulturore, politike e kombëtare, por edhe ato fetare-intelektuale e patriotike. Këto figura të penës, të dijes, të kulturës e të punës që populli shqiptar i nxori nga gjiri i tij në luftërat dhe në rrethanat e vështira shekullore, në përpjekje për çlirim dhe për zhvillim kombëtar, i krijuan emër dhe i sollën lavd e nder emrit të Shqipërisë. Ishin këta atdhetarë të flaktë, si: Dervish Cara e Hoxha Tahsini, Abdyl Frashëri e Sylejman

Vokshi, Ali Ibra e Sami Frashëri, Haxhi Ymer Prizreni e Haxhi Zeka, Hafiz Ali Korça e Hoxhë Kadri Prishtina dhe shumë të tjerë, të cilët ia vunë themelet Lëvizjes Kombëtare Shqiptare në fushën e emancipimit politik dhe kulturor të saj.

Këto figura me veprimtarinë e tyre të vazhdueshme përgatitën terrenin për formimin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, si organizatë e parë politike mbarë shqiptare. Siç dihet Lidhja Shqiptare e Prizrenit është dhe mbetet sinteza dhe programi më epokal i periudhës së Rilindjes Kombëtare Shqiptare.

Një vend të merituar në lëvizjen tonë kombëtare të shek. XX, e sidomos të periudhës ndërmjet Dy Luftërave

Botërore dhe pas tyre, zënë edhe shumë personalitete dhe figura të shquara patriotike kombëtare e fetare të cilat dhanë një kontribut të çmuar si në fushën e kulturës islame ashtu edhe në fushën e gjuhës dhe arsimit shqip, si dhe morën pjesë aktive në Lëvizjen Kombëtare për çlirim dhe bashkimin e trojeve etnike shqiptare.

Këto figura kanë kontribuar edhe në përgatitjen e terrenit dhe rrethanave politike për shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë më 28 nëntor të vitit 1912.

Figurat më të shquara të ulemasë shqiptare, asnjëherë nuk u ndanë nga problemet parësore të kombit e as nga hallet e tij, duke iu përmbajtur fjalës së urtë popullore “nga populli kurrë mos u ndaj as në gëzim as në hidhërim”, duke i parë edhe problemet e fesë dhe të besimit të lidhura ngushtë me to. Faktori vendimtar, që ka ndikuar për këtë buron nga thelbi i besimit që ata kanë përfaqësuar dhe nga fakti se shqiptarët janë një popull, kanë një kulturë e një traditë historike dhe janë mbrojtur në një hapësirë duke luftuar për një atdhe e për një Shqipëri Etnike të përbashkët.

Shqiptarët, ndonëse u pushtuan nga osmanlinjtë dhe e humbën pavarësinë kombëtare, por edhe pse e përqaftuan fenë islame, asnjëherë nuk u pajtuan me pushtuesin dhe as nuk u asimiluan prej tij. Në këtë aspekt, feja islame dhe kombi shqiptar janë dy nocione, që nuk i kundërvihen njëri-tjetrit. Ky koncept i balancuar me interes të zgjidhjes së çështjes kombëtare shqiptare në mënyrë thelbësore ka ndikuar që shqiptarët, si një popull me tradita të lashta dhe me një krenari shekullore, të përqafojnë Islamin edhe pse ajo ishte edhe fe e pushtuesit në rastin konkret.

Arsimimi gjithkund konsiderohet një prej shtyllave bazë të sigurisë

morale, fetare e kombëtare dhe të jetës kulturore në çdo shoqëri. Nëpërmjet arsimit përcaktohet niveli dhe shkalla e zhvillimit të vendit dhe pozita e tij në mesin e shteteve të tjera të botës. Tradita e kultivimit të jetës fetare-arsimore islame ndër shqiptarët është mjaft e hershme dhe fillon që nga shek. XIV, d.m.th. nga vitet e para të shtrirjes dhe depërtimit të shtetit osman në këtë pjesë të Ballkanit.

Në këtë periudhë kohore krahas përqaftimit të fesë islame fillon edhe procesi i arsimit dhe përhapjes së kulturës e civilizimit islam, si komponentë përbërës e të pandashëm të fesë islame dhe qytetërimit të saj. Bazuar në vlerat civilizuese dhe arsimore e edukative, që proklamoi feja islame, si komponentë përbërës të pandashëm të saj, në shumë pjesë dhe në shumë qendra të trojeve shqiptare, nisën të themelohen institucione fetare arsimore, si: xhami, biblioteka, medrese e mejtepe. Këto institucione u vunë në shërbim të myslimanëve shqiptarë të këtyre trojeve dhe në shërbim të popullit dhe të atdheut në përgjithësi, që do të thotë se këto institucione shekuj me radhë do të ruajnë traditën kulturore dhe atdhetare të popullit tonë.

Si rrjedhim i kësaj, në Kosovë, ku më shumë e ku më pak, fillojnë të themelohen institucione fetaro-arsimore islame, si xhami, biblioteka, mejtepe, medrese, konvikte etj., të cilat kanë luajtur rol të madh në mirëqenien, në formimin dhe edukimin fetar të masat e gjera të popullit shqiptar.

Roli i xhamive si institucione fetare, arsimore dhe edukative ishte dhe mbeti i rëndësishëm, sepse në fillim ato ishin vatra të arsimit për shqiptarët. Nëpër xhami, përveç kryerjes së obligimeve fetare, shqiptarët myslimanë kishin mundësi edhe të arsimohen nëpërmjet

ligjëratave, sepse këto kuadro në qendra të ndryshme të Kosovës ishin ndër personalitetet më të shkolluara të kohës.

Edhe në shtetin shqiptar që u pavarësua më 1912, pati një numër të madh medresesh, të cilat si edhe në Kosovë, përveç rolit edukativo-arsimor dhanë kontributin e tyre të çmueshëm edhe në rrafshin fetar e kombëtar. Personeli i tyre bashkë me nxënësit dhe me popullin e lidhën fatin e tyre me fatin e Shqipërisë. Nënshkrimet e Haxhi Vehbi Dibrës dhe Ferit Vokopolës ishin ndër të parat që u hodhën në Kuvendin e Vlorës më 28 nëntor 1912. Prandaj me të drejtë Sali Vuçiterni, ish senator në qeverinë shqiptare në deklaratën e tij kur flet mbi reformat në arsim thotë: “Çështja e medreseve është pika më me rëndësi për ne”.¹ Haxhi Vehbi Dibra përveç që ishte kryetar i senatit të parë qeveritar ai shpeshherë e zëvendësonte Ismail Qemal Bej Vlorën. Ndërsa Ismail Efendi Ndroçi i njohur si “flamurtar i nacionalizmës” në nëntor të vitit 1912, pas shpalljes së pavarësisë, i pari e kishte ngritur flamurin në Tiranë.²

Pas fitores së pavarësisë, Shqipëria hyri në etapat e zhvillimeve të reja historike, politike, sociale dhe kulturore. Me gjithë prapambetjen e madhe të vendit, pas pavarësisë shenjat e zhvillimeve progresive vëreheshin në shumë sfera të jetës. Ndryshime dhe progres pati edhe për sa i përket zhvillimit të kulturës fetare islame.

Në këtë periudhë u hodhën idetë, e më pastaj edhe themelet për një zhvillim të pavarur të kulturës shqiptare islame

dhe të çdo veprimtarie tjetër brenda kuadrit të shtetit kombëtar shqiptar. Kështu që në vitin 1921 Aleanca Kombëtare Myslimane, e përbërë prej hoxhëve titullarë dhe besimtarëve të shquar, shpalli shkëputjen e komunitetit shqiptar islam nga Shejhul-islami në Stamboll.

Në këtë periudhë mendjet e kthjellëta të dijetarëve dhe të hoxhallarëve shqiptarë filluan të zbatojnë reformën në kulturën shqiptare islame. Në këtë kohë mund të themi se zë fill edhe periodiku shqiptar islam, i cili luajti një rol mjaft të rëndësishëm për afirmimin e vlerave kulturore, civilizuese, fetare, morale, sociale, arsimore e shpirtërore për kohën.

Fillimi i shekullit XX për shqiptarët jashtë Shqipërisë solli ndarjen e kombit tonë. Me copëtimin e trojeve shqiptare dhe grabitjen e tyre nga mbretëritë serbe, malazeze, e greke e më pas të Jugosllavisë Versajase dhe të Greqisë, filloi një nga periudhat më të rënda, më të vështira dhe më të rrezikshme të historisë së tyre.

Politika e ndjekur ndaj shqiptarëve të Kosovës, të Çamërisë, e të viseve të tjera, ndërmjet Dy Luftërave Botërore, ishte politikë e dhunës dhe e gjenocidit ndaj popullit të pafajshëm e të pambrojtur, e cila synonte shkombëtarizimin e popullsisë, ndryshimin me çdo kusht të përkatësisë etnike të këtyre viseve.

Në rrethanat e pushtimit serbo-malazez dhe grek, përkatësia fetare e popullsisë së këtyre viseve, ku dominonte popullsia e besimit islam si dhe lufta për ruajtjen e këtij besimi, u bë një faktor i rëndësishëm qëndresë dhe një mjet i fuqishëm shprehës i përkatësisë

1. Sali Vuçiterni “Mbi nevojën e reformave”, “Zani i Naltë” Tiranë, 1927, nr. 7, f. 205.

2. “Vdiq flamurtari i nacionalizmës”, Kultura islame, 1944, f. 224.



Lart: 1. Sali Gjuka, 2. Bardh Isufi, 3. Lal Perolli, 4. Isuf Veseli, 5. Sadik Deçani,
6. Nexho Haxhisadiku, 7. Adush Kastrati, 8. Halim Gostivari, 9?,
10. Bajram Daklani, 11. Tahir Zajmi;

Në mes: 1. Ragib Kajabegolli, 2?, 3. Qazim Begolli,
4. Hoxhë Kadri Prishtina, 5. Hysni Curri, 6?, 7?;

Ulur: 1. Hamdi Zajmi, 2. Jahja Prishtina, 3. Kahreman Begolli, 4. Ibrahim Gjakova,
5. Bedri Pejani, 6. Sadik Gostivari, 7. Nimon Ferizi, 8. Rrok Perolli, Shkodër 1918.

kombëtare të popullsisë. Për këtë arsye gjenocidi antishqiptar i ndërmarrë gjatë kësaj periudhe, synonte likuidimin fizik të shqiptarëve si komb e si popull. Në këtë kuadër, një vend të veçantë zunë dhe përpjekjet për t'i detyruar ata për të braktisur fenë e besimin islam dhe për të përqaftuar fenë e pushtuesit.

Në këtë situatë jashtëzakonisht të vështirë për popullsinë shqiptare nën okupimin e huaj, u zhvillua veprimtaria e elementëve atdhetarë laikë dhe fetarë, e cila luajti një rol të rëndësishëm për ruajtjen e ekzistencës, për ngritjen e vetëdijes politike, për progresin

ekonomik, shoqëror, politik, kulturor e fetar të shqiptarëve.

Personalitetet atdhetare, laike e fetare, si në parlamentin shqiptar dhe sidomos në atë jugosllav, pranë forumeve dhe organizmave ndërkombëtare, luajtën një rol të rëndësishëm për informimin e opinionit shqiptar, jugosllav dhe të atij botëror, për shtypjen e popullsisë shqiptare, për përpjekjet për shkombëtarizimin e këtyre viseve.

Nuk ka dyshim se një rol të rëndësishëm për mbrojtjen e të drejtave kombëtare të popullsisë shqiptare,

luajtën organizatat dhe partitë politike të kohës dhe sidomos Komiteti, “*Mbrojtja Kombëtare e Kosovës*” dhe Organizata për mbrojtjen e të drejtave të myslimanëve “*Xhemijeti*” (Bashkimi), si dhe organet e tyre “*Populli*” dhe “*Hak*”.³ Këto dy organizata u krijuan afërsisht në të njëjtën kohë dhe udhëhiqeshin nga dy prej figurave më të shquara të Lëvizjes sonë Kombëtare, Hoxhë Kadri Prishtina (personalitet i njohur), dhe Ferat Bej Draga (udhëheqës i organizatës politike të myslimanëve të “*Jugut të Jugosllavisë*”).

Pas kapitullimit të Jugosllavisë së Vjetër, Kosova mbeti e pushtuar dhe e copëtuar nën pushtuesit gjerman, italian dhe bullgar. Shumica e territoreve të Kosovës mbeti nën pushtetin italian dhe iu aneksua “Shqipërisë Etnike”. Gjatë Luftës së Dytë Botërore, myslimanët e Shqipërisë, forcuan lidhjet e tyre me myslimanët shqiptarë të Kosovës, të trojeve të tjera shqiptare, të Malit të Zi, të Maqedonisë si dhe me popullatën çame. Këto lidhje ndikuan fuqishëm në ngritjen e ndërgjegjes kombëtare në këto zona. Bashkësia Islame e Kosovës në rrethana të reja, veprimtarinë e vet e zhvilloi në kuadër të Komunitetit Mysliman me qendër në Tiranë, pra në kuadër të Shqipërisë Etnike, përkatësisht nën okupimin italian.

Në këtë periudhë mund të themi se, përveç ngritjes së ndjenjave fetare në masë, roli i institucioneve fetare islame dhe i dijetarëve islam ishte i madh edhe në pikëpamje të ngritjes së ndjenjave atdhetare. Kjo shihet qartë edhe nga fakti se personalitetet fetare, gjatë periudhës së viteve 1941-1945, e gjetën ideologjinë e tyre të njëjtë me

fashizmin. Në këtë kohë kryetari i K.M. Behxhet Shapati dhe myftiu i Prishtinës përkrahnin haptas propagandën fashiste si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj. Në këtë kontest në Kosovë, fashizmi arriti të përfitonte mjaft përkrahje nga patriotët dhe nacionalistët, të cilët nuk besonin në vëllazërim-bashkimin e popujve të proklamuar në mënyrë artificiale, sidomos në Kosovë. Këta nacionalistë i bënë thirrje popullit për luftë kundër Partisë Komuniste dhe Revolucionit Socialist në Jugosllavi dhe në Shqipëri.

Është me rëndësi të përmendim se personalitetet fetare islame shqiptare me kohë dhe drejtë kishin kuptuar faktin se shqiptarët nuk mund të çlirohen pa mbështetjen në forcat ndërkombëtare demokratike, duke mos krijuar iluzione për përkrahje nga komunistët serbosllavë. Këtë e vërejmë edhe nga deklaratat e shpeshta të Mulla Mustafë Barës, Mulla Idriz Gjilanit, Mulla Vesel Gutës dhe të shumë hoxhallarëve të tjerë.

Për ta vërtetuar këtë konstatim kujtojmë periudhën e shtatorit të vitit 1944, kur skenën politike të Kosovës filloi ta trazojë më fuqishëm ideja komuniste për çlirimin antifashist të Kosovës e të Shqipërisë në bashkëpunim me Lëvizjen Antifashiste – Komuniste Jugosllave – Mulla Idriz Velekinca, i vuri në spikamë Fadil Hoxhës se: “Shqiptari nuk mund të çlirohet pa mbështetjen në forcat ndërkombëtare demokratike, por kurrë nuk do të fitojë liri duke u mbështetur në fqinjët armiq tradicional të Shqipërisë Etnike, e aq më pak duke u mbështetur në komunisto-çetnikët serb”.⁴

Ndërsa në disa kërkesa politike të artikuluara në programin e mbrojtjes

3. Dr. Lefter Nasi, *Aspekte nga kontributi i ulemasë shqiptare kundër gjenocidit serbomadn në Kosovë*, Feja, kultura dhe tradita islame ndër shqiptarët, Prishtinë, 1995, f. 473-474.

4. M. Pirraku, Mulla Idrizi shëmbëlltyrë e historisë sonë kombëtare (1991-1949), Dituria Islame, nr. 48.

kombëtare të Shqipërisë Etnike nga vazi i Mulla Vesel Gutës, të mbajtura në xhaminë Bajrakli në Prizren, më 17 prill 1943 në 2 vjetorin e çlirimit nga pushtuesit jugosllav, hasim edhe këtë citat: “Pas 5 shekujsh robnie të vështirë, Kosova nga traktati i turpshëm i Versait hangri grushtën ma të rëndë, u nështrua nën zotimin mizuer të një pakice t’egër. Mbeti pothuaj 30 vjet rresht nën shkelmin serb e shkaputën prej nanës Shqipëri (...) Filloi një kohë fatkeqësie, mjerimi dhe vuajtjesh, qi zgjati masë një të katërt shekulli. Kosova shkoi viktimë e traktatit të pavend, u përul dhe i duroi të gjitha mizorint, por durimin nuk e humbi, shpresën e kishte të gjallë se dikurë për hirë të së drejtës hënore do të binte edhe për Kosovën boria e lirisë”.⁵

Ndër emrat e hoxhallarëve e të dijetarëve islam shqiptarë, që bartën barrën e organizimit të luftës për Mbrojtjen e Shqipërisë Etnike gjatë viteve 1941-1945 janë edhe: Mulla Shaqir Halili, Mulla Jakup Kamberi, Asim efendi Luzha, Mulla Hamit Bytyçi, Mulla Rexhep Krasniqi, Mulla Riza Osmani, Mulla Haki Sermaxhaj, Haxhi Muhamet efendi Gashi, Mulla Adem Ibrahim Maloku, Mulla Maliq Gashi, Hafiz Shefki Kallaba, etj. Mund të themi se një plejadë prej mbi 300 hoxhallarëve të viseve shqiptare jashtë Shqipërisë Londineze la gjurmë të pashlyeshme në

historinë e popullit shqiptar në mbrojtje të Shqipërisë në vitet 1941-1945.⁶

Dihet se historia e shek. XX për popullin shqiptar, është përplot kthesa, batica e zbatica, plot ngjarje të dhembshme e plot heronj të heshtur apo të lënë në harresë. Ngjarjet e historisë së këtij shekulli shënojnë dy luftëra botërore, një shpallje të pavarësisë, disa beteja, disa kongrese, disa kushtetuta laike, ateiste e të panjohura ndërkombëtarisht, disa fushata kundër objekteve fetare, kundër personaliteteve fetare-ulemave e hoxhallarëve, personaliteteve fetare të besimeve të tjera të shqiptarëve, disa pushtime e luftëra agresive, të padrejta etj.

Në historinë e shek. XX, kanë jetuar, kanë vepruar dhe janë përpjekur një mori mendimtarësh, predikuesish, ideologë dhe luftëtarë shqiptarë islam. Prandaj, është një ndjenjë drejtësie, një obligim kombëtar e fetar edhe e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, e Bashkësisë Islame të Kosovës dhe Bashkësisë Islame të Maqedonisë që t’i nxjerrim në dritë, t’i vlerësojmë këto figura e personalitete që dhanë një kontribut në lartësimin e fesë islame, në lartësimin e kombit tonë, që na lanë një trashëgimi, një thesar të pasur, e që na bëjnë ballëlartë e krenar gjithherë.

5. Kremtimi madhështor i përvjetorit të dytë të liritimit të Prizrenit, Tomori, nr. 102, Tiranë, 29.IV.1943, f. 2.

6. M. Pirraku, Mulla Idriz Gjilani, Dituria Islame, nr. 49, f. 30.

Me e nda mendjen, o atlet i Krishtit, o hero kombëtar!

Fatos Koplaku M.S.
Universiteti i Michiganit, Ann Arbor, SHBA

Abstrakt

Provincialja nuk ka të drejtë e nuk mund të përmbushë rolin e universales, dhe as universalja nuk mund të burgoset në rajonalizëm pa u vulgarizuar; ideologjitë nacionaliste, e çfarëdo qofshin, nuk mund të zëvendësojnë religjionin, e as kjo e fundit nuk duhet të instrumentalizohet për çikërrima interesash provinciale në kafazin hapësirë-kohë.

Ky reagim nga një mik i hershëm ndaj shërbimit fetar në përrurimin e një statuje të Skënderbeut u bë shkaku, dhe në të njëjtën kohë titulli i këtij shkrimi. Para se të vazhdoj më gjatë dua të shtoj se shkruaj si dashamirës i sinqertë i religjioneve autentike, kësaj flotilje anijesh që, falë Providences, bart e shpëton shpirtat tanë drejt asaj çfarë shpesh quhet në rrëfenja folklorike si *Brigjet e Përtejme*, dhe që në fjalorin e universit religjioz abrahamik i korrespondon Parajsës¹.

1. Për praninë e lidhjes organike të simboleve dhe motiveve folklorike me realitetet shpirtërore të shihen A. K. Coomaraswamy, *Symplegades*, Studies in Comparative Religion, vol. 7, nr. 1 (1973); Martin Lings, *Simboli dhe Arketipi: studim i domethënies së ekzistencës*, përk. & parath. Edin Q. Lohja (Tiranë: Zemra e Traditës, 2012) kreu VIII.

Ajo që më tërheq vëmendjen është koncepti i 'heroit' në përgjithësi, dhe në lidhje me këtë qasja ndaj figurës historike të Skënderbeut kohët e fundit, në veçanti. Brenda këtij konteksti më lejoni t'i ndaj me ju disa mendime.

Etimologjia e fjalës 'hero' vjen nga greqishtja e vjetër, e do të thotë 'mbrojtës'². Megjithatë do të nguteshim nëse do ta kufizonim 'heroin' thjesht në aspektin luftarak. Edhe pse shumë shenjtorë e profetë, p.sh., kanë qenë kryesisht të tërhequr nga jeta e allishverishet e përditshme, ata kanë pasur përpjekjet e tyre kolosale ndaj armiqve të një tjetër lloji – mjafton të kujtojmë djallin, që i ofron botën Krishtit, apo demonin Mara që, përmes bijave të tij, kërkon të joshë Budën – e kjo i bën ata heronj nga një tjetër këndvështrim.

2. Liddell-Scott Greek-English lexicon.

Në një mënyrë, këto shembuj ilustronjë rëndësinë primare të asaj që quhet luftë, përpjekje, e brendshme në raport me të cilën çdo aktivitet e përpjekje e jashtme është vetëm një pasqyrë³. Gjithashtu, është e qartë se askush më pak se një hero i përmasave të një shenjtori a profeti nuk mund të ngadhënjejë karshi kundërshtarëve që përmendëm në shembujt më lart; si shembull le të shërbejë vendimi i Faustit të Goethe-s kur përballet me Mefiston. Pa dashur aspak të reduktojmë përshkrimin e figurave madhore si themeluesit e religjioneve me fjalën ‘hero’, ajo çfarë deshëm të nënvizojmë është se në këtë kontekst, përveç profetëve⁴, që përmendëm më lart, një shenjtorë-murgeshë si Shën Tereza e Avilës apo një shenjtor-poet si Junus Emre, mund të konsiderohen si heronj, edhe pse në jetën e tyre nuk kanë prekur armë me dorë. Heroizmi i tyre konsiston në arritjen e përsosmërisë njerëzore, potenciali i së cilës gjendet te çdo njeri por që është shumë, shumë vështirë të aktualizohet. Ky aktualizim është i mundur në sajë të një hapjeje të vullnetshme nga ana e individit ndaj hirit Hyjnor, e damarët kryesorë (por jo të vetmit) nëpërmjet të cilëve ky hir rrjedh janë tekste të shenjta. Nëse ndër vise e shekuj të ndryshëm nuk ka pasur pishtarë të përsosmërisë, posedues dhe mishërues të shkencës së shenjtë (*scientia sacra*)⁵, e si pasojë edhe rrëfyes të udhës

së shpëtimit për njerëzinë, atëherë fjalë të tilla si shenjtor, savant ose profet, nuk do të ekzistonin sepse nuk do të përkonin me një realitet të prekshëm. Në të kundërt, për të mohuar realitetin e shenjtorëve do të na duhej të deklaronim (jo pa arrogancë), se i gjithë njerëzimi në shekuj, qytetërim pas qytetërimi, ka qenë në halucinacion kolektiv, e vetëm njeriu modern është më afër së vërtetës se kurrë. Meqë një shenjtori e aktualizuar falë recitimit e asimilimit të teorive moderne progresiste⁶ – që pretendojnë se kanë monopolin e qasjes ndaj së vërtetës – nuk është dëshmuar akoma e nuk do të dëshmohet ndonjëherë, atëherë deklarata se shenjtorët nuk ka pasur e s’mund të ketë ndonjëherë realitet, apo në të shumtën e Vërteta për të cilën shenjtorët flasin (ose edhe heshtin nganjëherë) është e paarrtshme, do të na vinte natyrshëm në rolin e dhelpres, që akuzon për të thartë rrushin që nuk mund ta arrijë.

Duke iu kthyer këtë herë karakterit luftarak të fjalës ‘hero’ siç kuptohet zakonisht, duam të flasim këtu – për të shmangur polemikat, që shpesh shoqërojnë luftëtarët historikë dhe rrethanat përkatëse – për heronj jashtë kontekstit historik si Herkulini nga mitologjia greke, Rustem Zalin në atë perse, Shën Gjergjin në universin

realiteti të shihet Seyyed Hossain Nasr, *Knowledge and the Sacred* (Albany: SUNY Press, 1989), kreu VI.

6. Për një ekspozim kritik të natyrës së teorive moderne nga filozofi dhe metafizikani katolik Wolfgang Smith të shihet *Science and Myth: the Hidden Connection*, Sophia: The Journal of Traditional Studies, vol. 7, nr. 1 (2001). Gjithashtu me shumë vlere është edhe vëllimi me punime të zgjedhura nga Mehrdad N. Zarandi (ed.), *Science and the Myth of Progress* (Bloomington: World Wisdom Inc., 2003).

3. Një traditë e njohur profetike e Muhamedit, Profetit të Islamit, na tregon se pasi një grup luftëtarësh u kthyen nga një betejë ai u tha: “U kthyet nga xhibadi i vogël tek xhibadi i madh.” Kur e pyetën se çfarë ishte xhibadi i madh, ai iu përgjigj: “Përpjekja kundër egos (nefsit) tuaj.”

4. Në Budizëm ‘bodhisattva’ i korrespondon ‘profetit’ në religjionet abrahamike.

5. Për një shpjegim të detajuar të këtij termi e

kristian, apo Mujin e eposit tonë dhe atij boshnjak. Për heronj të tillë fronti i luftës së tyre është tjetërsoj, dhe zhvendoset jashtë në fushë-mejdan. Ata përballen me topuzet e bajlozëve, mizëritë e ushtrive, furinë e xhindëve, fuqinë e divave, egërsinë e bishave, kurthet e shtrigave, hilet e shtojzovalleve, xhelozitë e perrive, tekat e sovranëve, e njëmijë e një vështirësi nga më të pakapërcyeshmet. Megjithatë, ka edhe një aspekt tjetër shumë të rëndësishëm në lidhje me bëmat e heronjve të tillë; ato janë të mbushura me simbole⁷ që tregojnë, në thelb, për një rrugëtim të brendshëm shpirtëror. Në kapitullin me titull *Kthimi i Ulksit*, nga vëllimi “Pasqyrë e Intelektit” e autorit zviceran Titus Burckhardt⁸, shpjegohet me kthjelltësi të rrallë se përpjekjet e Ulksit për t’u kthyer tek Penelopa, gruaja e tij, janë temë e pranishme në mitologjinë e folklorin e shumë popujve, ku pavarësisht larmisë së rrëfenjave, gruaja ose princesha ose e Bukura e Dheut (në folklorin shqiptar) është vetvetja⁹ e heroit, e cila duhet të çlirohet nga dragoi që e mban rob, apo nga të huajt që i

7. Në lidhje me gjuhën e kuptimin e simboleve, përveç librit nga M. Lings, *Simboli dhe Arketipi*, që citohet disa herë në këtë shkrim, të shihen edhe Ananda K. Coomaraswamy, *Symbols*, Studies in Comparative Religion, vol. 14, nr. 1&2 (1980); René Guénon, *Language of Birds*, Studies in Comparative Religion, vol. 3, nr. 2 (1969).

8. Titus “Burckhardt”, *Mirror of Intellect: Essays on Traditional Science and Sacred Art*, trans. William Stoddart (Cambridge, England: Quinta Essentia, 1987), kreu XV.

9. Koncepti religjioz tradicional i njeriut nje trupin, veten, dhe shpirtin, ku vetja korrespondon me psiken, egon apo nefsin. Për më hollësi të shihet fq. 15 në parathënien nga Edin Q. Lohja në William C. Chittick, *Shkenjë e kozmosit, shkenjë e shpirtit* (Tiranë: Zemra e Traditës, 2009).

kërkojnë dorën për martesë. Në rastin e Penelopës numri i princave të huaj është 108, një numër aspak arbitrar nëse kemi parasysh se në religjionet e folklorin e Lindjes së Largët korrespondon me gjashtë veset në 18 gradët e tyre¹⁰. Menjëherë kjo e bën tregimin me temë universale, dhe nuk është e vështirë p.sh., të gjinden paralele në gojëdhënat e folklorin e shumë vendeve e popujve. Le të marrim një rast nga eposi, atë të kângës së Gjergj Elez Alisë¹¹.

10. Kambanat për Vitin e Ri në Japoni, sipas traditës Shinto dhe Budizmit, bien 108 herë për të fshirë njollat e veseve nga viti i mëparshëm. Edhe në ishujt e Malajzisë, si p.sh. Bali, ka një sërë ritualesh për purifikimin e 108 veseve që pengojnë rrugëtimin drejt nirvanës.

11. Nëse ka pasur një proces *gradual* të islamizimit të emrave, ku ai i Gjergj Elez Alisë paraqitet si dëshmi, atëherë me të drejtë lind pyetja se pse nuk gjendet gjurmë në folklor e heroit të ngjashëm (a të njëjtë) me emrin Gjergj Prekë Alia (p.sh.), e një tjetër si Gjergj Prekë Dodaj (p.sh.). Një proces i tillë si shpjegim ngjan më shumë si një projektim i mentalitetit imponues të nacional-komunizmit – që ndërroi emrat (e më tej) e një brezi të tërë në mënyrë sistematike – në një mentalitet mesjetar folklorik. Nëse pat një tendencë zëvendësimi emrash, atëherë çfarë ka penguar ndërrimin direkt nga Gjergj Prekë Dodaj (p.sh.) në Xhemal Elez Alia (p.sh.), duke u ruajtur kështu vetëm trajta ‘Gjergj’ përgjatë ‘Elez Alisë’?

Nga këndvështrimi simbolik është e qartë së ‘Gjergj’ korrespondon me një shenjtor-luftëtar (Shën Gjergji), ‘Elez’ (Iljaz, Elijah) korrespondon me një shenjtor-profet, i përbashkët në religjionet abrahamike dhe i pranishëm në folklorin e shumë popujve, dhe në fund tek emri ‘Ali’ gjendet sinteza harmonike e këtyre dy arketipeve. Në Islam Aliu njihet si luftëtar i pashoq me një bujari

Simboli i vetes, i xhanit të tij nuk është nusja në këtë rast, por motra, dhe rolin e 108 princave që kërkojnë dorën e Penelopës e përmbush Bajlozi, taksa e të cilit është "...tim për tim kah një vashë me ja djergun, ditë me ditë kah një kreshnik me premun, javë me javë kah një krahinë me djegun!".

Veset janë ato që çdo ditë zaptojnë xhanin e njerëzve, qofshin edhe kreshnikë, e nëse lihen pa u luftuar shkretojnë popuj të tërë. Ky është thelbi i asaj që na tregohet, sepse përndryshe nuk ka logjikë të na bindë se një i dergjur në shtrat, sëmure për nëntë vjet mund të dalë në dyluftim, e për më tepër të ngadhënjë karshi një bajlozi, apo Uliksi veç me tre katër vetë të tjerë të vrasin 108 princa. Në versione të tjera, tek ai i Shën Gjergjit p.sh., mishërimi i forcave negative kozmike (veset, ligësitë) nuk është një bajloz, por një dragua ose lubi që kërkon haraç vasha e djem të rinj. Arsyeja se pse veset përfaqësohen në folklor nga monstra e bajlozë është se ato mërgojnë njeriun nga Zoti, dhe në sytë e njerëzimit ndër shekuj diçka e

legjendare karshi edhe armiqve të tij, dhe në të njëjtën kohë si burim i diturisë. Një numër disiplinash si teologjia, ekzegjeza (tefsiri), kaligrafia, gramatika (arabe) e retorika, dhe dija ezoterike e gjurmojnë zanafillën tek Aliu ('Unë jam qyteti i diturisë, Aliu është porta' – hadith i profetit Muhamed).

Nga ky prizëm shihet qartë se Gjergj Elez Alia i përket një heroi që mishëron ndërthurjen e këtyre dy natyrave në harmoni, pra të Gjergjit dhe Elezit në Alinë – realitet ky që është akohor dhe ahistorik. Vetëm një realitet i tillë i 'reziston' kohës, sepse është jashtë asaj. Përndryshe Gilgameshët, Odisetë e Dantet nuk do të ishin akoma të pranishëm si objekte të interesit tonë, që nuk shfaq shenjë zbehje edhe pas kaq shekujsh.

tillë nuk është konsideruar si asgjë më pak se shkretim në këtë jetë e në tjetrën. Karshi kësaj gjëme nuk mund të ketë korrektesë politike, dhe për këtë, siç e thamë dhe më lart, folklori i ka veshur veset me rolet e epitetet më të frikshme e të neveritshme. Si rrjedhojë asgjësimi i veseve – ose zbutja e tyre në disa raste, siç do ta shohim pak më poshtë – mbetet thjesht e vetmja zgjidhje, e ata pak që ia arrijnë kësaj veprë kaq të vështirë skaliten në folklor për t'u bërë shembull e frymëzim për breza me radhë. Është shumë i njohur imazhi i Haxhi Veli Bektashit ku ai paraqitet me një luan në një krah e një gazelë në tjetrën. Luani i zbutur është egoja e çliruar nga pasionet e veseve, dhe në poezinë e sufive, simbol i shpirtit është gazela, e cila i afrohet vetëm atij njeriu që ka zbutur, apo paqtuar, egon e vet. Mjeshtri suprem i poezisë mistike Mevlana Xhelaledin Rumi na jep një tjetër simbol, atë të Krishtit mbi gomar, si përfaqësim i shpirtit-intelekt që ka në dorë frenat e egos¹². Ndërsa një tjetër hero folklorik, Hoxha Nasradini, na thotë në thelb të njëjtën gjë, veçse këtë radhë me humor; ndryshe nga gjithë njerëzia, ai i hip gomarit mbrapsht, duke i kthyer kështu shpinën kahut nga sheh e shkon gomari-ego, dhe duke dhënë kështu një mësim për ata që mendojnë.

Këto shembuj mjaftojnë të tregojnë se heronjtë folklorikë nuk janë krijime falë luhatjeve psikologjike e sentimentale të paraardhësve tanë, të diktuar nga rrethana krejt ndryshe me të tonat, e si rrjedhojë pa interes e lidhje me ne sot. Nëse kjo do të ishte e vërtetë atëherë asnjë rrëfenjë e poemë epike

12. Methnevi, Libri II, vargjet 1858-1929.

nuk do të kishte mbijetuar sepse s'do t'i interesonin askujt. Gjithashtu, këto rrëfime e poema, brenda larmisë së tyre, shfaqin një rigorozitet të mahnitshëm në përzgjedhjen e tematikës¹³, që bie ndesh me reduktimin e tyre si spontanitete thjesht për argëtim. Në thelb ato tregojnë për një Realitet Suprem, rruga drejt të cilit ka shumë pengesa, të ilustruara shpesh si bisha e monstra, hile e kurthe, e ata guximtarë, që ia dalin mbanë këtij rrugëtimi bëhen heronj të denjë për pavdekësinë, e pishtarë për shpëtimin e njerëzimit. Paaftësia e rrokjes së thelbit të mesazhit të folklorit është shoqëruar me indiferentizëm dhe përçmim në rrethe akademike e më gjatë. Një qëndrim i tillë është analog me qasjen e fundamentalistëve religjiozë ndaj teksteve të shenjta, të cilët i reduktojnë thjesht në kuptimin literal, pra sipërfaqësor. Ky qëndrim nuk është tjetër vetëm se një projektim në sferën e religjionit i botëkuptimit materialist, i cili njeriun e redukton në një grumbull indesh e kockash – pra në anën sipërfaqësore – e i mohon dimensionin e brendshëm shpirtëror, atë më të rëndësishmin; pra vetë thelbin e tij.

Dy arketipet e heronjve, shenjtori dhe luftëtari, korrespondojnë me atë çfarë njihet si përpjekje e madhe dhe përpjekje e vogël, e brendshme dhe e jashtme, e që në Islam i korrespondon xhihadit të madh e xhihadit të vogël. Megjithatë duhet të theksojmë se edhe një figurë shenjto-reprofetike si Krishti nuk është e divorcuar nga karakteri

luftarak (që nuk do të thotë doemos ushtarak). Mes të tjerave ai na thotë: "... nuk erdha të sjell paqen, por shtatën"¹⁴. Le të rikujtojmë se Krishti, me kamxhik në dorë, përzuri matrapazët e fajdexhinjtë nga Tempulli i Jeruzalemit¹⁵, duke na dhënë kështu edhe një tjetër udhëzim; ligësitë nuk mund të tolerohen në emër të mirësisë, e as gënjeshttrat në emër të së vërtetës; ato duhet të luftohen e përzihen nga zemra-tempull, e kjo është, me një fjalë, edhe esenca e mesazhit të xhihadit të madh. Nga ana tjetër, edhe për heronjtë luftëtarë jo gjithçka është betejë e përpjekje; në çdo pengesë ata kërkojnë prehje, udhëzim a falje me përgjërime të denja për murgj, çka dëshmon praninë e një prirjeje introspektive ndër ta. Gjithashtu, duhet të shtojmë se ka dhe një tjetër kategori të rëndësishme figurash madhore, të cilët mishërojnë ndërthurje në harmoni të plotë të dy përpjekjeve, asaj të jashtme e të brendshme. Këtu bëjnë pjesë profetët semitikë si Davidi (Davudi), Solomoni (Sulejmani), Moisiu (Musai) dhe Muhamedi, të cilët përveç rolit të tyre si liderë shpirtërorë e si bartës të Mesazhit Hyjnor ishin të obliguar të përmbushnin gjithashtu obligimet si liderë socialë, politikë e ushtarakë.

Ngjizja e frymëzimit, shpresës dhe magjepsjes së njerëzimit nga heronj të tillë (profetikë e folklorikë), edhe pse jehona e shumë prej tyre na vjen nga shekuj e mijëvjeçarë larg, nuk është shuar aspak por është e pranishme akoma. Si shpjegohet kjo prani e idealit

14. Mateu 10:34.

15. Rreth gjashtë shekuj më vonë, një tjetër profet, Muhamedi, me shkop në dorë rrëzon putat, duke pastruar kështu një tjetër tempull, Qabënë.

13. Në lidhje me këtë temë shpesh të keqkuptuar të shihet Rama Coomaraswamy (ed.) *The Essential Ananda K. Coomaraswamy* (Bloomington, Indiana: World Wisdom Inc., 2004) Kreu XVI.

të heronjve në jetën tonë? Në librin “Simboli dhe Arketipi”, shkrimtari, poeti dhe dijetari Dr. Martin Lings, nënvizon disa nevoja të patjetërsueshme shpirtërore për njeriun, pavarësisht nga përkatësia e racës, vendit apo kohës që jeton. Mes të tjerave ai përmend edhe nevojën universale për takimin, të paktën një herë në jetë, me një përfaqësues autentik të përsosmërisë njerëzore, apo një shenjtor, siç njihet me gjuhën popullore¹⁶. Frytet e një takimi apo të pranisë së një shenjtori janë të pallogaritshme, dhe për këtë arsye në shoqëritë tradicionale¹⁷ të çdo religjioni autentik, shenjtorëve jo vetëm u është rezervuar respekt i thellë, por edhe janë imituar e u janë thurur himne e lavde. Arsyeja është se imitimi i shenjtorëve konsiderohet litar mëshire nga Realiteti Suprem, e bashkë me ritualet e adhurimit ndihmon njeriun të çlirohet nga rëndesa e ekzistencës tokësore, të rikujtojë se është thjesht i mërguar në këtë botë, dhe është udhërrëfyes në rrugëtimin e tij drejt asaj Origjine prej nga ka ardhur. Ndërsa lavdet e himnet drejtuar profetëve e shenjtorëve, nga pikëpamja religjioze tradicionale, janë jehonë që i kthehet vetë thirrësit, besimtarit në pëshpëritjet e devotshme, apo dhe përpjekjet e përditshme, dhe nuk është profeti apo avatari, që ka nevojë për himnet, por recituesit e

tyre. Imagjinoni një hânë të plotë mbi një liqen të qetë, dhe papritmas, ndërsa kundrojmë këtë bukuri, një “ah” na del vetvetiu nga zemra, ndoshta edhe ndonjë varg i njomur në mall. Kjo thirrje, ky “ah”, nuk i shton (apo i heq, në rast se e injorojmë këtë pamje) asgjë bukurisë, që po dëshmojmë, e as hâna, e as liqeni nuk kanë nevojë për “ah”-un tonë, për konfirmimin prej nesh, që të ekzistojnë. Zgjedhja jonë që të njohim këtë bukuri, e si rrjedhojë reagimi ynë ndaj saj, është pjesëmarrje në këtë realitet. Kësisoj njohja e së Bukurës, tërheqja (që përkon me dashurinë) drejt Saj, dhe pjesëmarrja apo shkrirja në Të, është shpërblimi me i madh për çdo njeri. Nëse citojmë thënien e njohur të Platonit, “Bukuria është shkëlqimi i së Vërtetës”, kjo njohje e së Bukurës bëhet edhe obligim për njeriun.

Kuptohet, themeluesit¹⁸ e religjioneve janë shenjtorët *par excellence*, dhe natyrisht janë më të imituarit e më të lëvduarit nga besimtarët. Murgjit e krishterë, p.sh., që shmangin botën e preokupimet e saj në thelb imitojnë Krishtin që thotë: “Mbretëria ime nuk

18. “Themelues religjioni” nuk do të thotë asesi ‘sajues’, dhe këtu nuk kemi të bëjmë me diçka që diktohet nga egoja dhe pasionet. Përkundrazi, themelimi i religjioneve nga ata profetë që ishin caktuar për misione të këtyre përmasave ishte përputhje e plotë me Providencën Hyjnore. Është ajo “hapje ndaj Hyjnores”, siç e përmendim në këtë shkrim, që i transformon profetët në transmetues të hirit dhe udhëzimit Hyjnor. Në doktrinën Islame mund të thuhet se kjo “hapje” korrespondon, në pjesën e dytë të Dëshmisë, me titullin “abduHu”, pra “rob i Zotit”, që tregon për një dorëzim të vetëdijshëm ndaj Vullnetit Hyjnor. Ky dorëzim ndaj Hyjnores, në të njëjtën kohë e bën profetin mëkëmbës të Zotit në tokë (khalife), dhe korrespondon me titullin “resuluHu”, i dërguar i Tij.

16. Martin Lings, *Simboli dhe Arketipi: studim i domethënies së ekzistencës*, përk. & parath. Edin Q. Lohja (Tiranë: Zemra e Traditës, 2012) kreu V.

17. Për një shpjegim më të detajuar të termit “traditë” të shihet Seyyed Hossain Nasr, *Knowledge and the Sacred* (Albany: SUNY Press, 1989) kreu II; gjithashtu të shihet parathënia nga Edin Q. Lohja në Sejjid Husain Nasr, *Udhërrëfyesi i të riuat mysliman në botën moderne* (Tiranë: Zemra e Traditës, 2007).



është e kësaj bote.”¹⁹ Në Lindjen e Largët për shekuj me radhë, që nga murgjit, perandorët, gjeneralët e deri tek njerëzit e thjeshtë, poza më e njohur e meditimit është imitimi i qëndrimit të Budës në çastin e Iluminimit. Ndërsa për myslimanët imitimi i Profetit të Islamit, Muhamedit, ravijëzon kornizën brenda së cilës jeta duhet jetuar, duke filluar që nga aktivitete në dukje të rëndomta si të përkujdesurit ndaj macës së shtëpisë, e deri tek mënyra se si i është falur Zotit. Por imitimi i profetëve a shenjtorëve nuk do të thotë mjaftim vetëm në anën sipërfaqësore të jetës e sjelljes së tyre. Përkundrazi, veprimet e tyre shihen si rrezatim i përsosmërisë së brendshme, esenciale, dhe eventualisht si mjet për t’iu qasur e përshtatur kësaj përsosmërie.

Një e vërtetë si ajo që thamë më lart do të kishte qenë lehtësisht e qartë për brezat e hershëm, ndërsa njeriu modern, i rrethuar në mënyrë sistematike nga shpërqendrimet konkurruese, cerebrale

19. Gjoni, 18:36.

e emocionale, ka humbur pothuajse krejtësisht aftësinë e mendimit mbi esencialet, aq sa edhe t’u vejë në dyshim ekzistencën. Për këtë arsye po sjellim një shembull të thjeshtë nga sporti, i cili bashkë me industrinë e argëtimit (muzika, kinemaja, etj) zë vend qendror në botën moderne, e si rrjedhojë është kollaj i prekshëm si fakt e vështirë të kundërshtohet. Në sportin më popullor të globit, futbollin, p.sh., një Pele, një Maradonë apo një Zidane, përkon me një përsosmëri, kuptohet e kufizuar thjesht në këtë sport. Madje, mund të shtojmë se lojtarë të tillë janë të rrallë sepse janë mishërim i një sinteze harmonike mes forcës, agresivitetit e vendosmërisë nga njëra anë, dhe zhdërvjelltësisë, finesës e improvizimit, pra krijimtarisë, në anën tjetër – një *yin dhe yang*²⁰ në fushën e blertë. Dhe shpesh dëgjojmë nga lojtarë të rinj e veteranë se si identifikojnë si rol-modele për t’u imituar lojtarë të përmasave të tilla. Shembuj paralelë mund të gjinden pa vështirësi në fusha e disiplina të ndryshme, qoftë art, biznes e akademi; imitimi qenka i pranishëm kudo. E askush nuk mund të ofrojë në logjikë të shëndoshë – vazhdojmë me shembullin – sugjerimin se meqë shumica dërrmuese e sportistëve nuk mund të arrijnë majat e lojtarëve që përmendëm më lart, ata të mos e aspirojnë atë përsosmëri e të kënaqen me mediokritet. Nga ky paralel duhet parë në çdo religjion ortodoks, imitimi i shenjtorëve e savantëve, të cilët janë mishërime të një përsosmërie esenciale, që është një konformim i aktualizuar

20. Simboli universal i dualitetit në harmoni i njohur si *yin yang* në Taoism, në formën e dy presjeve, apo vorbullave, që puqen njëra me tjetrën.

ndaj udhëzimeve të zbritura me dekret apo frymëzim Hyjnor, e njëkohësisht edhe pasqyrim e dëshmi e atij Realiteti.

Imitimi, pra, nuk është anti-origjinalitet, përkundrazi. Sot në botën moderne opinione të tilla jo rrallë injorohen, apo edhe shihen si mbeturina të një mentaliteti të vjetruar (sikur mentaliteti është diçka që mund të vjetrohët apo rinohet), e që nëse lejohet edhe pak kohë, njerëzimi dalëngadalë do i lërë pas këto të ashtuquajtura besëtytni. Por a është me të vërtetë kështu? Dr. Lings, nga një këndvështrim rigoroz tradicional, na tregon se nevoja për të imituar përsosmërinë, takuar një mishërim të përsosmërisë ose thurur homazhe devocionale përsosmërisë (Budës, Shën Mërisë, Muhamedit) është diçka e ngulitur në natyrën e çdo njeriu²¹. Ne mund ta mohojmë këtë, por kjo nuk do të thotë se kjo nevojë do të vdirret se ne i mohojmë ekzistencën. Përkundrazi, ajo thjesht do të drejtohet kah një tjetër objekt, e në mungesë të një shembulli autentik do të imitojë përsosmëri të rreme, nëse mund të shprehemi kështu. Shembuj ka plot: miliona djem e vajza kanë modeluar e modelojnë flokët e veshjet duke imituar idhujt e tyre të muzikës apo artit; intervistat e shumta të njerëzve të famshëm²² gëlojnë me pyetje të rëndomta rreth orarit, p.sh., se kur ata zgjohen në mëngjes, çfarë diete ndjekin

21. Shih referencën 16.

22. Të kihet parasysh se fama dhe sukcesi janë kritere të mangëta, për të mos thënë të gabuara, si dëshmi të përsosmërisë. Gjithashtu duhet të theksohet se kjo nuk do të thotë se fama e sukcesi janë në antagoni me praninë e përsosmërisë. Një shenjtor, falë kësaj përsosmërie, mund të ketë famë e emër, por këto të fundit janë rrjedhojë e shenjtërisë, dhe jo e kundërta; shenjtori nuk kërkon famë.

etj, sepse me apo pa dashje pyetësit duan të imitojnë atë që e *perceptojnë* të përsosur. Tjetër shembull është krenaria, që ndiejnë njerëzit kur dalin në foto, shpesh pas orëve të tëra pritjeje, me njerëz të famshëm, ose turmat që përlohen nëpër koncerte apo përreth tapeteve të kuq sa duken këngëtarët apo aktorët e preferuar. Kjo dëshirë për të qenë pranë, dhe për t'i ngjarë një modeli që e perceptojmë si të përsosur, nuk haset vetëm në sferën e artit e sportit, sepse edhe politika, letërsia apo akademia kanë rol-modelet përkatës që ndiqen jo me më pak devotshmëri. Çfarë ka ndryshuar është se sot shumë prej nesh nuk imitojmë e kërkojmë përgjigjet nga jeta e shenjtorëve e profetëve (rol-modele të vërtetë), siç ka bërë njerëzimi në shekuj, por prej rol-modeleve jo-autentikë (shenjtorë të rremë). Mendja nuk mund të rrijë bosh. Nëse nuk ngopet me të vërtetën, do të përpiqet të ushqehet me të rremen, e si rrjedhojë rrezikon të mbesë e uritur gjithë jetën.

Ky proces-zëvendësim, kjo përmbysje-parodi e vlerave tradicionale, të cilat janë të gdhendura me udhëzim e frymëzim Hyjnor, ka filluar (dhe vazhdon akoma) gradualisht në Evropën Perëndimore – falë desakralizimit të diturisë²³ – në emër të formulimeve të ndryshme ideologjike, për arsye që janë jashtë temës së këtij shkrimi. Pjesa tjetër e botës – pa lënë mënjanë efektin imponues të kolonializmit që preku pothuajse çdo cep të globit – shpesh krejt verbërisht e pa menduar gjatë,

23. Për një analizë filozofike të kësaj teme delikate, por shumë të rëndësishme, të shihet Seyyed Hossain Nasr, *Knowledge and the Sacred* (Albany: SUNY Press, 1989), kreu I.

imiton këtë proces të zëvendësimit të vlerave, e hipnotizuar plotësisht nga superioriteti teknologjik, financiar e ushtarak perëndimor. Si pasojë, çdo mendim, qëndrim e jetë-stil, që nuk redukton aspiratat e individit e shoqërisë njerëzore në këtë përkufizim (tejet të ngushtë) progresi horizontal etiketohet si pengesë, e injorohet, përçmohet apo luftohet, në varësi të rrethanave. Ky është një tjetër shembull – këtë radhë në rang shoqëror, institucional e politik – se si imitohet ajo që perceptohet (pavarësisht në është apo jo) si përsosmëri.

Në rastin e përvojës së regjimeve totalitare, kjo përmbysje vlerash ishte e menjëhershme, e dhunshme dhe nga një pikëpamje, e pariparueshme. Përvoja e Shqipërisë është ndoshta më e qarta se si sentiment i religjioz, që buron nga një intuitë e brendshme e njeriut drejtuar kah e Vërteta u uzurpua agresivisht – nuk mund të gjendet fjalë më e zbutur nëse duam t'i qëndrojmë besnikë së vërtetës – për t'u vënë në shërbim të shtetit dhe ideologjisë së tij. Ideali nacional-komunist krijoi një 'katedrale' virtuale ku vendin e shenjtorëve e zunë ata që, shpesh në mënyrë arbitrare, u quajtën etërit e dëshmorët e kombit²⁴, ndërsa atë të shpëtimtarit për të cilin kombi paskësh pritur që se kur koha ishte kohë e zuri kryetari ose themeluesi i shtetit. Portretet e bustet (ikona sekulare) e

24. Këtu nuk po aludojmë nevojën për një revolucion të ri vlerash. Revolucion i *vetëm* që ia vlen të përkrahet është ai i vetvetes. Gjithashtu, është e qartë se shumë figura historike shqiptare nuk do të ishin dakord me paraqitjen e interpretimin e veprës së tyre jashtë kontekstit. Megjithatë, përvoja shqiptare nuk është e izoluar dhe ka paralele jo vetëm në shtetet fqinje, por edhe në shumë vende të globit, pavarësisht nga orientimi politik.

këtyre “shenjtorëve” të rinj mbushën sheshet. Mund të thuhet se vendin e liturgjisë e zunë retorikat e himnet nacionaliste dhe fjalimet e vëllimet e udhëheqësve të shtetit. Nuk flasim thjesht për Enver Hoxhën, sepse paralele të tilla hasen edhe në të tjera vende. Në fakt, kjo ishte një vazhdimësi logjike e ideologjisë nacionaliste – jo vetëm në Shqipëri kuptohet – në emër të së cilës u thurën himnet e para kombëtare, recitimi e mësimi përmendsh i të cilave u kthye në obligim të çdo shtetasi, e që në thelb nuk ishte gjë tjetër veçse një uzurpim direkt i devotshmërisë, që tradicionalisht njerëzit e kanë rezervuar për psalmet e tekstet e shenjta. Bajramet e Pashkët ia lëshuan vendin (me pahir) festave që glorifikonin ideologjinë zyrtare të shtetit, themelime grupesh a partish apo data lindjesh e vdekjesh të njerëzve që, nëse i qëndrojmë narrativit të kohës, individit dhe populli u kishte borxh gjithçka, edhe jetën. Madje edhe imazhe heronjsh mitikë u përçudnuan në mënyrë tragji-komike. E ngjashme edhe me afishe të prodhuara nga të dy palët luftuese gjatë Luftës së Dytë Botërore, nazi-fashistë e aleatë, poza e Vojo Kushit hipur mbi tank me granatë në dorë është një imitim patetik i ikonave të Shën Gjergjit kalëruar, që ka vënë poshtë dragoin. Ndërsa ky i fundit përkon me një realitet shpirtëror, të tjerat janë imitime boshe të sterilizuara nga çdo kuptim e vlerë përveç asaj propagandistike. Pelegrinazhi²⁵, një ritual i lidhur ngushtë me rrugëtimin

25. Për një shpjegim më të thelle të kuptimit të pelegrinazhit drejt Qendrës – së jashtme e të brendshme – të shihet Martin Lings, *Sufizmi*, përk. & parath. Edin Q. Lohja, (Tiranë: Zemra e Traditës, 2010), fq. 27.

njerëzor, siç shprehet një dijetar i sotëm, ‘nga periferia e ekzistencës drejt Qendrës’, dhe i pranishëm në çdo religjion, u zëvendësua nga vizitat në shtëpitë e mbledhjeve të para të partive që paskëshin hedhur farën e shpëtimit të kombit. Vizitat e faltoreve, mauzoleumeve, apo vendeve të shenjta u zëvendësuan me vizitat e dhomave-muze apo varreve të idealistëve a luftëtarëve, që shteti i konsideronte si zanafillën e vet. Lista është e gjatë, por le të themi se ky zëvendësim vlerash haset jo vetëm në regjimet totalitare, por edhe në shtetet moderne perëndimore; vizitat e shtëpisë-muze së Elvis Presley-t, apo e varrit të Jim Morrison-it, që s’janë tjetër veçse pelegrinazhe “shenjtorësh” modernë, sot jo vetëm shihen me simpati, por edhe glorifikohen me dokumentare e botime shumë më tepër se vizitat e varreve të shenjtorëve të vërtetë. Ndryshimi është se në shtetet e sotme moderne perëndimore, në dallim nga përvoja e bllokut Lindor, religjioni, shumicën e rasteve, nuk sulmohet direkt fizikisht nga shteti. Sidoqoftë, le të ndalemi këtu pasi mendojmë se shembujt e mësipërm ilustrjnë më së miri atë çfarë identifikuam si uzurpim të botëkuptimit religjioz dhe projektim artificial në një rrafsh ideologjik njerëzor, dhe manipulimin e transformimin e zellit e devotshmërisë religjioze në një zell e besnikëri ndaj shtet-kombit.

Religjioni – fjalë që vjen nga latinishtja, ‘re-ligare’, pra ri-lidhje – nënkupton dhe presupozon një shkëputje nga Hyjnorja që ka ndodhur në një kohë të pagjurmueshme nga historia, e që në literaturën e religjioneve abrahamike njihet si Rënia nga Edeni.

E dekretuar me udhëzim Providencial nëpërmjet feve të ndryshme, kjo ri-lidhje është e mundur në sajë të njohjes e vullnetit – të cilat përkojnë me doktrinën dhe përmbushjen e ritualit e përmbajtjes ndaj ligjit – të mbështetura *doemos* nga kultivimi i virtyteve. Përjetimi i këtyre udhëzimeve të religjionit mundëson një transformim alkimik te njeriu, transformim që lejon ri-lidhjen me Hyjnoren, e si rrjedhojë edhe rrezatimin e hirit që buron prej Saj. Nuk është e rastësishme që përherë shenjtorët janë përshkruar si qenie me hir, prani e hijeshi të pashoq. Por, as teoritë që gjithçka të pakuantifikueshme e mohojnë, ose më së shumti e reduktojnë në një dimension materialist horizontal (qasjet më “optimiste” – Jung et al. – e njohin rrafshin psikologjik thjesht si tejzgjatje të materies dhe pa ngurrim e reduktojnë Shpirtin në këtë rrafsh, pra në ego), as glorifikimet e himnet për partitë, ideologjitë apo sport-klubet, as absolutizimi metodik i realiteteve fragmentare empirike, politike e historike, as reduktimi i virtyteve në dikotominë e vakët “më pëlqen, s’më pëlqen”, nuk kanë pasur e nuk do të kenë ndonjëherë dobi për njeriun. Përkundrazi, ato kanë shkaktuar një krizë vlerash globale me pasoja serioze jo vetëm individuale e shoqërore, por madje edhe ekologjike, të përmasave të tilla që kërcënojnë të ardhmen e vetë njerëzimit²⁶.

Në vazhdimësi të atyre që thamë më lart duhet të shihet edhe hyjnizimi i figurës

26. Në lidhje me krizën ekologjike si pasqyrim i degradimit dhe krizës shpirtërore të njeriut modern të shihet Seyyed Hossain Nasr, *Man and Nature: The Spiritual Crisis of Modern Man* (Scranton, PA: HarperCollins, 1991).

historike të Skënderbeut. Përzgjedhja e fjalës “hyjnizim” justifikohet natyrshëm nëse marrim parasysh reagimet me një dozë të konsiderueshme historie ndaj disa autorëve të studimeve kritike të periudhës së Skënderbeut vitet e fundit. Në kohën e monizmit ai ishte një ‘hyj sekular’; ky togfjalësh është një paradoks në vete, por aspak diçka e papritur, përkundrazi, pasqyron më së miri një epokë të tërë. Tani, hyjnizimi i Skënderbeut (të kuptohemi, nuk është faji i Skënderbeut këtu që është piketuar arbitrarisht) vazhdon krejt qartë në të njëjtat linja nacional-komuniste, por këtë radhë me petk të krishterë-katolik, e vend të lavdeve nacionaliste i thuren urata e mbahet meshë për të. Doemos, në thelb ka një qëllim të fisëm në këtë, ku veshja e Skënderbeut në një rol luftëtari të fesë katolike presupozon ftesën, indirekt, për kthim të shqiptareve në Krishtin. Por sado i fisëm të jetë qëllimi, nëse kleri katolik nuk mundet të shprehë haptazi se Krishti është Rruga drejt Shpëtimit (e Dijes), e ta jetojnë një të vërtetë të tillë, por kërkohet që nëpërmjet fabrikimeve nacional-komuniste të veshura me petk religjioz të thërrasë shpirtat në shpëtim, atëherë me të vërtetë vajmedet!!! Kjo është një dëshmi e dhimbshme e degradimit të të kuptuarit e të jetuarit të një religjioni të lashtë që ka ndriçuar me mijëra shpirta me dritën e vet, dhe në të njëjtën kohë është pjesëmarrje aktive në zbehjen e mëtejshme të mesazhit thelbësor të saj.

Ja një shembull i dhimbshëm i kësaj zbehjeje, që për fat të keq i gjendet analogu kollaj dhe në religjione të tjera; në librin “Pse ka rëndësi Religjioni”²⁷

27. Huston Smith, *Why Religion Matters: The Fate*

autoriteti i njohur amerikan i historisë së religjioneve Huston Smith, mes të tjerave citon një autoritet të shkollës filozofike të Shën Toma Akuinit, një Tomist, i cili pohon: “Mund – dhe vetëm *mund* – të jenë veç dymbëdhjetë vetë sot në botë që kuptojnë më të vërtetë Shën Tomain, e unë nuk jam një prej tyre.” Ky kolos intelektual e shpirtëror i Krishterimit ishte një nga ata njerëz të rrallë që jo vetëm kishin dije, por edhe *ishin* dije²⁸. Mes qasjes intelektuale depërtuese të Shën Toma Akuinit ndaj religjionit dhe qasjes së klerikëve që aprovojnë e adoptojnë manipulime nacional-komuniste për të shpëtuar shpirtat ka një humnerë të pakapërcyeshme. Meqë është vështirë të thuhet se Skënderbeu mishëron aktualizimin e arketipit të shenjtorit-luftëtarit-hero – përndërimi i të cilit, siç treguam gjatë këtij shkrimi, është i integruar natyrshëm në një religjion tradicional – ka shumë gjasë që kjo soj qasje ndaj figurës së tij është e privuar nga hiri kristian. Për sa i përket ‘hirit nationalist’, ai mund të ekzistojë si togfjalësh por nuk ka, e s’mund të ketë, realitet përkatës. Megjithatë, Mëshira Hyjnore është Gjithpërfshirëse, e sidomos edhe më tepër në këtë periudhë ku kakofonia e ideologjive nga më të papranueshmet kërkon të mbyset zërin e së vërtetës.

Nëse mund të quhet “ngushëllim”, të gjitha doktrinat fetare janë unanime në lidhje me efektin e faktorit kohë, e me

of Human Spirit in an Age of Disbelief (New York, NY: HarperCollins, 2001) pg. 65-66.

28. Fjala për diturinë ose urtësinë në latinisht është ‘*sapientia*’, dhe e ka rrënjën nga ‘*sapere*’ që do të thotë ‘*me shijue*’. Nga ky këndvështrim tradicional dituria nuk është thjesht aktivitet cerebral ku njeriu që di dhe dija janë të shkëputura; dituria kur ‘shijohet’ ka efekt transformues.

“plakjen” e njerëzimit, dhe problemi i zbehjes së të kuptuarit të mesazhit të tyre nuk është aspak diçka e re dhe e papritur, por një nga shenjat e fundit të ciklit njerëzor²⁹. Kështu, edhe besimet e tjera po vuajnë pasojat e rënda nga infiltrimi agresiv i ideologjive profane nën petkun religjioz, e një nga dëshmitë më të qarta është lindja e fundamentalizmit, – islamik, kristian, çifut, budist etj. – diçka krejt pa precedent në sferën e religjionit tradicional ndër shekuj. Si rrjedhojë, janë krijuar shartime ideologjike nga më të çuditshmet e të rrezikshmet, me pasoja shumë serioze për të ardhmen e religjioneve. Pak kohë më parë më qëlloi të lexoj një shkrim nga një përfaqësues bektashi ku deklarohet se Skënderbeu paska qenë misionari i parë i bektashinjve në Shqipëri. Nuk e di nëse është tepër vonë dhe është hapur kutia e Pandorës, e nuk dua të imagjinoj çfarë mund të vijojë më pas nëse të gjithë përfaqësuesit e komuniteteve fetare në Shqipëri pozicionohen në mënyrë të ngjashme, duke përdorur Skënderbeun, a këdo tjetër qoftë, për të instrumentalizuar figurat historike e për t’u imponuar, në mënyrë të ngjashme me ideologjinë zyrtare gjatë monizmit, si ideologji dominuese. Ky do të ishte dëmi më i madh që mund t’i bëhej religjioneve dhe do të ishte provë që viktimat – vetë ne shqiptarët – akoma nuk janë çliruar nga përvoja e abuzimit

29. Sipas eskatologjisë budiste, p.sh., flitet, mes të tjerave, për një degradim gradual të njerëzimit; koha pas vdekjes së Budës ndahet në tre epoka, e në të parën mësimet e Ligjit (Dharma) do të jetohej, në të dytën thjesht do të imitohen, e në të tretën e të fundit të kuptuarit e Ligjit do të jetë zbehur në atë shkallë sa do të mbizotërojë injoranca.

totalitar nëse vazhdojnë të shfaqin të njëjtën prirje shterpë për uniformizim me çdo kusht.

Provincialja nuk ka të drejtë e nuk mund të përmbushë rolin e universales, dhe as universalja nuk mund të burgoset në rajonalizëm pa u vulgarizuar; ideologjitë nacionaliste, e çfarëdo qofshin, nuk mund të zëvendësojnë religjionin, e as kjo e fundit nuk duhet të instrumentalizohet për çikërrima interesash provinciale në kafazin hapësirë-kohë. Kushdo që merr pjesë me ndërgjegje si në njërin a tjetrën është ose i papërgjegjshëm (dhe injorant) – qëllimi i mirë rrallë është i vetë-mjaftueshëm – ose ofendohet personalisht nga prania e së Vërtetës, e kërkon ta mbulojë atë.

Meqë përmendëm Skënderbeun disa herë desha të cek disa argumente që serviren shpesh, por që, për mendimin tim, kane defekte serioze në zinxhirin logjik. Arsyeja se pse hyjnizohet Skënderbeu paraqitet si e thjeshtë; ai ka luftuar kundër osmanlinjve (lexo Islamit) dhe ka mbrojtur Arbërinë, e cila shpesh njësohet me Krishterimin, dhe se Papa Piu i II-të i ka dhënë titullin “*Athleta Christi*”. Por, kur ky narrativ zhvendoset në platformën nacionaliste shqiptare na jep këtë tablo: një luftëtar feudal mesjetar nis karrierën ushtarake në Stamboll e pas 20 e më tepër vitesh kthehet në provincën e dikurshme të të atit, ndërsa mban një emër mysliman (Skënder) e titull po ashtu mysliman (bej), bëhet ‘kampion i Krishtit’, dhe falë një ideali nationalist – rreth tre shekuj para se të lindë nacionalizmi – vendos të krijojë shtet-kombin shqiptar... Një narrativ i tillë mund të quhet shumë gjëra, por vetëm koherent jo.

Bashkangjitur me këtë narrativ është sjellë shpesh sugjerimi, direkt ose indirekt, se meqë *dikur* kemi qenë të gjithë të krishterë (nuk mund të thuhet katolikë sepse kemi qenë kryesisht ortodoksë), atëherë le të kthehemi në fenë e të parëve. Argument jo pa probleme ky; nëse *dikur* bëhet pikë referimi në vetvete atëherë logjika na imponon ta përdorim kudo. Në këtë mënyrë mund të argumentohet natyrshëm se meqë *dikur* shumica e shqiptarëve ishin komunistë, atëherë është e këshillueshme kthimi në atë realitet. E zëmë se e shtyjmë më tej, virtualisht, kohën e shkojmë në shekullin e XII-të sepse në atë *dikur* ishim të gjithë të krishterë. Por logjika nuk e lejon këtë argument të ndalet këtu. Para lindjes së Krishtit në ato vise ka pasur tjetër religjion, e ky argumenti *dikur*, i pavarur nga gjithçka, na fton drejt saj. Kuptohet, para atij religjion ka pasur një tjetër, e kështu me radhë në pambarim. Të insistosh që *dikur* të përdoret si argument arbitrarisht thjesht në një rast, kur shumica ishim të krishterë, e në asnjë tjetër rast nuk është as më pak as më shumë se sentimentalizëm. Nuk flasim për ndjenjat fisnike që lindin si reagim ndaj së vërtetës, por për ndjenjat e papjekura që kërkojnë të lakojnë të vërtetën për t'iu përshtatur atyre.

Një tjetër pikë është ideja e “Shqipërisë”, “Arbërisë”, “Turqisë” etj, në shekullin e XV-të. Është diskutuar aq shumë sa nuk ia vlen të zgjatet tepër. Por le të themi se as Shqipëria, as Italia, as Greqia, as Turqia nuk kanë ekzistuar në ato shekuj që po bëjmë fjalë; as ekzistencë fizikisht, e as konceptualisht. Gjithashtu, Italia moderne nuk është

pasardhëse e Romës, as Greqia moderne e Bizantit, e as Turqia moderne e Osmanëve. Madje mund të thuhet pa frikë se Perandoria Romake, Bizantine e Osmane – një Romë pagane, një Romë e krishterë, dhe një Romë myslimane – ngjasojnë në aspekte esenciale shumë më tepër me njëra tjetrën sesa me shtetet moderne përkatëse³⁰. Dhe anasjelltas, këto të fundit ngjasojnë shumë më tepër me njëra tjetrën se me perandoritë, tokat e të cilave trashëguan (pjesërisht). Pra, të flasësh për “Shqipëri”, “Itali” ose “Turqi” në mesjetë është një anakronizëm dhe një pohim i gabuar në themel, e që nëse merret si i qenë, na çon, si pasojë, vetëm drejt konkluzioneve të gabuara.

Një tjetër pohim shumë i ngutur – po tregohemi bujarë me epitetin – është ai i “aksidentit historik” në formën e sundimit osman të trojeve shqiptare. Aksidenti presupozon diçka që ndodh rëndom, pa qëllim, e pa ndjekur një rrjedhë logjike. Në linjë me këtë përkufizim, aksident do të ishte

30. Me ‘Romë’ kemi parasysh një hapësirë civilizimi me përmasa universale ku larmia – individuale, shoqërore, etnike, kulturore, religjioze etj. – është edhe pasqyrim i legjitimitetit të sovranit. Ky i fundit sundon me mandat dhe miratim të Vullnetit Hyjnor, e mban rregullin që ruan e ushqen këtë larmi që është manifestim i vetë Hyjnore; të kihet parasysh se asnjë Faraon, Çezar, Perandor apo Sulltan nuk është kurorëzuar pa praninë dhe dorën e një autoriteti të lartë fetar. Në këtë aspekt thelbësor shtetet pre-moderne janë shumë më të ngjashme me njëra tjetrën sesa me shtetet moderne që u krijuan më vonë në të njëjtat hapësira gjeografike. Një ngjashmëri thelbësore e komb-shteteve moderne është tendenca e tyre sistematike uniformizuese (një komb, një gjuhë, një religjion, një program arsimor, një orar pune etj.) krejt në antitezë me shtetet-premoderne.

sikur në viset shqiptare do të mbinte nga dheu Tokugawa Iejasu, e të formonte shogunatin e tij në brigjet e Adriatikut e jo në Japoni, ndërkohë pa qenë as ai vetë i vetëdijshëm për këtë. Diçka e tillë mund të quhet në mënyrë legjitime një aksident. Por nuk mund të pretendohet logjikë në etiketimin si “aksident” të sundimit të dinastisë së Osmanëve. E shtrirë në tre kontinente, që nga Evropa Qendrore në Afrikën Veriore, e nga Gjiri Persik deri në stepat e Azisë Qendrore, ajo ishte dinastia më jetëgjatë në historinë e shkruar të njerëzimit (1299-1923), ku çdo fushatë, ligj, kanun, ndërtim, rrugë, marrëveshje, aleancë, luftë-shpallje etj., etj., ishte e menduar dhe shqyrtuar mirë, shpesh me vite para se të implementohej. P.sh., një Jugosllavi fqinjë – me vetëm shtatë-tetë kombësi në krahasim me mbi 30 në Perandorinë Osmane – me të gjitha mjetet e avantazhet e komunikimit të shtetit modern, për arsye që nuk janë aspak aksidentale, të jashtme e të brendshme, nuk mundi të mbijetonte më tepër se shtatë apo tetë dekada. Në të njëjtën mënyrë, edhe jetëgjatësia e perandorisë shumëkombëshe të Osmanëve, apo çdo perandori e përmasave të ngjashme që ka lënë gjurmën e vet në histori, nuk mund të konsiderohet “aksident historik” pa pezulluar arsyen. Një linjë argumentimi e tillë na lejon të quajmë edhe supremacinë globale të shtetit prej të cilit po shkruaj këto rreshta (SHBA³¹), si “aksident”, dhe

31. Shënim i redaksisë.

sa vlerë do të kishte një argumentim i tillë nuk ka nevojë për koment.

Ftesat, direkte e indirekte, për rikthim në Krishterim të shqiptarëve presupozojnë edhe diçka tjetër; të qenit e Islamit religjion jo-autentik. Një argument i tillë do të ishte i ngjashëm me pretendimin se meqë gjuha shqipe është mjet komunikimi, atëherë greqishtja apo italishtja janë të pavlefshme si mjete shprehëse. Ndërsa e logjikshme që një person të mos kuptojë gjuhët e tjera, nuk mund të jetë e logjikshme mohimi i vlefshmërisë së tyre shprehëse.

Ka larmi klimash, ka larmi racash, grupesh etnike, gjuhësh, temperamentesh, karakteresh... Është

krejt e natyrshme

që kjo larmi, pasqyrë e

Pasurisë së Thesarit Hyjnor,

të manifestohet edhe në sferën e religjioneve³². Por të reduktosh manifestimin e shpalljes Hyjnore në tek eveniment, sado madhor qoftë, është sikur të insistosh se ka *vetëm* një shteg që të çon në Majën e Malit, apo se drita manifestohet vetëm në një ngjyrë. Doktrina e Islamit, shpalljes së fundit të ciklit njerëzor, flet për 124,000 të dërguar, në kohë, kombe e vise nga më të ndryshmet. Ky numër, në një mënyrë, është edhe tregues i një elementi kryesor të natyrës së njeriut të rënë, atë

32. Për një shtjellim themelor të kësaj teme nga autoriteti më i njohur në shekullin e XX-të i studimit krahasimor të religjioneve të shihet Frithjof Schuon, *The Transcendent Unity of Religions* (New York, NY: Pantheon, 1953).

të harresës, mangësi së cilës Mëshira Hyjnore i është përgjigjur më dërgimin e avatarëve, profetëve e shenjtorëve – rikujtuesit e dëshmitarët e gjallë të origjinës sonë çelësiale – duke mbajtur kështu hapur në çdo epokë udhën e shpëtimit (e dijes) për njerëzinë.

Dhe diçka të fundit. Sot më tepër së kurrë duhet të theksohet se nuk është faji i mësimave të Kur'anit, Ungjillit, Rigvedave, apo çdo teksti të shenjtë, për abuzimet në emër të religjionit, qofshin të klerikëve në veçanti, apo njerëzve në përgjithësi, për keqinterpretimin e tyre, apo edhe më keq, manipulimin e tyre. Zërat, gjoja në emër të liberalizmit e humanizmit, që propozojnë mënjanimin ose edhe anulimin e religjionit për shkak se manipulohet, apo keqinterpretohet, do t'i ftonim të bënin propozime të ngjashme në lidhje me arsimin apo shëndetësinë. A mund të quhet e arsyeshme braktisja e arsimit e mjekësisë krejtësisht për shkak të disa mësuesve e doktorëve të paaftë e korruptuar, e se shkollat me spitalet janë në gjendje të mjerueshme? Nëse po, një zgjidhje e tillë do të ngjante me anekdotën e njohur të doktor Adhamudhit, i cili sugjeron si kurë për një kokë që dhemb këputjen e saj. Dhimbja e kokës me të vërtetë zhduket, por edhe koka bashkë me të.

Këto ishin disa mendime e shqetësime që desha t'i ndaj me ju, bashkë me urimin e shpresën për mirëkuptim e përpjekje në ruajtjen e trajtës tradicionale të religjioneve, qoftë në lëmin dituror, qoftë në mënyrën si i jetojmë ato. Providenca u ka dhuruar shqiptarëve, si rrallë tjetër kombi, tre fe madhore, tre lumenj që rrjedhin në Oqean. Është një mëshirë e privilegj, dhe në të njëjtën kohë, dhurata e çdo gjëje të çmuar, sjell edhe përgjegjësinë për ruajtjen e saj. Një traditë profetike e profetit të Islamit, Muhamedit³³, këshillon që edhe nëse Vakti i Fundit afrohet ndërsa keni në dorë një fidan, prapë mbilleni. Është përpjekja jonë ajo që ka rëndësi, dhe këtu e vetëm këtu njeriu është i lirë të zgjedhë mes përmbushjes së përgjegjësisë që ka, ose braktisjes së saj. Përtej kësaj zgjedhjeje çdo gjë tjetër është jashtë dorës sonë.

Zoti e din ma mirë!

33. Në Islam kortezia shpirtërore (edeb) kërkon përdorimin e titujve të përshtatshëm si 'hazreti' (prania ose hirësia e tij/saj), kur flitet për profetët, dhe shqiptimi i emrit të tyre pasohet me një bekim. P.sh., Hazreti Merjem (paqe qoftë mbi të), ose Hazreti Muhamed (paqe qoftë mbi të). Në këtë shkrim nuk janë përdorur këto terma për të shmangur përsëritje të ngjashme çdo herë që përmendet një emër profeti, por aspak nga një neglizhencë ndaj figurës së tyre.

SHKRONJAT E KUR'ANIT DHE SHQIPTIMI I TYRE – I

M.A. Elton Karaj

Universiteti Bedër - Departamenti i Shkencave Islame

Abstrakt

Texhvidi është shkencë që trajton dhe analizon në thellësi leximin e germave të Librit të Shenjtë, Kur'anit. Ajo është një nga shkencat më të trajtuara dhe analizuar thellë e më thellë ndër shekuj, për shkak të rëndësisë që ka. Leximi i Kur'anit është një nga kushtet e adhurimit thelbësor të myslimanit dhe për më tepër ai është një adhurim më vete. Nga ky këndvështrim besimtarët kanë treguar kujdes të madh në studimin teorik dhe praktikimin e njohurive që na ofron shkencë e texhvidit.

A. HYRJE

Texhvidi është shkencë që trajton dhe analizon në thellësi leximin e germave të Librit të Shenjtë, Kuranit. Ajo është një nga shkencat më të trajtuara dhe analizuar thellë e më thellë ndër shekuj, për shkak të rëndësisë që ka. Leximi i Kur'anit është një nga kushtet e adhurimit thelbësor të myslimanit dhe për më tepër ai është një adhurim më vete. Nga ky këndvështrim besimtarët kanë treguar kujdes të madh në studimin teorik dhe praktikimin e njohurive që na ofron shkencë e texhvidit.

Kërkimet në këtë fushë në gjuhën shqipe janë të pakta dhe këto të paktat janë me të vërtetë versione shumë të shkurtra. Kështu që lind nevoja për kërkime më të thella e të përpikta, sepse punimet sipërfaqësore gjithmonë kanë mangësira. Shkencë e texhvidit është njëra prej të cilave kanë rënë pre

e botëkuptimit të të mësuarit me një rrugë sa më të shpejtë e të shkurtër, dhe pjesërisht, kjo është e realizueshme. Por duhet të jemi të qartë, që nëse një person dëshiron t'i mësojë çështjet me përpikmëri, atëherë duhet të tregohet më i durueshëm e të studiojë më thellë.

Ky artikull është një studim, deri diku, i mjaftueshëm për të hedhur hapat e para drejt një studimi më të detajuar, gjë rreth së cilës jemi duke punuar. Në këtë punim do të gjejmë njohuri rreth zonave të shqiptimit të shkronjave të Kur'anit dhe veçorive të tij. Kjo do të korrigjojë e saktësojë shqiptimin e shkronjave.

Literatura e shkencës së texhvidit, së cilës i bashkëngjitet edhe ajo e kiraeteve, është e përbërë kryesisht prej veprave të Imam ed-Daniut, esh-Shatibiut dhe të Ibn el-Xhezeriut. Ndërkohë që duke marrë këto në qendër, janë shkruar edhe shumë libra të tjerë texhvidi, të cilët

janë në formën e interpretimeve dhe trajtimeve të pjesshëm të veprave në fjalë. Ne jemi kufizuar me një pjesë prej tyre, duke mos hequr dorë nga literatura themelore e duke përzgjedhur disa prej atyre më të vonshme. Mendojmë që literatura e konsultuar është më se e mjaftueshme për kufijtë e këtij artikulli. I lutemi Zotit që t'ia kemi arritur sadopak qëllimit.

B. SHKRONJAT E KUR'ANIT DHE ZONAT E SHQIPTIMIT TË TYRE

1. Shkronjat - اَلْحُرُوفُ

Mes dijetarëve ka diversitet në përcaktimin e numrit të shkronjave të alfabetit arab. Një pjesë janë të mendimit se ato janë 28, kurse një pjesë tjetër mendojnë se janë 29. Ky diversitet lind për shkak se disa prej tyre elif-in (ا) nuk e radhisin ndër shkronjat bashkëtingëllore të këtij alfabeti. Por mendimi më i saktë është se alfabeti i gjuhës arabe formohet prej 29 shkronjash. Mendim ky i shtruar nga Mekki b. Ebî Tâlib në veprën e tij er-Ri'aje dhe i pranuar nga xhumhuri (shumicës së dijetarëve).¹

Ahmed et-Tîbî e shpreh kështu këtë çështje:

وَعِدَّةُ الْحُرُوفِ لِلْهَجَاءِ ... تِسْعٌ وَعِشْرُونَ بَلَا
اِمْتِزَاءِ
أُولُهَا الْهَمْزَةُ، لَكِنْ سَعِيَتْ: ... بِالْفِ مَجَازًا؛ اذْ
قَدْ صُوِّرَتْ
بِهَا فِي الْاِبْتِدَاءِ حَتْمًا، وَهِيَ فِي ... سِوَاهُ بِالْوَاوِ وَبِا
وَالْفِ
وَدُونَ صُورَةٍ، فَمَا لِلْهَمْزَةِ ... مُمَيِّزٌ يَخْصُصُهَا مِنْ
صُورَةٍ

1. Abdulhamid, Suad, *Tejsir er-Rahman fi Texhvid el-Kur'an*, t'hk: Ahmed Ahmed Mustafa Ebu Hasen dhe Mahmud Emin Tantaui, Dar et-Takua, Kajro 2009, fq. 47.

بَلْ يَسْتَعْبِرُونَ لَهَا صُورَةً مَا ... مَرَّ لِتَخْفِيفِ الْإِيَّ
عُلْمًا

Përkthimi:

Numri i shkronjave bashkëtingëllore është 29 pa asnjë diversitet, E para është hemzeja, por është quajtur "elif" në mënyrë figurative, sepse ka formën, e saj (elifit) si zëvendësuese, dhe ajo (hemzeja) përveç kësaj është (shoqëruar) me uau-in, ja-në si elifi, dhe pa formë (të caktuar), dhe hemzeja nuk ka një formë (në shkrim) të caktuar,

por përdorin në formë figurative forma me anë të të cilave të dallohet me lehtësi.²

Shkronjat që përbëjnë alfabetin e gjuhës arabe dhe emërtimi i tyre janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

1.	ا	أَلِفٌ	Elif	16.	ط	طَا	Tâ
2.	ب	بَا	Bê	17.	ظ	ظَا	Dhâ
3.	ت	تَا	Tê	18.	ع	عَيْنٌ	'Ajn
4.	ث	ثَا	Thê	19.	غ	غَيْنٌ	Gajn
5.	ج	جِيمٌ	Xhîm	20.	ف	فَا	Fê
6.	ح	حَا	Ha	21.	ق	قَافٌ	Kâf
7.	خ	خَا	Ha	22.	ك	كَافٌ	Kêf
8.	د	دَالٌ	Dêl	23.	ل	لَامٌ	Lâm
9.	ذ	ذَالٌ	Dhêl	24.	م	مِيمٌ	Mîm
10.	ر	رَا	Râ	25.	ن	نُونٌ	Nûn
11.	ز	زَا	Zê	26.	و	وَاوٌ	Uâu
12.	س	سِينٌ	Sin	27.	ه	هَا	Hê
13.	ش	شِينٌ	Shin	28.	لا	لَامٌ أَلِفٌ	Lâm- elif
14.	ص	صَادٌ	Sâd	29.	ي	يَا	Jê
15.	ض	ضَادٌ	Dâd				

2. et-Tîbî, Shihabuddin Ahmed b. Ahmed, *Mandbume el-Mufid fi Ilm et-Texhvid*, t'hk: Ejmen Rushdi Suvejd, fq. 8.

2. Zonat e shqiptimit të shkronjave – Mahrexhet

Ibn el-Xhezeri

إِذْ وَاجِبٌ عَلَيْهِمْ مُحْتَمٌ ... قَبْلَ الشُّرُوعِ أَوْلَىٰ أَنْ يَعْلَمُوا
مَخَارِجَ الحُرُوفِ وَالصَّفَاتِ ... لِيَلْفِظُوا بِأَفْصَحِ اللُّغَاتِ

Përkthimi:

Sepse është një detyrë e padiskutueshme të dinë përpara zbatimit,

Mahrexhet e shkronjave dhe veçoritë në mënyrë që të shqiptojnë (shkronjat) sa më saktë.³

Fjala “mahrexh” vjen nga trajta *mef'al* e gjuhës arabe dhe shpreh emër vendi. Kuptimi i kësaj fjale në leksik është “vend daljeje”. Shumësi është “mehârixh”. “Mehârixhul Hurûf” (مَخَارِجُ الحُرُوفِ) është një emërtim për zonat nga dalin zërat e shkronjave.

Mahrexh: Zona, vendi ose pika nga i cili nis zëri i një shkronje dhe dallohet nga të tjerat quhet *mahrexh*. Ndryshe mund të themi edhe zona, vendi ose pika nga i cili shqiptohet zëri i një shkronje.⁴

Në lidhje me numrin e mahrexheve ka tri mendime të ndryshme:

- Mendimi i Halil b. Ahmed dhe Ibn el-Xhezeriut, i cili është edhe mendimi i xhumhurit, sipas së cilit ka 17 mahrexhe.
- Mendimi i Sibeuejhit dhe esh-Shatibiut, sipas së cilit ka 16 mahrexhe. Ata nuk e emërtojnë zonën xheuf, prej së cilës shqiptohen shkronjat zgjatëse, si një mahrexh të veçantë, por i shpërndajnë tri shkronjat zgjatëse si më poshtë:

- Elif-in (ا) e bashkëngjisit me mahrexhin e hemzes, d.m.th., me

3. Ibn el-Xhezeri, Shemsuddin Muhammed b. Muhammed b. Jusuf, *el-Mukaddime el-Xhezerije*, Dar el-Mugni, 2001, fq. 8.

4. Temel, Nihat, *Kiraat ve Tecvid Istılabları*, İFAV yay., Botimi 2, Stamboll 2009, fq. 93.

pjesën e poshtme të fytit.

- Ja-në (ي) zgjatëse e bashkëngjisit me mahrexhin e ja-së me hareke, d.m.th. me mesin e gjuhës.

- Uau-in (و) zgjatës e bashkëngjisit me mahrexhin e uau-it me hareke, d.m.th. me buzët.

- Mendimi i el-Ferra dhe disa të tjerëve, sipas së cilit ka 14 mahrexhe. Ata në lidhje me mahrexhin xheuf i bashkëngjiten mendimit të Sibeuejhit. Për më tepër, shkronjat rra (ر), lam (ل) dhe nun (ن) i grupojnë nën të njëjtën pikë mahrexhi.⁵

Mahrexhi dahet në dy lloje: kul’lî (î plotë) dhe xhuz’î (î pjesshëm). Zona, nga e cila shqiptohet një grup shkronjash quhet “mahrexh kul’lî”, kurse çdo vend i caktuar, që ndodhet në këto zona dhe nga i cili del një ose më shumë shkronja, quhet “mahrexh xhuz’î”. Këto zona ndryshe emërtohen muhakkak ose hass (xhuz’î) dhe mukadder ose ‘amm (kul’lî).

Imam Ibn Abd er-Razzek thotë:

والحصْرُ تقريبٌ وبالْحَقِيقَةُ ... لكلِّ حرفٍ بقعةٌ دقيقةٌ
إذ قال جمهورُ الوری ما نصُّهُ ... لكلِّ حرفٍ مخرجٌ یخصُّهُ

Përkthimi:

Kufizimi (i shkronjave në një mahrexh) është i përafërt, por në fakt çdo shkronjë ka një vend shqiptimi të përpiktë,

Sepse pjesa dërrmuese e dijetarëve thonë: çdo shkronjë ka një mahrexh që e përcakton atë (zërin e saj)⁶

Gjithashtu Ibn el-Xhezeri e shpjegon temën në fjalë në këtë mënyrë: مَخَارِجُ الحُرُوفِ سَبْعَةُ عَشَرَ ... عَلَى الَّذِي يَخْتَارُهُ مَنِ احْتَبَرَهُ

Përkthimi:

Mahrexhet e shkronjave janë 17, sipas mendimit të kujt ka studiuar (këtë shkencë)⁷

5. Abdulhamid, *po aty*, fq. 50-51.

6. Shih: Abdulhamid, *po aty*, fq. 47.

7. Ibn el-Xhezeri, *po aty*, fq. 8. Për më tepër detaje

Kemi pesë zona të cilat janë mahrexh kul'li:

Xheuf – الخَوْفُ

Fjala xheuf do të thotë “zbrazëti”. Në terminologji, është boshllëku që fillon nga fyti, vazhdon me gojën dhe arrin deri te buzët. Që këtu dalin shkronjat med (shkronjat zgjatëse) dhe lin, pra shkronjat *elif* (ل), *uau* (و) dhe *jê* (ي).

Këto shkronja dallohen nga të tjerat sepse nuk kanë një pikë të caktuar prej së cilës shqiptohen. Zëri i tyre nis nga boshllëku i fytit e vazhdon deri në gojë. Këtë mund ta përngjasojmë me fyellin ose nejin, të cilët kur i fryjmë pa bllokuar brimat me gishta, zëri vazhdon pa u ndryshuar deri në dalje.⁸

a) Fyti – الخَلْوُ

Zona e fytit nis nga pika ku bashkohet qafa me kraharorin, d.m.th. klavikula dhe përfundon me gjuhëzën. Në këtë zonë shkronjat dalin nga tri vende (nga tri mahrexhe xhuz’i):

- Pjesa e poshtme: Është pjesa ku bashkohet fyti me kraharorin. Që këtu shqiptojmë shkronjat *hemze* (ء) dhe *hê* (ه).
- Pjesa mesore: Është pjesa e gurmazit (laringut). Që këtu shqiptojmë shkronjat *hâ* (ح) dhe *ajin* (ع).
- Pjesa e sipërme: Është pjesa ku fyti bashkohet me gojën. Që këtu shqiptojmë shkronjat *hâ* (ح) dhe *gajin* (غ).
 - Këto janë shkronjat e zonës së fytit, të cilat shqiptohen duke ngushtuar fytin në vendin e caktuar për çdo zë.
- Gjuha – اللَّسَانُ
 - Shkronjat që dalin nga kjo zonë mund t’i radhisim duke

nisur nga fundi i gojës e deri në majën e gjuhës:

- Nga fundi i gojës, pra nga vendi afër bashkimit të gjuhës me fytin, del shkronja *keáf* (ق).
- Pak më lart shkronjës *keáf* (ق), shqiptojmë shkronjën *kef* (ك).
- Duke afruar mesin e gjuhës drejt qiellzës, mund të shqiptojmë shkronjat *xhim* (ج) , *shîn* (ش) dhe *jà* (ي).
- Duke prekur me pjesën anësore të gjuhës dhëmbët e qumështit në anën e djathtë ose të majtë, do të shqiptojmë shkronjën *dâd* (ض).
- Duke prekur me majën e gjuhës pjesën e sipërme të dhëmbëve të poshtëm e të sipërm prerës, do të shqiptojmë shkronjat *çê* (ج) , *sîn* (س) dhe *sâd* (ص).
- Duke prekur qiellzën me majën dhe pjesën anësore të gjuhës shqiptojmë shkronjën *rrâ* (ر).
- Duke prekur qiellzën me majën, pjesët anësore dhe qendrore të gjuhës, mund të shqiptojmë shkronjën *lâm* (ل).
- Duke prekur me majën e gjuhës afër rrënjëve të dhëmbëve të sipërm prerës shqiptojmë shkronjën *nûn* (ن).
- Duke prekur me majën e gjuhës në mes dhe në rrënjë të dhëmbëve të sipërm prerës mund të shqiptojmë shkronjat *tê* (ت) , *del* (د) dhe *tâ* (ط).
- Duke prekur midis dhëmbëve prerës me majën e gjuhës mund të shqiptojmë shkronjat *thê* (ث) , *dbel* (ذ) dhe *dhâ* (ظ).

b) Buzët – اللَّسْفَتَانُ

Nga zona e buzëve dalin me radhë këto shkronja:

shih shënimin në fund të titullit “Hajshum”.

8. Ibn el-Musanef, *el-Havashi el-Mufehheme fi Sherh el-Mukaddime*, fq. 9.

- Duke prekur dhëmbët e sipërm prerës me buzët e poshtme shqiptojmë shkronjën fê (ف).

- Duke bashkuar buzët me njëra tjetrën mund të shqiptojmë shkronjat bê (ب) dhe mîm (م).

- Duke zgjatur përpara buzët shqiptojmë shkronjën *uau* (و). Kjo i ngjan shkronjës “w” të alfabetit të gjuhës angleze.

c) Hajshûm – الْحَيْشُومُ

Është zona ku goja lidhet me hundën dhe nga ku kalon fryma për të dalë nga hunda. Nga kjo zonë shqiptohet vetia e quajtur gunne, që i përket shkronjave *mîm* (م) dhe *nûn* (ن).

Shënim: Siç shohim, nga zona e fytit me 3 mahrexhe xhuz’î dalin 6 shkronja, nga zona e gjuhës me 10 mahrexhe xhuz’î dalin 18 shkronja dhe nga zona e buzëve me 3 mahrexhe xhuz’î dalin 4 shkronja. Fyti quhet tri mahrexhe xhuz’î, gjuha dhjetë, buzët dy, xheufi dhe hajshumi nga një mahrexh, të cilat gjithsej bëjnë 17 mahrexhe xhuz’î, siç thoshte edhe Imam Ibn el-Xhezerî në fjalën që përmendëm më sipër.⁹

Megjithëse ne u munduam t’i paraqesim me përafërsi mahrexhet e shkronjave, shqiptimet e tyre të saktë mund të mësohen vetëm duke i dëgjuar nga një mësues i mirë Kur’ani. Gjë e cila është shumë e rëndësishme dhe e domosdoshme për çdo person që dëshiron të mësojë leximin e Kur’anit.

C. VEÇORITË E SHKRONJAVE TË KUR’ANIT

Veçoritë e shkronjave mund të klasifikohen nga këndvështrime të

ndryshme, por ne do të bëjmë vetëm një klasifikim, i cili do të na duhet për të mësuar më qartë veçoritë e shkronjave të Kur’anit Fisnik.¹⁰ Nga këndvështrimi i vazhdueshmërisë, veçoritë e shkronjave ndahen në dy lloje si në vijim:

1. Veçoritë relative

Veçoritë relative: Këto janë veçoritë, të cilat nuk kanë vazhdueshmëri në shkronjë, por dalin në pah në gjendje të caktuara. P.sh.: ihfâ, idgâm, meddi lîn, etj. Këto veçori njihen më tepër si “rregullat e texhvidit”.

2. Veçoritë absolute

Veçori absolute quhen veçoritë të cilat shkronja i ka në bazën e saj dhe që është e pamundur të ndahen nga ajo.

Në librat e texhvideve njihen Këto veçori si xhehr-hems, shiddet-rihuet-bejniije, isti’lâ-istifâl (inhifâd), itbâk-infitâh, dhuhur-hafij, safîr, tefeshshî, gunne, kalkale, istitâle dhe inhirâf. Me anë të tyre nënkuptohen disa detaje si p.sh: rrjedhja apo jo e frymës kur shkronja është me hareke, rrjedhja apo jo e zërit kur shkronja është me xhezm, shpërndarja e zërit në brendësi të gojës, etj.

a) Rëndësia dhe dobia e mësimit të veçorive absolute

Të shqiptosh shkronjat nga vendi i tyre i saktë përbën bazat e veçorive absolute. D.m.th., nëse e shqiptojmë një shkronjë nga mahrexhi i saktë, atëherë i kemi zbatuar të gjitha veçoritë e saj absolute. Përndryshe, nëse nuk i zbatojmë ato, shkronja pëson ndryshime duke humbur tiparet e saj themelore dhe kështu mund të bëjmë gabime të mëdha të cilat quhen “lahn xhelij”.

9. Ibn el-Xhezeri, *en-Nesbr fi el-Kiraet el-Asbr*, t’hk: Ali Muhammed ed-Debba’, Dar el-Kutub el-Ilmijje, I-II, Bejrut (pa datë), I, 198.

10. Tuğral, Rahim, *Ana Hatlarıyla Kur’an Tecvidi*, İlahiyat Fakültesi Vakfı Yayınları, İzmir 2001, fq. 15.

Le të japim disa shembuj për të tilla raste:

ظليلٌ ، سُورَةٌ ← صُورَةٌ ، غَلَبَ ← قَلَبَ ذَلِيلٌ ←
عَسَى ← عَصَى ، حَلَقَ ← حَلَقَ هَلَكَ ، أَلِيمٌ ← عَلِيمٌ

Nëse ne do t'i lexonim shkronjat duke mos treguar kujdes ndaj veçorive absolute, atëherë fjalët do të pësonin ndryshime edhe në kuptimet e tyre. P.sh.: nëse foljen haleka (حَلَقَ), që do të thotë “krjoi”, do ta lexonim heleke (هَلَكَ), atëherë ajo merr kuptimin “shfarosi, shkatërroi”.

Nga dobithë e përvetësimit dhe praktikimit të veçorive absolute mund të përmendim dy pika të rëndësishme si më poshtë:

-Dallimi i shkronjave të përbashkëta ose të ngjashme në mahrexh: Shkronjat, të cilat kanë mahrexh të përbashkët mund të dallohen nga njëra-tjetra vetëm me anë të veçorive absolute dhe shkronjat që përmbajnë të njëjtat veçori mund të dallohen nga njëra-tjetra vetëm me anë të mahrexhit. P.sh., shkronja ha (ح) dhe ajn (ع) kanë të njëjtin mahrexh, por dallohen nga njëra-tjetra për shkak se kanë veçori absolute të ndryshme.¹¹ Kurse shkronjat dha (ظ) dhe da (ض) i kanë të gjitha veçoritë absolute të njëjta, por mahrexhi i tyre ndryshon.¹²

- Dallimi i shkronjave të buta nga ato të fortat: Duke njohur veçoritë e shkronjave do të dimë se kur bashkëngjiten duke u shkrirë tek njëra tjetra shkronjat e forta me ato të buta. P.sh.: Shkronja ta (ط) është e fortë kurse te-ja (ت) është e butë. Nëse përpara shkronjës ta (ط) vjen me sukun shkronja te (ت), atëherë kjo e fundit shkrihet krejtësisht tek shkronja

11. Për veçoritë e secilës shkronjë shih në pikën e tretë të këtij kapitulli me titull “Shkronjat dhe veçoritë e tyre përkatëse”.

12. Ibn el-Xhezeri, *en-Nesbr*, I, 214.

ta (ط), dmth bëhet idgam e plotë. Si shembull mund të përmendim ajetin e 69 të sures Al Imran: وَوَدَّتْ طَائِفَةٌ, e cila lexohet kështu: وَوَدَّتْ طَائِفَةٌ. Por, nëse radha e tyre është në të kundërt, përpara shkronjës te (ت) vjen me sukun shkronja ta (ط), atëherë kjo e fundit shkrihet tek shkronja te (ت), por jo krejtësisht, dmth bëhet idgam e pjesshme, duke mos zbatuar vetëm kalkalenë e shkronjës ta (ط). Shembull: بَسَطَتْ.¹³

b) Përkufizimet e veçorive absolute

i. Veçoritë që kanë të kundërt

Veçoritë absolute i quajmë ndryshe edhe *veçori themelore*. Ato i ndajmë në *veçoritë të cilat kanë të kundërtën* dhe *ato që nuk e kanë të kundërtën* e tyre përkatëse.

Kur themi veçoritë që e kanë të kundërtën e tyre përkatëse, nënkuptohet që nga 29 shkronja që ka alfabeti arab, një pjesë e këtyre ka një veçori, kurse pjesa tjetër që mbetet ka veçorinë e kundërt me atë të parën. Ja disa prej këtyre: xhehr-hems, shiddet-rihuet, isti'lâ-istifâl, itbâk-infitâh, dhuhur-hafij etj. Tani le t'i shpjegojmë këto me rradhë:

1) Xhehr—الْجَهْرُ

Xhehr do të thotë “të sqarosh diçka, të nxjerrësh në pah, të flasësh me zë të lartë”.¹⁴ Në terminologjinë e texhvidit është veçoria e shkronjave të cilat kur lexohen me hareke, pjesa më e madhe e frymës bllokohet në kraharor dhe një pjesë e vogël rrjedh jashtë. Shkronjat që kanë këtë veçori janë:

ط (shkronja 18) أ ب ج د ذ ر ز ض ط

ظ ع غ ق ل م ن ر ي

Duhet pasur parasysh që disa shkronja e kanë më të theksuar këtë

13. Abdulhamid, *po aty*, fq. 69-70.

14. Temel, *po aty*, fq. 43.

përsëri si shembull shkronjën ta (ط)¹⁸, do të shohim qartë që ajo ka vetëm tipare të forta si xehëri, shiddeti, isti'laja, kalkaleja dhe itbaku. Kështu që është më se e natyrshme që ta ketë më të theksuar shiddetin në krahasim me një shkronjë si kef-i (ك), e cila nuk është ndër shkronjat e itbakut apo të kalkalesë.

4) *Rihuet* – الرَّحْوَةُ

Rihuet do të thotë “butësi, gjerësi, gjatësi dhe bollëk”.¹⁹ Është veçoria e shkronjave, që kryesisht kur i lexojmë me sukûn, na rrjedh zëri. Kjo ndodh për shkak të mbështetjes së dobët të shkronjës në mahrexhin e saj. Shkronjat që kanë këtë veçori janë:

ص ش ذ ز س ح خ (shkronja 15)

ض ظ غ ف و ه ي

5) *Bejnije* – الْبَيْنِيَّةُ

Bejnije do të thotë “të ndodhesh në mes”. Në terminologjinë e texhvidit, është veçoria e shkronjave, që mbeten midis shiddetit dhe rihuetit. Megjithatë, kjo veçori është më afër rihuetit. Ndryshe quhet *tenassut* (التَّوَسُّطُ). Shkronjat që kanë këtë veçori janë:

ن م ل ر ع ل م ن (shkronja 5)

Në shqiptimin e këtyre shkronjave zëri rrjedh më pak dhe për arsye se kanë disa cilësi të veçanta, janë pranuar veç shkronjave të rihuetit.

Shënim: Të gjitha shkronjat që kanë edhe veçorinë xehër edhe veçorinë shiddet janë nga shkronjat kalkale, përveç *hemzes* (ء). Prandaj në fjalë të tilla si *je'kulu* (يَأْكُلُ) ose *me'kâlun* (مَأْكُولٌ), hemze nuk lexohet si kalkale.²⁰

18. Abdulhamid, *po aty*, fq. 74.

19. Temel, *po aty*, fq. 114.

20. Për kalkale shih nën titullin “Veçoritë që nuk kanë të kundërt”..

6) *Ist'ilâ* – اِلْتِغَالًا

Shpeshherë shkronjat i ndajmë në të buta e të forta. Në fakt në gjuhën arabe nuk bëhet fjalë për një ndarje të tillë. Shkronjat, të cilat ne i quajmë të buta, në literaturën arabe formojnë grupin e veçorisë istifal ose inhidad, kurse ato të fortat formojnë grupin e shkronjave të veçorisë isti'la.

Isti'la do të thotë “lartësim” kurse në terminologjinë e texhvidit, ajo është veçoria e shkronjave, gjatë shqiptimit të së cilave, mesi i gjuhës ose anësoret e saj ngrihen drejt qiellzës. Kur ndodh ky fakt, “pashmangshmërisht” hapet goja, zëri presohet drejt kubes së qiellzës dhe shkronjat lexohen të forta. Për këtë arsye zëri i zanores fet'ha lexohet “a”, por jo një “a” e thjeshtë si në gjuhën shqipe. Zëri i saj duhet të ngjitet në qiellzë. Kjo dukuri quhet *tefhim* (التَّفْهِيمُ).²¹ Shkronjat që kanë këtë veçori janë:

ط ظ ع ق (shkronja 7)

ط ظ ع ق

7) *Istifâl* – اِلْتِغَالًا

Istifal do të thotë “të ulesh poshtë”.²² Në texhvid, istifali është e kundërta e isti'lasë. Është veçoria e shkronjave, gjatë shqiptimit të të cilave, gjuha mbetet në tabanin e gojës, pa u ngritur drejt qiellzës. Ndryshe quhet edhe *inhifâd* (اِلْتِخْفَانٌ). Shkronjat që kanë këtë veçori janë:

س ش ع ف ك ل م ن و ه ي (shkronja 21)

س ش ع ف ك ل م ن و ه ي

21. Tefhim do të thotë “të zmadhosh ose trashësh diçka”. Në terminologji, është trashja e zërit të disa shkronjave të caktuara ose të zanores fet'ha, duke ngritur gjuhën drejt qiellzës dhe burguar zërin brenda gojës pjesërisht ose plotësisht. Ndryshe quhet edhe taglidh (التَّغْلِيظُ). (Shih: Temel, *po aty*, fq. 131)

22. Temel, *po aty*, fq. 78.

Megjithëse gjatë leximit të disa prej këtyre shkronjave maja e gjuhës mund të prekë qiellzën, për arsye se goja nuk hapet shumë, këto shkronja kanë zë të butë. Mes së gjithash ju kujtojmë se shkronjat *rrâ* (ر) dhe *lam*-i i fjalës *Allah* (الله) i përshtaten vlerësimeve të tyre të veçanta.

Gjithashtu duhet të tërheqim vëmendjen edhe për shkronjat *hâ* (ح) dhe *ajñ* (ع), zëra që nuk ndodhen në alfabetin shqip. Vëmë re që shumë persona i vendosin këto shkronja në grupin e shkronjave të forta. Ndërkohë që është e kundërta. Kjo ndodh për shkak se shqiptimi i tyre me zërin “a” është më i lehtë. Kur bëhet fjalë për fillestarët, të cilët sapo kanë nisur të mësojnë shkronjat e alfabetit, atëherë mund të shpjegohet në këtë mënyrë. Për këtë arsye, në libra fillestarë *hâ* (ح) dhe *ajñ* (ع) janë paraqitur si të forta, por duhet të jemi të qartë se ato bëjnë pjesë në grupin e shkronjave të buta dhe zëri i zanores fet’ha shqiptohet sikurse tek hemze, be, te, the, etj.

8) *Itbâk* – الأَطْيَاقُ

Kuptimi leksikor i fjalës itbak është “të ngjitesh, të përshtatesh, të arrish”.²³ Në texhvid, është veçoria e shkronjave gjatë artikulimit të të cilave, maja e gjuhës, pjesa qendrore ose anësoret e saj ngrihen drejt qiellzës duke u mbështetur mbi të (duke e prekur atë), ose në të njëjtin nivel me boshllëkun e qiellzës.

Duke qenë se maja e gjuhës prek qiellzën, vëmë re që zëri dhe fryma mbeten të presuar midis pjesës qendrore të gjuhës dhe qiellzës. Shkronjat që kanë këtë veçori janë:

ص ض ط ظ (*shkronja 4*)

23. Temel, *po aty*, fq. 81.

Prej këtyre shkronjave ta-ja (ط) është më e forta, dha-ja (ظ) më e buta, ose më saktë më pak e forta, dhe sad-i (ص) me dad-in (ض) janë mesatare në përfaqësimin e kësaj veçorie.²⁴

Shënim: Dallimi midis isti’lasë dhe itbakut është se isti’laja nuk nënkupton domosdoshmërisht prekjen e gjuhës në qiellzë, kurse itbaku po. Kështu që çdo shkronjë e veçorisë itbak ndodhet gjithashtu edhe në grupin e isti’lasë, por jo çdo shkronjë e isti’lasë ndodhet në grupin e itbakut.²⁵

9) *Infitâh* – الْإِنْفِتَاحُ

Infitah do të thotë “hapje e zgjerim”. Në terminologji, është veçoria e shkronjave gjatë artikulimit të të cilave, pjesa qendrore dhe anësoret e gjuhës mund të ngrihen drejt qiellzës, por nuk e prekin atë. Midis qiellzës dhe gjuhës ngel hapësirë, por zëri dhe fryma nuk presohen. Shkronjat që kanë këtë veçori janë të gjitha të tjerat përveç ص ض ط ظ. (*shkronja 24*)

10) *Idhlâk* – الْإِدْلَاقُ

Në leksik do të thotë “e lehtë dhe e shpejtë, e mprehtë, etj”.²⁶ Është veçoria e shkronjave, të cilat mund të shqiptohen shumë lehtë dhe rrjedhshëm nga maja e gjuhës ose buzët.²⁷ Shkronjat që kanë këtë veçori janë:

ب ر ف ل م ن (*shkronja 6*)

11) *Ismât* – الْأَصْمَاتُ

Ismat do të thotë “të heshtësh, të pengosh, etj”.²⁸ Është veçoria e shkronjave, të cilat mund të shqiptohen

24. Ibn el-Xhezeri, *et-Tembid fi Ilm et-Texhvid*, Mektebe el-Mearif, Rijad 1985, fq. 90.

25. Abdulhamid, *po aty*, fq. 85.

26. Temel, *po aty*, fq. 82.

27. Abdulhamid, *po aty*, fq. 88.

28. Temel, *po aty*, fq. 77.

më me vështirësi dhe ngadalësi. Është e kundërta e veçorisë idhlak, kështu që të gjitha shkronjat përveç atyre të idhlakut kanë këtë veçori.

أ ت ث ج ح خ د ذ ز س ش
ص ض ط ظ ع غ ق ك و ه ي

Deri tani folëm rreth përkufizimit që gjejmë në librat e texhvidit rreth idhlakut dhe ismatit. Në fakt këto dy veçori nuk kanë shumë lidhje me shqiptimin e shkronjave. Mësuesi i Kur'anit nuk ka mundësi të bëjë dallim mes zbatimit apo jo të këtyre veçorive.

Në morfologjinë e gjuhës arabe (sarf), një ndër rregullat me anë të së cilës dallohet një fjalë nëse është me origjinë nga gjuha arabe apo është e huaj, është në lidhje me veçoritë idhlak dhe ismat. Nëse një fjalë është e formuar prej 4 ose 5 shkronjash dhe të gjitha shkronjat janë prej veçorisë ismat, atëherë kjo fjalë është e huaj dhe jo arabe. P.sh.: عَسَجِد, është një emër që përdoret për floririn. Kjo është një fjalë e huaj, sepse të gjitha shkronjat që e formojnë atë janë prej veçorisë ismat.²⁹

29. Ebu el-Uefa, Alijullah b. Ali, *el-Kaul es-Sedid fi Ilm et-Texhvid*, Dar el-Uefa, Mansura 2003, fq. 169; Abdussemit' esh-Shafii, Ahmed Mahmud, *el-Uafi fi Kejjjeti Tertil el-Kur'an el-Kerim*, Dar el-Kutub el-Ilmije, Bejrut 2000, fq. 81.

Ne vepruam si shumica e autorëve klasikë të texhvidit, të cilët i kanë përfshirë këto veçori në veprat e tyre. Gjithashtu edhe për të shpjeguar se çfarë përfaqësojnë në të vërtetë këto terma.

12) *Dhubûr* – الظُّهُورُ

Dhuhur do të thotë “të nxjerrësh në pah”. Në shkencën e texhvidit do të thotë që shkronja, pak a shumë, të ndihet gjatë leximit të saj. Shkronjat që kanë këtë veçori janë të gjitha të tjerat përveç *he-së* (27). *shkronja* (هـ).

13) *Hafij* – الْحَفِيُّ

Në leksik fjala hafij do të thotë “e lehtë, e fshehur”. Në terminologji ajo është veçoria e shkronjës *he* (هـ), e cila ka një lidhje shumë të dobët me mahrexhin, aq sa mund të themi që nuk ka fare. Nëse nuk tregohet kujdes i veçantë për leximin e kësaj shkronje ajo mund të zhduket fare. Mos shqiptimi i kësaj shkronje pas shkronjave zgjatëse (P.sh.: ...لَا إِلَهَ...) ose tek fjala (...أَشْهَدُ...) kryesisht gjatë ezanit, vjen si pasojë e mospajtjes kujdes për veçorinë hafij. Për këtë arsye duhet të tregohemi më të kujdesshëm me të.

ISLAMI SI FE E MËSHIRËS UNIVERSALE

Muhammed Fet'hullah Gylen

Abstrakt

Disa ndodhi “natyrore” ose tronditje shoqërore mund të vështrohen si të pakëndshme në fillim, por ne nuk dubet t'i gjykojmë ato si ngjarje që nuk përputhen me mëshirën. Ata janë si re të zeza ose vetëtima dhe bubullima që, ndonëse janë të frikshme, na sjellin sihariqin për shiun. Në këtë mënyrë i tërë universi i thur lavde të Gjithëmëshirshmit.

Kjo jetë është bekimi më i rëndësishëm dhe më i qartë i Zotit të Plotfuqishëm, kurse jeta e vërtetë dhe amshimi janë në botën e pasme. Meqë ne mund ta meritojmë këtë jetë vetëm për pëlqim të Zotit, Ai dërgoi profetët dhe shpalli shkrimet e shenja si shprehje të Mëshirës së Tij për njerëzimin. Ndërsa përmendte bekimet e Tij për njerëzimin, Ai fillonte:

“I Gjithëmëshirshmi. Ua ka mësuar Kur'anin (robërve të Tij). E krijoi njeriun, dhe ia mësoi atij të folurit e qartë.”¹

Të gjitha aspektet e kësaj jete janë provë për botën tjetër dhe asnjë krijesë nuk mund t'i shmanget kësaj rruge. Ky rregull është i dukshëm në çdo përpjekje dhe mëshira qëndron në çdo arritje. Disa ndodhi “natyrore” ose tronditje shoqërore mund të vështrohen si të pakëndshme në fillim, por ne nuk duhet t'i gjykojmë ato si

1. Kur'an ER-Rrahmân, 55:1-4.

ngjarje që nuk përputhen me mëshirën. Ata janë si re të zeza ose vetëtima dhe bubullima që, ndonëse janë të frikshme, na sjellin sihariqin për shiun. Në këtë mënyrë i tërë universi i thur lavde të Gjithëmëshirshmit.

Profeti Muhamed, paqja dhe mëshira qofshin mbi të, është si një burim me ujë të kthjellët në zemër të shkretëtirës, si një rreze drite në errësirën e paanë. Ata që janë përgjëruar për këtë burim mund të përdorin aq ujë sa t'u nevojitet për të shuar etjen, për të pastruar mëkatet dhe për t'u ndriçuar me dritën e besimit. Mëshira është si një çelës magjik në duart e Profetit, me të ai hap zemrat që janë ngurtësuar dhe ndryshkur kur ndonjë mendon që ato nuk mund të hapen kurrë. Por ai bën akoma më shumë: ndez një pishtar të besimit tek ato.

Mëshira e të Dërguarit të Zotit përfshin çdo krijesë. Ai dëshironte që gjithsecili të ishte i orientuar në rrugën

e drejtë, domethënë, t'i besonte Allahut, misionit të tij profetik dhe Kur'anit. Në fakt, kjo ishte çështja e tij më e madhe:

*"A mos vallë do ta shkatërrosh veten nga pikëllimi duke rendur pas tyre, nëse ata nuk besojnë në këtë Fjalë (Kur'an)?"*²

Por si mund t'i fuste ai në rrugë të drejtë ata që këmbëngulnin në shtypjen dhe persekutimin, ata që nuk e pranonin atë dhe ndjekësit e tij meqë adhuronin Zotin e Vetëm, ata që kishin ngritur armët për ta shkatërruar atë? Ai ka për të luftuar me këta njerëz, ndonëse mëshira e tij universale i ngërthen të gjitha krijesat. Për këtë arsye ndërsa ishte i plagosur rëndë në betejën e Uhudit, ai ngriti duart e tij dhe u lut: *O Zot, falë njerëzimit e mi, ata nuk dinë ç'bëjnë!*³

Mekasit, populli i tij, i shkaktuan aq shumë vuajtje, sa, më së fundi, ai emigroi në Medine. Edhe pas kësaj, pesë vitet e ardhshme ishin larg nga paqja. Megjithatë, kur ai triumfoi mbi Mekën pa gjakderdhje në vitin e njëzet e një pas profetësisë, i pyeti mekasit e pafe: *"Si prisni që t'ju trajtoj ju?"* Ata iu përgjigjën të gjithë së bashku: *"Ti je një njeri i lartësuar, bir i një ati të lartësuar!"* Ai atëherë u tregoi atyre vendimin e tij: *"Ju mund të jetoni, nuk do të ketë fajësim për ju sot. Ndoshta Zoti do t'ju falë. Ai është më i Mëshirshmi!"*⁴ Pas tetëqind e njëzet e pesë vjetësh, Fatih Sulltan Mehmeti II tha të njëjtnë gjë me rënien e Bizantit pas marrjes së Kostandinopojës. Kjo është mëshira universale që përçon Islami.

I Dërguari shfaqti shkallën më të lartë të mëshirës kundrejt besimtarëve:

2. Kur'an, El-Kehf, 18:6.

3. Kadi Ijad, *Shifa*, I, 78-79; Hindi, *Kenzu'l-Ummal*, IV, 93.

4. Ibni Hisham, *Siratu'l-Nebeviye*, IV, 55; Ibni Kethir, *el-Bidaje ve'n-Nihaje*, IV, 344.

*"Tashmë ju ka ardhur një i Dërguar nga gjiri juaj. Atij i vjen rëndë për gjynahet që bëni, jua dëshiron të mirën me gjithë zemër që ju të shkoni rrugës së drejtë dhe është i butë e i mëshirshëm për besimtarët."*⁵

*"...kurse ndaj besimtarëve ji i përlulur e i butë."*⁶ (Hixhr, 88)

*"I Dërguari është më i afërt për besimtarët, sesa ata për njëri-tjetrin..."*⁷

Kur një nga bashkëpunëtorët e tij vdiq, ai pyeti ata që merrnin pjesë në funeral nëse i ndjeri kishte lënë borxhe pas. Me njohuritë që zotëronte, Profeti përmendi ajetet e mësipërme dhe njoftoi që kreditorët duhej të shkonin tek ai për shlyerjen e borxheve.

Hipokritët dhe mosbesuesit ishin nën mëshirën e tij. Ai e dinte se kush ishin hipokritët, por kurrë nuk i identifikoi dhe demaskoi ata, përndryshe, do t'i kishte privuar nga të gjitha të drejtat qytetare që ata i kishin fituar duke deklaruar dhe ushtruar në opinion besimin e tyre. Më pas ata jetuan mes myslimanëve, mohimi i tyre mund të jetë reduktuar ose ka ndryshuar, por gjithmonë me një hije dyshimi, duke pakësuar kështu frikën e tyre nga vdekja dhe mundimin që i shoqëronte vazhdimisht shkaktuar nga pohimi i mosekzistencës pa fund pas vdekjes.

Zoti nuk i shkatërroi të gjithë mosbesuesit bashkërisht, ndonëse Ai kishte zhdukur shumë popuj të tillë në të kaluarën:

*"Por Allahu nuk do t'i ndëshkojë ata përderisa ti (Mubamed) je në mesin e tyre dhe Allahu nuk do t'i dënojë ata përderisa ata i kërkojnë falje Atij."*⁸

5. Kur'an, ET-Teube, 9:128.

6. Kur'an, El-Hixhr, 15:88.

7. Kur'an, El-Ahzâb, 33:6.

8. Kur'an, El-Enfâl, 8:33.

Ky ajet u referohet mosbesuesve në kohë dhe vende të ndryshme. Zoti nuk do të shkatërrojë të gjithë popujt si dhe ata që ndjekin të Dërguarin. Përveç kësaj, Ai ka lënë të hapur derën e pendimit deri në ditën e fundit. Çdonjëri mund ta pranojë Islamin ose të kërkojë mirëkuptimin e Zotit, pavarësisht nëse ata e shohin veten të mbytur në mëkate.

Për këtë arsye, armiqësia e një myslimani ndaj jobesimtarëve është një sjellje për të ardhur keq. Kur Omeri vështrroi një të moshuar rreth të tetëdhjetave, u ul në gjunjë dhe filloi të lotonte. Kur e pyetën pse po qante, ai u përgjigj: “Zoti i dha jetëgjatësi, por ai nuk ishte në gjendje të gjente udhën e vërtetë!” Omeri ishte një ndjekës i të Dërguarit të Zotit, Profetit, i cili kishte thënë:

Unë nuk kam zbritur si mallkim, por si mëshirë për njerëzit.⁹

Unë jam Muhamedi, dhe Ahmedi (i lartësuar), dhe Mukaffi (Profeti i Fundit); Unë jam Hashiri (Profeti i fundit në praninë e të cilit njerëzit do të mbliidhen); Profeti i Pendimit (Profeti për hir të të cilit dera e pendesës do të qëndrojë gjithmonë e hapur) dhe Profeti i Mëshirës.¹⁰

Xhebraili gjithashtu përfitoi nga mëshira e Kur’anit. Njëherë, pasi Profeti e pyeti Xhebrailin nëse ai bënte pjesë në mëshirën që përfshihej në Kur’an, Xhebraili u përgjigj se po dhe u shpjegua: «Unë nuk isha i qartë për fundin tim. Prandaj kur u shpall ajeti, “...që është i respektuar atje (në mesin e engjëjve) dhe besnik”¹¹ unë u ndjeva i qetë!”¹²

9. Muslim, *Birr*, 87.

10. Hanbel, *Musned*, IV, 395; Muslim, *Fedail*, 126.

11. Kur’an, ET-Tekuir, 81:21.

12. Kadi Ijad, *esh-Shifa*, I, 17.

I Dërguari i Zotit kishte një dhembshuri të veçantë për fëmijët. Kur ai shikonte një fëmijë që po qante, e pushtonte në krahët e tij dhe ndante së bashku me të brengën apo hidhërimin. Ai ndjente dhimbje për një fëmijë më tepër se sa mund të ndjente nëna e tij. Një herë ai tha: “Unë po falem dhe dëshiroj ta çoj sa më gjatë faljen. Por unë po dëgjoj një fëmijë duke qarë dhe po e shkurtroj faljen për t’ia larguar ankthin nënës.”¹³

Ai i merrte fëmijët në krahë dhe i përqafonte. Njëherë, ndërsa po përkëdhelte dhe puthte nipin e tij të madh, Hasanin, Akrah ibn Habisi i tha: “Unë kam dhjetë fëmijë, por asnjërin prej tyre nuk e kam puthur kurrë!” I Dërguari i Zotit iu kthye: “Për atë që nuk ka mëshirë për të tjerët, nuk mund të ketë mëshirë!”¹⁴ Sipas një versioni tjetër, ai shtonte: “Çfarë mund të bëj për ty nëse Zoti e ka larguar mëshirën prej teje?”¹⁵

Ai thoshte: “Mëshironi në tokë që ata në qiell t’ju mëshirojnë ju!”¹⁶ Kur Sad ibn Ubade u sëmur, i Dërguari i Zotit shkoi ta vizitonte në shtëpi. Duke vështruar bashkëpunëtorin e tij besnik që ishte në gjendje të rëndë, ai filloi të qante dhe duke treguar gjuhën, tha: “Zoti nuk ndëshkon për lotët apo brengat, por Ai është ndëshkues për këtë!”¹⁷ Kur Osman ibn Maduni vdiq, ai qau pa pushim. Përgjatë funeralit, një grua tërhoqi vëmendjen duke thënë: «Osmani fluturoi si një zog në parajsë.» Profeti nuk e humbi qetësinë dhe e qortoi gruan: “Nga e di ti këtë? Akoma unë nuk e di këtë gjë, dhe unë jam Profeti!”¹⁸

13. Buhari, *Edeb*, 65; Muslim, *Salat*, 192.

14. Buhari, *Edeb*, 18.

15. Buhari, *Edeb*, 18; Muslim, *Fedail*, 64.

16. Tirmidhi, *Birr*, 16.

17. Buhari, *Xhenaiz*, 45.

18. Buhari, *Xhenaiz*, 3.

Një anëtar i fisit Benu Mukarrin rrahu njëherë skllaven e tij. Ajo vuri në dijeni të Dërguarin e Zotit, i cili atëherë i dërgoi një mesazh pronarit të saj. Ai thoshte: *“Ti e ke rrahur atë pa asnjë të drejtë. Lëre të lirë!”*¹⁹ Të linte të lirë një skllave ishte më e pakta që pronari mund të bënte në krahasim me ndëshkimin që e priste në botën e përtejme për shkak të sjelljes së gabuar. Edhe para profetësisë, i Dërguari i Zotit gjithmonë mbronte dhe mbështeste vejshat, jetimët, të varfrit dhe të pamundurit. Kur ai u kthye në shtëpi nga mali Hira pas shpalljes së parë, gruaja e tij Hatixhja i tha: *“Unë shpresoj që ti do të jesh Profeti për këtë shoqëri, ti që thua gjithmonë të vërtetën, që përmbush besimin tënd, përkrah të afërmit, ndihmon të varfrit dhe të pafuqishmit dhe ushqen miqtë!”*²⁰

Dhembshuria e tij përfshinte edhe kafshët. Ne dëgjuam prej tij: *“Një grua e përdalë e drejtuar nga e vërteta e Zotit shkoi në parajsë sepse i kishte dhënë një një qeni të gjorë që po ngordhte nga etja... Kurse një tjetër grua ishte dërguar në ferr sepse kishte lënë një mace të ngordhte nga uria...”*²¹

Njëherë, ndërsa kthehej nga një fushatë ushtarake, disa nga bashkëpunëtorët kishin marrë nga foletë e tyre ca zogj të vegjël për t'i përkëdhelur. Kur nëna e zogjve kthehet, nuk i gjen në fole zogjtë e saj dhe fillon të fluturojë përreth duke cicëruar në kërkim të tyre. Pasi i treguan për këtë, i Dërguari i Zotit u zemërua dhe urdhëroi që zogjtë të ktheheshin në foletë e tyre.²²

19. Muslim, Ejman, 31, 33; Ibn Hanbel, *Musned*, III, 447.

20. Ibn Sa'd, *el-Tabakatu'l-Kubra*, I, 195.

21. Buhari, *Enbija*, 54; Muslim, *Selam*, 153.

22. Ebu Davud, *Edeb*, 164; Ibn Hanbel, *Musned*, I, 404.

Ndërsa në Mina, disa nga bashkëpunëtorët iu turrën një gjarpri për ta vrarë, por ai arriti të shpëtonte. Duke ndjekur këtë skenë nga larg, ai vuri në dukje: *“Ai shpëtoi nga ligësia juaj, aq sa ç'shpëtuat edhe ju nga ligësia e tij!”*²³ Ibn Abasi tregonte që i Dërguari i Zotit, pasi vërejtë një njeri duke mprehur thikën e tij para syve të deles që do të therej, iu drejtua atij: *“Dëshiron ta therësh atë më shumë se një herë?”*²⁴

Dashuria dhe dhembshuria e tij për krijesat ndryshonte prej dashurisë dhe dhembshurisë së atyre që sot vetëshpallen humanistë. Ai ishte i sinqertë dhe i matur në dashurinë dhe mëshirën e tij. Ai ishte një Profet i lartësuar nga Zoti, Krijuesi dhe Përkrahësi i të gjithë qenieve, për drejtimin dhe lumturinë e krijesave të ndërgjegjshme - njerëzit dhe xhindet - dhe harmoninë e ekzistencës. Si i tillë, ai nuk jetoj për vetveten por për të tjerët. Ai ishte një mirësi për të gjithë botën, një manifestim i mëshirës.

Ai çrrënjosi të gjitha dallimet për racat dhe ngjyrat. Njëherë Ebu Dherri u zemërua me Bilalin dhe e ofendoj atë: *“Ti je biri i një zezakeje!”* Bilali vajti tek i Dërguari dhe ia tregoi ngjarjen me lot në sy. I Dërguari e qortoi Ebu Dherrin: *“Tek ti ekzistojnë akoma shenja të injorancës!”* I penduar thellë, Ebu Dherri u shtri përdhe dhe tha: *«Unë nuk do ta ngre më kokën nëse Bilali s'do ti vinte këmbën mbi të. Bilali e falë dhe ata u pajtuan.»*²⁵ Të tilla ishin lidhjet farefisnore dhe njerëzore që Islami krijoi në mes të një populli të egër e të paqytetëruar!

23. Nesai, *Haxh*, 114; Ibn Hanbel, *Musned*, I, 385.

24. Hakim, *Mustedrek*, IV, 231.

25. Buhari, *Iman*, 22.

Dhuna në familje: Një fenomen paralizues për familjen dhe shoqërinë shqiptare

Dok. Ana Uka (Bulku)
Universiteti BEDËR, Tiranë

Abstrakt

Dhuna në familje është një nga fenomenet më të përhapura dhe një nga krimet më të paraportuara në shoqërinë shqiptare dhe kjo e bën të pamundur matjen me saktësi të përmasave të një fenomeni të tillë. Dhuna në familje është trajtuar më shumë si një problem individual, i cili i përket vetëm anëtarëve të familjes dhe jo shoqërisë. Kjo është përgjegjësi e shtetit dhe individëve për të marrë hapa efektivë për të mbrojtur gratë dhe fëmijët dhe për të ndaluar dhunën. Statistikat tregojnë se vetëm 0 % e grave të dhunuara raportojnë dhunën. Studimet tregojnë se dhuna në familje, veçanërisht kundër grave dhe vajzave, është rritur gjatë periudhës së tranzicionit. Ky problem i komplikuar me rrënjët e tij në marrëdhëniet bashkëshortore, ka një ndikim negativ edhe në prindërim. Gratë që janë viktima të dhunës në familje kanë zakonisht vështirësi të përqendrohen dhe në mënyrë efektive të punojnë me fëmijët e tyre, janë më të prirura për shmangie apo mohim të situatës dhe e neglizhojnë ndikimin e dhunës mbi veten dhe fëmijët e tyre. Një strategji kombëtare është e nevojshme për të siguruar që të gjitha format e dhunës në familje të identifikohen, shkaktohen dhe ndikimet e saj të adresohen dhe politikat sociale dhe programe të ndryshme ndërhyrjeje të implementohen për të parandaluar çdo lloj pasojë që mund të dëmtojë familjen dhe mbarë shoqërinë shqiptare.

Fjalët kyçe: Dhuna, familja, gratë, prindërimi, fëmijët, ligji, shoqëria

1. Hyrje

Shqipëria, si një vend që ka kaluar një periudhë të vështirë tranzicioni, radhitet ndër vendet që ka pësuar më shumë ndryshime politike, sociale dhe ekonomike, të cilat kanë prekur jetën e shumë individëve dhe familjeve shqiptare. Në ditët e sotme, Shqipëria

po përballet me shumë sfida në lidhje me dhunën në familje. Dhuna në familje është një nga fenomenet më të përhapura dhe një nga krimet më të paraportuara në shoqërinë shqiptare dhe kjo e bën të pamundur matjen me saktësi të përmasave të një fenomeni të tillë. Dhuna në familje është një kërcënim i përhapur dhe serioz për

jetën dhe mirëqenien e grave. Vetëm 5 për qind e grave të dhunuara raportojnë dhunën. Çdo formë e ‘shuplakës’ që ushtrohet mbi një grua është shkelje e të drejtave të saj. Në shumë raste ajo e lë gruan me dëmtime psikologjike dhe fizike, duke dobësuar aftësinë e saj për të jetuar një jetë të plotë. Dhe fëmijët mësojnë atë çfarë ata shohin - fëmijët që janë dëshmitarë ose përjetojnë dhunë në shtëpi, shpesh rriten duke e ushtruar atë tek partnerët dhe fëmijët e tyre, duke u bërë shkak i përsëritjes së një cikli të dhunës, që vazhdon ndër breza (UNICEF, 2003). Sipas një studimi mbarëkombëtar i kryer në vitin 2003 nga UNICEF, të paktën 8 për qind e grave shqiptare kanë pësuar dhunë fizike në duart e një partneri intim, dhe 25 për qind kanë përjetuar dhunë psikologjike.

“Gazetat dhe media në përgjithësi raportojnë thujse çdo ditë rreth këtij fenomeni të vështirë për t’u trajtuar dhe akoma më të vështirë për t’u raportuar, pasi të kuptosh dinamikat e dhunës shumë shpesh nuk është e lehtë” (GADC, 2008). Ajo është trajtuar më shumë si një problem individual, i cili i përket vetëm anëtarëve të familjes dhe jo shoqërisë. Të drejtat e njeriut janë shkelur shpesh në shoqëritë në tranzicion, ku kanë ndodhur shumë transformime të rëndësishme politike, sociale dhe ekonomike. Studimet tregojnë se dhuna në familje, veçanërisht kundër grave dhe vajzave, është rritur shumë sidomos gjatë dekadës së fundit. «Edhe në vitet e para të sistemit demokratik, problemi nuk kishte ato përmasa që ka sot, por ai është rritur gjatë pesë apo gjashtë viteve të fundit, duke u bërë një shqetësim real» (Lloja & Xhemali, 2005).

Përmirësimi i praktikave të të drejtave të njeriut duhet të jetë objektiv kryesor për reformatorët vendas, si dhe komunitetin ndërkombëtar (Horowitz & Schnabel, 2004). Ky punim do të ofrojë një përshkrim të gjendjes aktuale në lidhje me dhunën në familje në Shqipëri, si dhe ndikimet negative të saj ndaj fëmijëve, prindërimit, formimit të marrëdhënieve mes anëtarëve të familjes dhe zhvillimit të shoqërisë.

2. Një këndvështrim i shkurtër i dhunës në familje në Shqipëri

Dhuna në familje është bërë një problem serioz në Shqipëri. Sipas Raportit të Progresit të Shqipërisë (2008), të përgatitur nga Komisioni i Komuniteteve Evropiane, është konstatuar se dhuna në familje është një fenomen “i rëndësishëm, i cili ka ardhur në rritje”, për shkak të mungesës së mosmarrjes së masave të duhura në kohë dhe moszbatimit të ligjeve. Ata shprehën gjithashtu se një numër shumë i vogël rastesh të dhunës në familje raportohen, hetohen dhe ndiqen penalisht. Në fakt Kodi Penal e trajton dhunën në familje, si një sulm që të çon drejt një krimi të përgjithshëm. Vetëm plagosje e rëndë me dashje dënohet sipas nenit 88 nga tre gjer në dhjetë vjet burgim. Edhe pse ka disa rregulla në lidhje me këtë problem, problemi qëndron në atë që viktimat nuk e konsiderojnë dhunën në familje si një krim ose ata frikësohen nga raportimi i incidenteve pasi mund të shkaktojë turp mbi familjet e tyre.

«Gratë janë bindur të pranojnë se burrat janë më të fortë dhe më të zotë se femrat, ata e kuptojnë se shteti favorizon

burrat, pozicionet e pushtetit janë të zëna nga burrat, dhe kjo reflekton kudo – në punësim, socializim, rrjete (Qendra për Paqe dhe Drejtësi).»

Statistikat tregojnë se të paktën një e treta e të gjitha grave në Shqipëri kanë përjetuar dhunë fizike, ku shumë prej tyre kanë qenë të goditura, të rrahura, të përdhunara dhe madje vrarë nga burrat e tyre, ish-bashkëshortët apo partnerët intimë. Dhuna kundër grave shpesh është toleruar dhe ajo kurrë nuk ka qenë konsideruar dhe trajtuar si një abuzim i të drejtave të njeriut, të grave dhe vajzave, duke përfshirë të drejtat e tyre mbi sigurinë, lirinë e fjalës dhe integritetit fizik dhe mendor. Një dhunë e tillë ka qenë gjithmonë e justifikuar për shkak të traditës apo «mentalitetit» shqiptar edhe nga ana e qeverisë dhe organeve gjyqësore.

«Duke ditur se gratë dhe vajzat e mitura shpesh nuk e raportojnë dhunën që ushtrohet kundër tyre, sepse ata shpesh nuk e kuptojnë që janë viktimat e saj, por më shumë e konsiderojnë veten e tyre si pjesëmarrëse në dhunë, shteti duhet ... të informojë gratë për të drejtat e tyre ligjore dhe t'i edukojë ata veçanërisht në lidhje me dhunën në familje. Në familjet tradicionale gratë duhet të ndjekin rregullat, ata duhet të jenë “vajza të mira” dhe dhuna është pjesë e kësaj tradite. Ata nuk e shohin dhunën në familje si dhunë; ata e shohin atë si normale» (SRVAW, Raporti i Komisionit për të Drejtat e Njeriut, 1996).

Roli i qeverisë dhe autoriteteve kombëtare ka qenë shumë i kufizuar ose më saktë jo-ekzistent në mbështetjen dhe sigurimin e ndihmës për viktimat e

dhunës në familje në Shqipëri. Një rol aktiv në trajtimin e këtij fenomeni kanë luajtur organizatat jo-qeveritare (OJQ) të grave, të cilat kanë ofruar shërbime të shumta duke përfshirë linja ndihme dhe strehëza për të mbështetur dhe për të mbrojtur këto gra nga ushtruesit e dhunës. Për arsye mosbesimi ndaj policisë së shtetit apo mosnjohja e dhunës në familje, si një akt kriminal dhe duke pasur ndjenjën e turpër, gratë nuk janë të inkurajuar, që të ankohen në lidhje me dhunën, por më tepër ta pranojnë atë si fatin e tyre të keq. Arsye të tjera të mosraportimit të dhunës ose të mosankimit në lidhje me të, është pamundësia e tyre për të mbështetur financiarisht veten dhe fëmijët kur ata largohen apo divorcohen nga partnerët e tyre.

3. Efektet e dhunës tek fëmijët

Vitet e fundit, sjelljet e dhunshme kanë marrë përmasa të mëdha sidomos në zonat urbane prandaj dhe fëmijët kanë qenë të ekspozuar ndaj dhunës në shtëpi, shkollë dhe komunitet. Dhuna në familje është konsideruar si një formë e abuzimit të fëmijëve, ku fëmijët preken në mënyrë të pashmangshme nga ky fenomen (Lapierre, 2008). Dhuna në shtëpi mund të marrë formën e një ose më shumë incidenteve traumatike, që mund të shkaktojnë një ndryshim të papritur. Ndryshime të tilla shpesh vihen re në sjelljen e fëmijës, si p.sh. agresiviteti, apo mungesa e respektit ndaj grave. Dhuna në shtëpi gjithashtu ndryshon mënyrën se si fëmijët mendojnë dhe ndjehen - për veten, familjet e tyre dhe jetën në përgjithësi (Cunningham & Baker, 2007). Ata



thonë se fëmijët janë vëzhgues të mirë dhe interpretues të dobët, pra ata janë në gjendje të dëgjojnë dhe të shohin atë çfarë ndodh, por ata nuk arrijnë të kuptojnë situatën si të rriturit. Fëmijët mund të jenë të zemëruar sepse nëna e tyre qëndron me një person të tillë, ata kanë frikë se ajo do të shkojë përsëri tek ai, ose shqetësohen se ajo mund të njihet me një partner tjetër abuziv. Pra, fëmijët nuk mund të besojnë se nëna e tyre mund t'i mbajë ata në një ambient të sigurt, madje mund të dyshojnë nëse ajo i do ata apo jo. Cilësia e marrëdhënieve që prindërit dhe sidomos nënat, krijojnë me fëmijët e tyre që në fëmijëri, është një parashikues i rëndësishëm i zhvillimit të fëmijëve dhe të të gjitha marrëdhënieve, që fëmija krijon gjatë jetës së tij (Bornstein 2002; McCain & Mustard 1999).

Ndonjëherë fëmijët mund të zhvillojnë edhe disa besime negative, që janë thelbësore për veten e tyre, si p.sh. të pyesësh veten: “A jam unë dikush që meriton të jetë i lumtur?” Besime të tilla formohen që në fëmijëri dhe prindërit luajnë një rol të rëndësishëm gjatë këtij procesi (Bancroft & Silverman,

2002). Hulumtimet tregojnë gjithashtu se fëmijët të cilët kanë qenë viktime të dhunës brenda familjeve të tyre kishin 24% më shumë gjasa të raportojnë sjelljen e dhunshme si adoleshentë, sesa ata që nuk kishin qenë të keqtrajtuar. Adoleshentët të cilët nuk kanë qenë të viktimizuar, por vetë ishin rritur në familje ku ndodhej një partner dhunues kishin 21% më shumë gjasa të raportojnë delikuençën e dhunshme, sesa ata që nuk kanë qenë të ekspozuar ndaj saj (Baker & Jaffe, 2003). Përpjekjet që janë bërë për vlerësimin dhe trajtimin e shëndetit mendor për të rinjtë, të cilët kanë qenë dëshmitarë të dhunës kanë qenë shumë të kufizuara. Hulumtime të kufizuara tregojnë gjithashtu se si pasojë e ekspozimit ndaj dhunës, fëmijët mund të jenë në rrezik të shfaqin simptoma të çrregullimit të stresit post-traumatik, depresion dhe ankth ndarjeje, hidhërim dhe agresivitet, dëmtime të marrëdhënieve ndërpersonale me kolegët dhe lidhjeve me bashkëmoshatarët dhe arritje të dobëta akademike. Kjo është e mbështetur edhe nga gjetjet e studimit të Levendosky-t dhe bashkëautorëve të tij (2006), ku fëmijët me një të kaluar dhune familjare janë të predispozuar për të shfaqur sjellje problematike në ambientin e jashtëm.

Në një tjetër studim me 103 fëmijë parashkollorë, të cilët ishin në rrezik të ekspozimit të dhunës në familje ndaj nënave të tyre, u gjet se dhuna në familje ndikonte negativisht në sjelljen ndërvepruese të fëmijëve me nënat, por e cila nuk ndikonte në raportimin e nënës për sjelljet problematike të fëmijës. Këto gjetje sugjerojnë se ndikimi

i dhunës në familje fillon shumë herët, duke reflektuar më shumë në fushën e marrëdhënieve të ndërtuara me nënën dhe individë të tjerë, sesa në shëndetin mendor të fëmijës (Levendosky et al., 2003). Në një studim të Holden (1998), raportohet se dhuna martesore është e lidhur me një gamë të gjerë problemesh të sjelljes dhe përshtatjes si p.sh. probleme emocionale dhe të sjelljes së fëmijëve. Efektet e dhunës në familje janë cilësuar nga Rossman (2001), si efekte afatgjata, ku ekspozimi në çdo moshë mund të krijojë ndërprerje dhe çrregullime në të gjitha aspektet e zhvillimit të fëmijëve. Të jesh dëshmitar i një abuzimi të nënës nga partneri i saj për një kohë të gjatë, ndikon në perceptimin e fëmijës apo adoleshentit ndaj nënës si një viktimë e pambrojtur, emocionalisht e padisponueshme për të, një person vetëm me një autoritet legjitim prindëror, apo si dikush që nuk mund ta mbrojë atë. Shpesh herë në këto raste ndodh një ndërrim i roleve, ku fëmija kalon në rolin kujdestar ndaj nënës së viktimizuar duke lënë pas të gjitha ëndrrat dhe dëshirat femënore.

4. Dhuna në familje dhe çështjet e prindërimit

“Dhuna ndodh kudo, në komisariatit e policisë, në shtëpi, në shkollë - është një cikël dhune në të gjithë shoqërinë, (Proni, Drejtor i HRDC). “

Dhuna ndaj grave është një kërcënim serioz për shëndetin e grave në të gjithë botën. Një dhunë e tillë mund të ndërhyjë në sjelljet e tyre prej nëne. Ky problem i komplikuar me rrënjët e saj në marrëdhëniet



bashkëshortore ka një ndikim negativ në prindërim. Gratë që janë viktime të dhunës në familje kanë zakonisht vështirësi të përqendrohen dhe në mënyrë efikase të punojnë me fëmijët e tyre; janë më të prirura për tërheqje dhe shmangie dhe injorojnë ndikimin e dhunës mbi veten dhe fëmijët e tyre. Këto nëna rrezikojnë të vriten apo të plagosen seriozisht dhe në shumicën e kohës ata vuajnë nga dhimbjet kronike, depresioni, çrregullime psikosomatike, shtatzëni të padëshiruara, aborte spontane dhe kështu me radhë. Rolet që luajnë të gjithë pjesëtarët e një familjeje abuzive reflektojnë se si çdo person i përshtatet dhe mësohet me fshehtësinë, intrigat, dhe me situatën e rrezikshme në të cilën ata jetojnë. Një njeri abuziv shkatërron përpjekjet e një nënë për të prindëruar, qoftë duke e kundërshtuar atë, duke dobësuar besimin e saj si një prind, apo duke ndryshuar pikëpamjen e fëmijëve të saj ndaj nënës duke mos e konsideruar si një person të denjë për respekt. Ajo mund të ndryshojë stilin e saj të prindërimit (Bancroft & Silverman, 2002).

«Shumica e grave zakonisht nuk e denoncojnë dhunën në polici: ata nuk e kuptojnë se ajo është një vepër penale,

dhe shumë prej tyre janë të dhunshme ndaj fëmijëve të tyre - ata e shohin atë si një mjet edukimi (Proni, Drejtor i HRDC).»

Efektet e dhunës mund të vazhdojnë edhe pasi abuzimi ka ndaluar dhe efekte të tilla mund të jenë kumulative. Rezultatet e një studimi (Albania Reproductive Health Survey) të kryer nga Ministria e Shëndetësisë në vitin 2002, tregojnë se 11.5 për qind e grave shqiptare mes moshave 15-44 vjeç kishin fëmijë dëshmitarë të abuzimit prindëror. Gjithashtu individë meshkuj me të njëjtin profil shoqëror kanë raportuar se kanë vërejtur (47.4 për qind) dhe kanë përjetuar, (66.8 për qind) nivele të larta të dhunës si fëmijë. Një sondazh i kryer nga profesionistë në sektorin e shëndetësisë tregon një tjetër profil të një abuzimi të tillë. Ata gjetën se 37 për qind e grave që jetojnë në Tiranë kanë përjetuar dhunë fizike, ku femrat e moshës 25-34 ishin në rrezik më të lartë. Sipas gjetjeve të tyre, me rritjen e nivelit arsimor të grave, rritej edhe rreziku për t'u abuzuar. Gjithashtu edhe në familjet ku vetëm gratë ishin të punësuar, rreziku për t'u abuzuar ishte më i lartë. Gjetje të tilla janë në përputhje me teoritë që argumentojnë se dhuna është përdorur për të zbatuar hierarkinë gjinore (Burazeri et al., 2005).

Në ditët e sotme, vihet re një shqetësim i madh ndaj efekteve të dhunës mbi fëmijët dhe një vëmendje e kufizuar i ushtrohet efektit të dhunës ndaj nënave dhe prindërimit të tyre. Shqetësime të tilla kanë qenë gjithmonë të përqendruara më shumë tek fëmijët se sa tek gratë që luajnë një rol kyç në mirëqenien e fëmijëve të tyre.

Megjithëse disa studime tregojnë se dhuna në familje nuk ka një ndikim të madh në sjelljet prindërore ndaj rritjes së fëmijëve, kjo nuk do të thotë se cilësia e prindit mbetet e njëjtë, si në një ambient të dhunshëm, ashtu edhe në familje jo të dhunshme (Holden, 1998). Për shembull, nënat e fëmijëve të ekspozuar ndaj dhunës në familje në fakt tregojnë një rritje të madhe të përdorimit të disiplinës pozitive dhe një rënie të lehtë në sjelljen e butë dhe të ngrohtë në krahasim me nënat e fëmijëve jo të ekspozuar ndaj dhunës (Levendosky et al., 2003 and Letourneau et al., 2007). Gjithashtu, është gjetur si i arsyeshem ndërmjetësimi i lidhjes mes dhunës në familje dhe sjelljes prindërore nëpërmjet përfaqësive të brendshme mendore të nënës, ndaj vetes së saj, fëmijës dhe përkujdesjes së saj (Stephens, 1999). Ndonjëherë, gratë ndjehen si në kurth dhe ato luftojnë për mbrojtjen e fëmijëve të tyre nga abuzuesit. Në këtë kontekst, nëna luan një rol të rëndësishëm në mënyrën se si fëmijët ndikohen nga dhuna. Shumë studime janë fokusuar më shumë në gratë e abuzuara ku në lidhje me prindërimin, ato janë konsideruar si nëna të falimentuara. Një numër i pakët studimesh janë bërë rreth efektit të dhunës në familje mbi përvojat e prindërimit nën rrethana të tilla, pavarësisht nga pozita e nënës.

5. Përfundime dhe rekomandime

Deri tani, ky punim ka zbuluar disa nga vështirësitë që gratë hasin në lidhje me prindërimin nën rrethanat e dhunës në familje dhe ndikimin negativ të saj tek gratë dhe fëmijët. Në kontekstin e dhunës në familje, gjyqësorit shqiptar

dhe institucioneve të tjera qeveritare u mungon vullneti për të përqendruar kompetencat e tyre në mirëqenien e fëmijës, grave dhe çështjeve të tyre që lidhen me prindërimin. Ky fenomen konsiderohet dhe trajtohet nga shteti dhe organet gjyqësore si një krim brenda familjes dhe mendohet se një problem i tillë do të zgjidhet menjëherë pasi dhunuesi të dënohet. Pas kësaj, asnjë program ndërhyrjeje apo rehabilitimi nuk ofrohet në shërbim të nënës dhe fëmijëve për rikuperimin e këtyre viktimave nga kjo traumë, nga ana e strukturave shtetërore. Në fakt, siguria dhe të drejtat e viktimave të dhunës në familje duhet të jenë prioriteti më i lartë në të gjitha aspektet e shërbimeve që ofrohen nga ana e institucioneve gjyqësore.

Gjithashtu, profesionistë të mirëqenies së fëmijës dhe familjes duhet të jenë të vetëdijshëm dhe të vlerësojnë rrezikun për fëmijët dhe marrëdhëniet

që krijojnë me nënat e tyre dhe të ndërhyjnë në mënyrë të përshtatshme dhe në kohën e duhur për parandalimin e këtij fenomeni. Kur në shumicën e rasteve janë partnerët meshkuj abuzuesit në familje, është e rëndësishme të bëhen edhe ata pjesë e këtij problemi dhe të përfshihen në programet e ndërhyrjes. Në këtë mënyrë, angazhimi i tyre si baba me fëmijët, mund të hapë mundësi për ndryshim.

Pra, strategjitë e dhunës në familje dhe programet e ndërhyrjes duhet të përparojnë premisën e tyre se dhuna në familje është një aktivitet kriminal dhe është një sjellje e mësuar, dhe prandaj është e ndryshueshme. Në fokusin e politikave sociale dhe praktikave të lidhura me dhunën në familje, duhet të jetë përmirësimi i sigurisë së grave dhe fëmijëve dhe parandalimi i sjelljeve abuzive, frikësuese dhe të dhunshme të keqbërësve ndaj kësaj kategorie të popullatës shqiptare.

Bibliografia

1. AI Interview with Andrea Gurakuqi. Peace and Justice Center. Shkodra.
2. Baker, L. L. & Jaffe, P. G. (2003). Youth exposed to domestic violence: A handbook for the Juvenile Justice System to enhance assessment and intervention strategies for youth from violent homes. Center for children and families in the Justice System, p. 7.
3. Bancroft, L. & Silverman, J. (2002). The batterer as parent: Addressing the impact of domestic violence on family dynamics.: Sage, Thousand Oaks, CA.
4. Bornstein, M. (Ed.). (2002). Handbook of parenting: Vol. 1: Children and parenting (2nd ed.). Mahwah, NJ: Erlbaum.
5. Burazeri G., Roshi E., Jewkes R., Jordan S., Bjegovi V., & Laaser U. (2005). "Factors associated with spousal physical violence in Albania: Cross sectional study", British Medical Journal 331, 197-201.
6. Cunningham, A. & Baker, L. (2007). Little eyes, little ears: How violence against a mother shapes children as they grow. The center for children and families in the justice sistem (book).
7. Dhuna në familje në fokusin e medias – Udhëzues. (2008). Aleanca Gjinore për Zhvillim (GADC). E marrë nga: www.gadc.org.al
8. Holden, G.W. (1998). Introduction: the development of research into another consequence of family violence. In: Children Exposed to Marital Violence: Theory, Research, and Applied Issues (eds G.W. Holden, R.A. Geffner & E.N. Jouriles), p. 1–20. American Psychological Association, Washington.
9. Horowitz, Sh. & Schnabel, A. (April, 2004). Human rights and societies in transition: Causes, consequences, responses. United Nations University Press, Tokyo, New York, Paris.
10. Lapierre, S. (2008). Mothering in the context of domestic violence: the pervasiveness of a deficit model of mothering. Child and Family Social Work 13, 454-463.
11. Letourneau, N. L., Fedick, C. B. & Willms J. D. (2007). Mothering and domestic violence: A longitudinal analysis. Journal of Family Violence.
12. Levendosky, A. A., Huth-Bocks, A. C., Shapiro, D. L. & Semel, M. A. (2003). The impact of domestic violence on the maternal-child relationship and preschool-age children's functioning. Journal of Family Psychology 17(3), 275-287.
13. Levendosky, A. A., Leahy, K. L., Bogat, G. A., Davidson, W. S. & von Eye, A. (2006). Domestic violence, maternal parenting, maternal mental health, and infant externalizing behavior. Journal of Family Psychology 20(4), 544-552.
14. Lloja, A. & Xhemali, B. (2005). Crime within the family. The Review of Albanian Legal Medicine 2, 9-16.
15. McCain, M., & Mustard, F. (1999). Early years study: Reversing the real brain drain. Ottawa: Canadian Institute of Advanced Research.
16. Rossman, B. B. R. (2001). Longer term effects of children's exposure to domestic violence. Domestic Violence in the Lives of Children: The Future of Research, Intervention, and Social Policy (eds S.A. Graham-Bermann & J.L. Edleson), p. 35–65. American Psychology Association, Washington.
17. SRVAW, report to the Commission on Human Rights, (1996). AI Interview with NGO. Useful to albanian women.
18. Stephens, D. L. (1999), Battered women's views of their children. Journal of Interpersonal Violence 14, 731–746.
19. How prevalent is domestic violence in Albania. Retrieved from: www.unicef.org

...vizitoni të sëmurët,...

Iilir Akshija, M.D., M.Sc.
Spitali Universitar “Nënë Tereza”,
Departamenti i Statistikave, iakshija@yahoo.com

Abstrakt

I sëmuri, cilido nga ne, mbetet i vendosur midis frikës si do të përfundojë sëmundja dhe shpresës për përmirësim dhe shërim. Në një situatë të tillë të vështirë pagesa për të përfituar shërbimin më të mirë shëndetësor mbetet një nga shtyllat, që kontribuojnë në rezultatin përfundimtar të situatës. Detyrimet dhe të drejtat në raport me sistemin shëndetësor janë tashmë të konsoliduara dhe pavarësisht që ndryshojnë vazhdimisht, ndryshimi bëhet mbi një bazë të mëparshme. Financimet e shëndetit në rang sistemi janë një koncept i ri, ndërkohë që besimet fetare, e në rastin konkret islami, kanë pozicionin e tyre për këto çështje madhore. Detyrë e jona mbetet analizimi, nxjerrja e konkluzioneve dhe zbatimi i drejtë i asaj çfarë Kur’ani dhe Sunneti tashmë na kanë ofruar si zgjidhje. Në kohë të ndryshme jetojnë njerëz të ndryshëm dhe së bashku me to edhe këndvështrime të ndryshme dhe pikërisht në këtë kuadër shprehja profetike mbi “vizitën e të sëmurit” duhet shikuar përveç këndvështrimit tradicional edhe sipas këndvështrimit të situatës bashkëkohore. Artikulli merr përsipër të vendosë të sëmurin mysliman dhe shoqërinë e myslimanëve në kontekstin e situatës kontraktuale që kanë me shtetin në lidhje me shëndetin dhe mundësitë e ofruara nga përkatësia e tyre në fenë Islame.

Fjalëkçe. Sëmundja, i sëmurë, zekat, sadaka, shëndet, financim.

Një ndër rekomandimet e Profetit (a.s.), është vizita e të sëmurëve. Tema e sëmundjes dhe e përfundimeve të saja, si shërimi, vdekja dhe invaliditeti takohen si në Kur’an edhe në Sunnet. Madje në Kur’an janë përcaktuar edhe gjashtë ajetet e shërimit. Sëmundja e ka shoqëruar gjithmonë njeriun e kësaj bote duke qenë një nga sfidat dhe sprovat më

të vështira. Përkundër kësaj në Islam nuk mungon asnjëherë shpresa dhe ofrimi i zgjidhjes me përjashtim të sëmundjes që shkakton largimin përfundimtar nga kjo botë. Në vuajtjen e tij i sëmuri nuk është vetëm, edhe nëse nuk ka asnjë person tjetër duket se Allahu (xh.sh.) nuk e braktis, sidomos të durueshmit duke i quajtur edhe besimtarë të vërtetë, “... e atyre që durojnë në kohë skamjeje,

sëmundjeje dhe luftime. Këta janë besimtarët e vërtetë dhe këta janë ata që e kanë frikë Allahun.”¹

Duke qenë një problem jo vetëm i Islamit dhe myslimanëve, por i të gjithë njerëzimit, sëmundja dhe marrëdhënia e njeriut dhe e shoqërisë me të ka një numër shumë të madh përfaqësues, që fillon që nga diagnostikimi e trajtimi, duke përfshirë një komponent jo të parëndësishëm siç është financimi. Kushdo që ka pasur një njeri të sëmurë në familje ose ka qenë vetë i sëmurë, e kupton që problemi është shumëdimensional, ku përveç kërkimit me ankth të zgjidhjes më të mirë të mundshme shtohet edhe kërkimi i afërsisë me Allahun (xh.sh.), jo për të kritikuar njerëzit, por si pjesë e natyrës së tyre. Gjithë ky spektër aktivitetesh takohen masivisht në përditshmërinë e jetës së myslimanëve dhe madje inkurajohen drejtpërdrejt nga Profeti (a.s.), si kërkimi i ndihmës drejtuar Allahut (xh.sh.), edhe kërkimi i zgjidhjes ‘teknike’ të problemit. Në mjaft raste, për të mos thënë në të gjitha rastet, pjesë e zgjidhjes është edhe pagesa për gjetjen e zgjidhjes më të mirë, ose financimi i shërbimit mjekësor. Zgjidhja më e mirë vendoset ndërmjet tjerash edhe nga sasia e parave në dispozicion për të marrë shërbimin më të mirë. Para që janë të kufizuara dhe pavarësisht çfarë sistemi kemi zgjedhur apo na kanë zgjedhur për të jetuar, janë të kufizuara dhe pse jo edhe të keqmenaxhuara. Pikërisht me komponentin e financimit të shërbimeve shëndetësore nuk kam gjetur diskutime në literaturën Islame në shqip, por ndoshta edhe më gjerë. Të gjithë vendet, përfshirë ato me maxhorancë myslimane kanë sisteme

që financojnë shëndetësinë, por mendoj që përfitimi nga zgjidhjet e ofruara nga Kur’ani dhe Sunneti në shoqërinë e sotme janë të kufizuara.

Ajeti i cituar më sipër bën thirrje për durim gjatë sëmundjes dhe e përfshin sëmundjen së bashku me skamjen dhe luftën. Janë bashkuar në një ajet tre situata shumë të vështira për njeriun dhe sigurisht janë tre sprovat më të rënda në jetë. Dy nga situatat, skamja dhe lufta, janë diskutuar gjerësisht në komponentin e financimit të tyre, ndërsa sëmundja nuk ka diskutim të drejtpërdrejtë për financimin e kësaj situatë. Pagesat për shërbimet shëndetësore kanë qenë të gjithmonshme, por modelet e financimit në rang sistemi janë moderne. Atëherë t’i rikthehem bazës së kërkimit tonë dhe të shikojmë se çfarë rekomandohet për të sëmurin dhe sëmundjen.

Kemi kërkuar në versionin shqip të Kur’anit online² dhe kemi gjetur rezultatet si më poshtë, me fjalëkyçet respektive;

- **sëmurë** - gjithsej u gjetën 12 ajete (2:184, 2:185, 2:196, 4:43, 4:102, 5:6, 9:91, 23:25, 24:50, 37:89, 37:145, 73:20),
- **sëmundje** - gjithsej u gjetën 7 ajete (2:10, 2:177, 5:52, 8:49, 9:125, 33:12, 33:32),
- **zekat** - gjithsej u gjetën 31 ajete,
- **sadaka** - gjithsej u gjetën 7 ajete,
- **japin** - gjithsej u gjetën 48 ajete.

Gjatë kërkimit mund të ketë diferenca në rezultate sipas përkthyesve, Hasan Nahi dhe Sherif Ahmeti. Gjithsesi kërkimi më i mirë i mundshëm do të ishte në gjuhën arabe në origjinal. Fjala sëmundje përdoret edhe për sëmundjet e si mangësi në besim edhe si sëmundje fizike.

2. <http://www.kuranifisnik.net/KuraniFisnik/Ballina>; 22 korrik 2013.

1. Kur’ani, Bekare, 177.

Ajetet që e përmendin sëmundjen trajtojnë çështje si lehtësimi për njerëzit e sëmurë nga detyrime të rëndësishme si lufta dhe agjërimi, gjendje të personave ose kategorive të caktuara dhe rekomandime për shërim. Tek rekomandimet e shërimit futen dhe gjashtë ajetet e konsideruara si Ajetet e Shërimit dhe jo vetëm këto shërbejnë për këtë qëllim. Nuk takohen ajete specifike në lidhje me mënyrën e përfitimit të shërbimeve shëndetësore.

Çfarë përmasash ka financimi i sistemit shëndetësor sot në botë?

Tema është shumë e gjerë dhe po kufizohemi shkurtimisht në disa të dhëna për të treguar peshën e financimit të shëndetit në botë, në kohën e sotme. Shpenzimet për shëndetin në Shqipëri gjatë viteve në vazhdim janë dhënë në tabelën e mëposhtme.

Tab. 1 Financimi i shpenzimeve për shëndet, Shqipëria, 2007 – 2009.³

	2007	2008	2009
		në 1000 LEK	
Financim publik	25.441.700	29.112.314	32.414.293
Financim privat	25.940.352	28.923.492	30.647.333
Ndihma të huaja	622.926	1.582.959	2.104.734
Totali i shpenzimeve	52.004.977	59.618.766	65.166.360
		si % e GDP	
Financim publik	2,63	2,68	2,81
Financim privat	2,68	2,66	2,66
Ndihma të huaja	0,06	0,15	0,18
Totali i shpenzimeve	5,38	5,48	5,65

Tab 2 Shpenzimet për shëndet në disa prej vendeve të OECD [Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim], 2009.⁴

Shpenzimet totale për shëndet				
	Popullata (milionë)	GDP për frymë^a	Për frymë^b	% GDP
Kanada	33.4	\$38,230	\$4,363	11.40%
Gjermani	81.9	\$36,328	\$4,218	11.60%
Japoni	127.5	\$32,431	\$2,878 ^a	8.5% ^a
Svicër	7.7	\$45,150	\$5,144	11.40%
Mbretëria e Bashkuar	60.9	\$35,656	\$3,487	9.80%

3. Development and Institutionalization of National Health Accounts (NHA), Albania; Tirana, Augsburg, July 27, 2010; REPUBLIC OF ALBANIA, MINISTRY OF HEALTH.

4. Burimi: OECD Health Data 2011 (Nov. 2011).

SHBA	306.7	\$45,797	\$7,960	17.40%
OECD Mediana	10.7	\$33,434	\$3,182	9.50%

^a 2008.

^b Axhustuar për diferencat në koston e jetesës.

SHBA ende shpenzon më shumë se çdo vend tjetër, duke i dedikuar më shumë se 17 % të produktit të brendshëm bruto (GDP) për kujdesin shëndetësor në krahasim me 12 % ose më pak në të gjitha vendet e tjera.⁵

Harta e mëposhtme tregon shpërndarjen e shpenzimeve për shëndetin si përqindje e buxheteve të shteteve në të gjithë botën. Shikohet që ka ndryshime të mëdha në financimin e shëndetit në rajone të ndryshme. Megjithatë kjo nuk është qëllimi i diskutimit tonë. Me këto të dhëna kemi për qëllim të japim një paraqitje të përmasave të mëdha që merr komponenti i financimit të shëndetit në botë. Po t'i hedhim një sy shifrës që merr nga buxheti i shpenzimeve për shëndet në SHBA është e lehtë për të kuptuar që bëhet fjalë për treg të shëndetit dhe gjithashtu kjo sasi parash është edhe një komponent i rëndësishëm politik dhe shoqëror.⁶




Fig. 1 Shpenzimet e përgjithshme për shëndetin si përqindje e GDP, 2011*⁷
*Bazuar në të dhëna të përditësuara në Mars 2013.

5. David A. Squires; Explaining High Health Care Spending in the United States: An International Comparison; Issues in International Health Policy; May 2012.

6. http://gamapserv.who.int/mapLibrary/Files/Maps/TotPercentGDP_2011.png,
<http://gamapserv.who.int/mapLibrary/app/searchResults.aspx>; 22 Korrik 2013.

7. Data Source: Global Health Observatory, WHO Map Production. Public Health Information and Geographic Information Systems (GIS) World Health Organization ©WHO 2012.

Cilat janë burimet e financimit?

Mënyrat e financimit ndryshojnë shumë nga vendi në vend dhe vlera e tyre gjithashtu. Megjithatë jemi munduar të japim në mënyrë të përmbledhur këtë informacion. Transparenca në mbledhjen dhe shfrytëzimin e fondit si një pasuri publike është e rëndësishme dhe prandaj nevojitet edhe njohja e krijimit të tij. Procesi i mbledhjes së fondeve përmban tre elementë: burimet e financimit, mekanizmat kontribuues për mbledhjen e fondit dhe organizatat përgjegjëse për mbledhjen e fondit (shiko Tab. 2.1). Individët dhe ndërmarrjet e biznesit janë burimi kryesor i mbledhjes së fondeve për kujdes shëndetësor, megjithëse disa fonde mund të kanalizohen nëpërmjet organizatave joqeveritare dhe agjencive multilaterale.⁸

Procesi tjetër pas sigurimit të fondeve dhe mbledhjes së tyre është blerja e shërbimeve për shëndetin. Nuk është më pak e rëndësishme dhe në fund tregon se si janë përdorur paratë e mbledhura.

Tab. 3 Procesi i mbledhjes së fondeve: burimet e financimit, mekanizmat kontribuues dhe organizatat që bëjnë mbledhjen.⁹

Burimet e financimit	Mekanizmi i kontributeve	Organizatrat që mbledhin fondet
Individë, familje dhe të punësuar	Publike	Qeverisja qendrore, rajonale ose lokale
Firmat, korporatat dhe punëdhënësit	Taksim direkt dhe indirekt	Organe të pavarura publike
	Sigurimi i detyrueshëm	ose agjensitë e sigurimeve shoqërore (në bashkëpunim, për të gjitha benefitet, ose vetëm për benefitet shëndetësore)
OJQ dhe organizata bamirëse vendore dhe të huaja	kontributet (taksa të vendosura me qëllim specifik)	Fondet publike të sigurimeve ose fondet private të sigurimeve fitimprurëse ose jo-fitimprurëse
	Private	
Qeveritë e huaja dhe agjensitë multilaterale	Sigurimet private primet e sigurimit	
	Llogari kursimesh për shëndetin	
	Pagesat nga xhepi (pagesa direkte ose ndarje kostoje/ pagesa që i ngarkohen përdoruesit)	

Një mendim rreth përqasjes sipas Islamit të financimit të shëndetit

Islami dhe myslimanët gjithsesi kanë një këndvështrim specifik të botës. Para se të kalojmë në diskutimin se cilat mund të jenë disa veçanti të financimit të shëndetit në Islam, le të ndalemi vetëm një moment për të gjetur veçantinë e Islamit në raport me modelin sekularist të trajtimit të këtij problemi, model të cilin e aplikojmë çdo

8. Financing health care in the European Union; Challenges and policy responses; Sarah Thomson, Thomas Foubister, Elias Mossialos; © World Health Organization 2009, on behalf of the European Observatory on Health Systems and Policies; ISBN 978 92 890 4165 2.

9. Kutzin 2001; Mossialos & Dixon 2002.

ditë. Ka parime të pandryshueshme islame që përcaktojnë formën e marrëdhënieve ndërmjet njerëzve, por nuk ka asnjë strukturë islame ekonomike, shoqërore ose politike, e cili nuk mund të ndryshohet... Asgjë që mund të bëjë botën një vend më të mirë nuk mund të refuzohet si joislame... Në mënyrë që të jetë islame, një zgjidhje duhet të përmbushë dy kushte: duhet të jetë maksimalisht efiçente dhe maksimalisht humane...¹⁰

Islami nga ana tjetër e shikon botën si një sistem harmonik pjesëzash të nënshtruara ndaj Allahut (xh.sh.), njeriu jeton në harmoni me natyrën duke ndryshuar së bashku me të. Namazi i jacisë nuk falet gjithmonë në të njëjtën kohë, koha e tij ndryshon sipas stinëve, dikur më herët e dikur më vonë dhe njeriu i përshtatet kësaj natyre duke e mësuar këtë nëpërmjet udhëzimit hyjnor. Në të njëjtën mënyrë sillet edhe natyra me njeriun. Ndërkohë që një ditë pune me orar të fiksuar është shumë e ndryshme nga kjo lloj harmonie. Mund të mos e kuptojmë, por ky lloj orari është e qartë, që ka një logjikë të ndryshme dhe mjaft më arbitrare nga koha e ndryshueshme e faljes së namazit. Duket sikur është harruar parimi i harmonisë me natyrën. Një krahasim të ngjashëm do të bëja edhe me sjelljen e sistemeve shëndetësore, dhe të gjithë shoqërisë, ndaj njeriut të sëmurë. Mوندohemi me të gjitha mënyrat për t'i futur njerëzit nëpër kategori sëmundjesh dhe sigurisht edhe pagesat respektive dhe harrojmë që çdo person ka karakteristika të përbashkëta por ka edhe shumë specifike nga të tjerët. Pikërisht këto karakteristika specifike, mendoj, janë pjesë e harmonisë që kërkohet për të trajtuar një të sëmurë dhe konkretisht në rastin që po diskutojmë, të financojë një kërkesë shëndetësore.

Hadithet rreth vizitës së të sëmurit

Në kërkimin e haditheve që lidhen me temën e sëmundjes kemi gjetur me dhjetëra.¹¹

Po ndalemi vetëm në këto dy hadithe sepse në njërin prej tyre rekomandohet vizita e të sëmurit nga ana e Profetit (s.a.u.s.) dhe në tjetrin vetë Allahu (xh.sh.) e kërkon këtë vizitë dhe e përmend së bashku me detyrimin e ushqyerjes së të uriturit dhe dhënies ujë të eturit.

Ebu Hurejra (r.a.) tregon se Pejgamberi sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem. Thotë: *“Myslimani ndaj myslimanit ka këto pesë obligime: pranimin e selamit, vizitën e të sëmurit, përcjelljen e xhenazës, përgjigjen e ftesës si dhe kërkimin e shëndetit për ata që teshitjnë.”* (Muttefekun alejhi)¹²

Ebu Hurejra (r.a.) tregon se i Dërguari i All-llahut sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: “Vërtet All-llahu i Madhëruar do të thotë Ditën e Kijametit: “O njeri, isha i sëmurë dhe nuk më vizitove!” Njeriu atëherë do të përgjigjet: “O Zoti im, si do të të vizitoj

10. The Islamic Declaration (Islamska deklaracija) Alija Izetbegović. Published in 1969–70, and republished in 1990 in Sarajevo.

11. The Book of Visiting the Sick; <http://sunnah.com/riyadussaliheen/7>; This is book 7 of Riyad as-Salihin, containing 61 hadith; 22 Korrik 2013.

12. Riad Us Salehiin; Hadithe nga Muhammedi A.S.; Imam En-Nevevij; Biblioteka Islamike “Co Kavaja Albania”; 1994; Hadithi 893.

Ty, kur Ti je Zot i të gjitha botëve?” All-llahu do të thotë: *“A nuk e ke ditur se robi im ishte i sëmurë dhe nuk e ke vizituar? A nuk e di se, sikur ta kishe vizituar, me siguri do të më kishe gjetur Mua tek ai? O njeri, kam kërkuar prej teje ushqim, por nuk më ke dhënë?”* Njeriu do të përgjigjet: *“O Zoti im, si do të të jap unë Ty ushqim, kur Ti je Zot i të gjitha botëve?”* All-llahu do të thotë: *“A nuk e ke ditur që robi im ka kërkuar prej teje ushqim e ti nuk i ke dhënë? A nuk e ke ditur se, sikur t’i kishe dhënë ushqim, do të më kishe gjetur Mua tek ai? O njeri, Unë kam kërkuar prej teje të më japësh ujë, por ti nuk më ke dhënë të pi!”* Njeriu do të thotë: *“O Zoti im, si do të të jap unë Ty ujë, kur Ti je Zot i të gjitha botëve?”* All-llahu do të thotë: *“Ka kërkuar robi Im ujë prej teje e ti nuk i ke dhënë. Sikur t’i kishe dhënë ujë atij, do të më kishe gjetur Mua tek ai!”* (Transmeton Muslimi)¹³

Çfarë shohim kur vizitojmë të sëmurin?

Meqenëse i sëmuri që po shkojmë të vizitojmë është një përgjithësim i personave të sëmurë do të mundohemi të përmbledhim në mënyrë joshteruese se çfarë mbetet në mendjen tonë kur jemi kthyer nga kjo vizitë.

Së pari kur mbërrijmë shikojmë shtëpinë, spitalin ose vendin e punës së personit në fjalë. Këto mund t’i kemi parë edhe herë tjetër ose jo, ngaqë i sëmuri mund të jetë një familjar që e vizitojmë rregullisht, por edhe një mik ose koleg që e takojmë zakonisht në ambiente jo familjare ose është një familjar por që është i shtruar në spital, etj. Tashmë jemi të informuar për

rrethin familjar dhe kushtet e banimit brenda shtëpisë. I sëmuri mund të jetë në gjendje të përmirësuar apo të rëndë, mund të jetë me sëmundje ngjitëse ose me sëmundje tumorale, ose me çfarëdo sëmundje tjetër. Gjendja e tij psikologjike nuk është ajo që njohim ne në takimet e zakonshme me personin e sëmurë, përveç vuajtjes fizike shfaqet edhe ankthi dhe depresioni. Po të vazhdojmë listën e mendimeve pasi jemi kthyer nga i sëmuri mendoj se do të duheshin shumë faqe dhe gjithsecili e përjeton në mënyrë individuale. Sëmundja mund të jetë akute apo kronike, para ose pas operacionit, ka frikë dhe shpresë dhe lista vazhdon.

Duaja jonë për të sëmurin dhe falënderimi i Allahut (xh.sh.) janë vetëm njëra pjesë e të vërtetës që u bëmë prezent. Pjesa tjetër është realiteti të cilin e mësuam vetëm falë vizitës dhe një ndër komponentët më të rëndësishëm të këtij realiteti është rëndesa e sëmundjes, opsionet për shërim ose të paktën përmirësimi, dhe çmimi i tyre.

Shërbim shëndetësor i financiar nga shteti dhe detyrimet që rrjedhin nga vizita tek i sëmuri

Hadithet e përmendur më sipër nuk merren me diskutimin e financimit të shëndetit, por sëmundjen e shohim të rreshtuar me nevojat bazë të domosdoshme fiziologjike të njeriut që janë të ngrënë dhe të pirët. Nëse ndërpriten edhe jeta tokësore përfundon, dhe që të dyja nuk janë nevoja shpirtërore. Shëndeti rreshtohet me këto nevoja fiziologjike dhe kërkon të njëjtat zgjidhje si këto dy nevoja. Nga ana psikologjike mund të mendohet që vizita ia largon mendjen përkohësisht

13. Riad Us Salehiin; Hadithe nga Muhammedi A.S.; Imam En-Nevevij; Biblioteka Islamike “Co Kavaja Albania”; 1994; Hadithi 894.

nga sëmundja dhe e afron nga shpresa, por nuk mjafton.

Le të kthehemi në fillimin e diskutimit tonë ku morëm në konsideratë ajetin e Kur'anit që e përmend sëmundjen së bashku me luftën dhe skamjen. Duhet t'i ndihmojmë këtij njeriu që po lufton me sëmundjen e sidomos kur është skamnor. Dikush mund të jetë i gatshëm të ndihmojë, dikush do të dijë si të ndihmojë dhe dikush mund të pyesë pse duhet të ndihmojë përderisa shteti garanton shërbimin shëndetësor me apo pa pagesë.

Jo pa qëllim diskutimi është fokusuar në vizitën e të sëmurit. Disa konkluzione që mund të ishin krejt të ndryshme nëse e bëjmë ose jo këtë vizitë po i radhis më poshtë dhe në vazhdim kanë nevojë të shtohen, madje edhe të riorganizohen.

- Vizita mund të na tregojë se i sëmuri dhe familja e tij mund të jenë kategori zekati, që në mjaft raste ne nuk e dimë këtë fakt të rëndësishëm sepse duke qenë besimtar personi në fjalë nuk ankohet por duron.

- Ka mundësi që edhe nëse nuk përfiton zekat gjithmonë mbetet e hapur porta e sadakasë.

- Shikohet konkretisht lloji dhe rëndesa e sëmundjes, duke na mundësuar edhe përafrimin më të mirë me koston e mjekimit.

- Kuptohet në rastin e sëmundjeve ngjitëse se mjekimi i kësaj sëmundje nuk është vetëm në të mirën e pacientit, por edhe të komunitetit dhe rrjedhimisht edhe të familjes dhe vetë vizituesit.

- Njihemi konkretisht me shpenzimet që ky person përfiton

nga shteti për mjekimin e sëmundjes së tij dhe njëkohësisht kthehemi në konsumator dhe taksapagues më të ndërgjegjshëm, koncept ky ndër më modernët në menaxhimin shëndetësor.

Listën mund ta shtojë dhe riorganizojë më mirë secili prej nesh sipas eksperiencave personale dhe njohurive në këtë fushë.

Asgjë të re për të rekomanduar

Kështu që lexoni Kuran aq sa mundeni! Ai e di se disa prej jush do të jenë të sëmurë, disa do të udhëtojnë nëpër botë, duke kërkuar mirësitë e Tij (për jetesë) dhe disa të tjerë do të jenë duke luftuar në rrugën e Tij, prandaj lexoni sa keni mundësi nga Kur'ani!¹⁴

Si gjithmonë Kur'ani mbetet i mahnitshëm. Brenda një fjalie të vetme përfshihen të gjithë myslimanët, disa kërkojnë të mirat, disa luftojnë në rrugën e Allahut (xh.sh.) dhe disa janë të sëmurë. Çdo shoqëri myslimane do të dëshironte të kishte sa më shumë pjesëtarë të saj në dy kategoritë e para dhe sa më pak në shtrat. Problemi i shëndetit dhe financimit të shëndetit shihet që nuk është një problem vetëm personal, apo vetëm i familjes së të sëmurit, apo vetëm i atij që e viziton të sëmurin, apo vetëm i të gjithë shoqërisë, por është të gjitha këto së bashku të shikuara me syrin e besimit që kemi pranuar. Vizita e të sëmurit hap portat e njohjes së problemit, tregon madhësinë e tij dhe vendos para detyrimit ose zgjedhjes për të ofruar zgjidhjen më të mirë.

...edhe nëse artikulli nuk ka impakt, së paku të vizitojmë një të sëmurë.

14. Kur'ani, Muzemil, 20.

Referenca:

- [1] Kur'ani, Bekare, 177.
- [2] <http://www.kuranifisnik.net/KuraniFisnik/Ballina>; 22 Korrik 2013.
- [3] Development and Institutionalization of National Health Accounts (NHA), Albania; Tirana, Augsburg, July 27, 2010; REPUBLIC OF ALBANIA, MINISTRY OF HEALTH.
- [4] Burimi: OECD Health Data 2011 (Nov. 2011).
- [5] David A. Squires; Explaining High Health Care Spending in the United States: An International Comparison; Issues in International Health Policy; May 2012.
- [6] http://gamapserver.who.int/mapLibrary/Files/Maps/TotPercentGDP_2011.png, <http://gamapserver.who.int/mapLibrary/app/searchResults.aspx>; 22 Korrik 2013.
- [7] Data Source: Global Health Observatory, WHO Map Production. Public Health Information and Geographic Information Systems (GIS) World Health Organization ©WHO 2012.
- [8] Financing health care in the European Union; Challenges and policy responses; Sarah Thomson, Thomas Foubister, Elias Mossialos; © World Health Organization 2009, on behalf of the European Observatory on Health Systems and Policies; ISBN 978 92 890 4165 2.
- [9] Kutzin 2001; Mossialos & Dixon 2002.
- [10] The Islamic Declaration (Islamska deklaracija) Alija Izetbegović. Published in 1969–70, and republished in 1990 in Sarajevo.
- [11] The Book of Visiting the Sick; <http://sunnah.com/riyadussaliheen/7>; This is book 7 of Riyad as-Salihin, containing 61 hadith; 22 Korrik 2013.
- [12] Riad Us Salehiin; Hadithe nga Muhammedi A.S.; Imam En-Nevevij; Biblioteka Islamike “Co Kavaja Albania”; 1994; Hadithi 893.
- [13] Riad Us Salehiin; Hadithe nga Muhammedi A.S.; Imam En-Nevevij; Biblioteka Islamike “Co Kavaja Albania”; 1994; Hadithi 894.
- [14] Kur'ani, Muzemil, 20.

GJUHA SHQIPE DHE SHTETTFORMIMI NË VEPRAT E DIJETARËVE ISLAM

Doc. Dr. Ismet Osmani
Universiteti “Shën Çirili dhe Metodi”, Shkup

Abstrakt

Kontributi i dijetarëve islam për gjuhën shqipe dhe shtetformimin përbëjnë një fushë studimi me interes, që kanë tërhequr vëmendjen dhe janë bërë objekt kërkimesh e hulumtimesh nga shumë studiues gjatë viteve. Një përpjekje e tillë e dijetarëve islam shënon fillimin e një reforme të madhe në ngritjen e kulturës kombëtare dhe përhapjen e kulturës islame në gjuhën amtare. Përveç kësaj, dijetarët islam, në planin politik gjithnjë punojnë në mbarëvajtjen e kombit e të atdheut.

Historia shkruhet sipas logjikës së fakteve dhe mbetet një libër i hapur për të gjitha kohërat. Pikërisht kjo, pra historia, respekti dhe mirënjohja që vendet e qytetëruara ju kanë dhënë ndër shekuj njerëzve të shquar të kombit në kulturë art dhe shkencë, nëpërmjet të cilëve kanë krijuar edhe identitetin e tyre, ka bërë që gjithmonë të mbeten në pedestal.

Kështu, dijetarët islam, apo siç i quajmë ndryshe me fjalorin oriental ulematë janë dëshmuar si krijues dhe ithtarë të denjë të lëvizjes mendore e iluministe dhe veprimtarë të denjë të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare.

Veprimtaria e pasur e shumë dijetarëve islam, e gërshetuar me

motivin patriotik dhe fetar ka bërë që të vlerësohet lart munda dhe sakrificat e tyre për një shtet të fuqishëm dhe kompakt. Ide kjo e ngritur dhe e ngulitur në vetëdijen kombëtare e fetare nga rilindësit tanë. Një bashkëveprim i tillë bëhej vetëm nga ata të cilët kishin ndërtuar bindjen se ne shqiptarët mund të qëndrojmë të fortë në tri vertikale¹ - që kishin të përbashkët vetëdijen kombëtare shqiptare.

Dijetarët islam jetuan në një epokë krizash, lëvizjesh e përmbysjesh të mëdha, në një epokë ballafaqimesh të ashpra politike, ekonomike e ideologjike. Të gjitha këto i përjetuan në mënyrën e vet, duke mbetur kurdoherë në pozitativ e një krijuesi të denjë, por edhe të një

1. M. Hysa, Alamiada shqiptare I, Shkup, f. 10.

pjesëmarrësi të drejtpërdrejtë në betejat e luftës. Afërsia e tyre me qytetërimin evropian, por edhe me atë të lindjes ju mundësoi atyre të pasurohen intelektualisht dhe të përfitojnë nga këto dy kultura duke u bërë edhe pjesë e tyre.

Veprimet e tilla të sunduesve të huaj bënë që nga gjiri i popullit të dalin mendimtarë, historianë, gjuhëtarë e artistë, veprat e të cilëve do të lënë gjurmë në zhvillimin e ndërtimin e shtetit.

Veprimtaria kombëtare e shkencore e dijetarëve islam

Kufizimi i së drejtës elementare, përdorimit të gjuhës amtare shqipe bëri që të gjithë së bashku myslimanë, katolikë e ortodoksë shqiptarë të ndjehen keq për një privim të tillë, gjë që përforcoi edhe më shumë unitetin e tyre kombëtar shqiptar me moton se atdheu duhet çliruar. Të shkruarit në gjuhën shqipe përfaqësonte një simbol të qëndresës ndaj të gjithë atyre që përbuznin gjuhën shqipe.

Të gjitha lëvizjet kombëtare bartin me vete emra të shquar të kombit, krijues të fjalës së shkruar, të cilët sot e kësaj dite gjenden në pedestal. Kështu mund të themi se sot si krijues janë të njohur Mulla Hysen Dobraci dhe Mulla Salî Pata, të cilët një mbledhës i shquar i folklorit shqiptar Zef Jubani, njërin, Mulla Hysen Dobracin, do ta quajë edhe si “Anakreonti i Shqipërisë”, ndërsa Mulla Salî Patën do ta quajë patriot me vetëdije të qartë kombëtare. Të tillë dijetarë – teologë janë të shumtë, ndër ta është edhe Sheh Jonuzi (1848 – 1909) një hoxhë i shquar, i shkolluar në Stamboll, i cili tërë veprimtarinë e

vet do t’ia kushtojë gjuhës dhe shkollës shqipe, për çka do të nxirret edhe para gjyqit në Shkup. Ndërkaq, Dervish Salihu në poezinë e tij “*Bismil-labi nokte e nisa*” mbështet kërkesat dhe aspiratat e lidhjes. Baba Meleqi, ku temë kryesore në poezinë e tij është kushtrimi për atdhenë. Ai përmes vargjeve fton popullin të rrëmbejnë armët kundër sunduesve “*Rrëmbeni pushkën dhe pallë!*” Në këtë periudhë të Lëvizjes Kombëtare, me pikëpamje fetare e kombëtare vepruan edhe Rexhep Voka e Said Najdeni, veprimtarë të shquar të Lëvizjes Kombëtare. Janë këta dy emra që përcaktojnë qartë jo vetëm vetëdijen kombëtare, por edhe atë fetare duke himnizuar se jemi vëllezër të krishterë e myslimanë, ashtu si toskë e gegë, të cilët do të japin një kontribut të çmueshëm në kultivimin e dijes në gjuhën kombëtare shqipe. Kështu, kontributi i çmuar që do të jap Rexhep Voka për shtetin shqiptar, duket qartë edhe në ngritjen e dijes, me ç’rast vë në spikamë nevojën e shkrim-leximit shqip. Ai më 1910 do të hartojë një abetare shqipe me shkronja arabe, por të përshtatur me fonetikën shqipe, të cilën e titulloi “Abbeja skip”. Një vit më vonë, më 1911, R. Voka boton “Gramatikën elementare shqipe”, si edhe një tekst mësimor fetar “Ilmihali i hollësishëm shqip”, në të cilin shpjegohen rregullat e besimit islam. Ndërkaq, Said Najdeni, i cili i frymëzuar nga Lëvizja Kombëtare Shqiptare dhe takimi me atdhetarë të shquar bëri që më 1888 të hapë shkollën shqipe në Dibër. Veprat kryesore që S. Najdeni botoi me alfabetin latin janë dy. E para është “Fe rrëfenjësja e myslimanëve”, botuar në Sofje më 1900, dhe e dyta

“Abetare e gjuhës shqipe ndë të folë gegënisht”, botuar po në Sofje më 1900, në mënyrë anonime. Veprimtaria kombëtare e fetare e dijetarëve islam lë gjurmë të pashlyeshme në të gjitha porët e jetës kombëtare e fetare shqiptare. Për një veprimtari të tillë u shqua edhe Haxhi Vehbi Dibra, delegat i Kuvendit historik të Vlorës të udhëhequr nga Ismail Qemali, një komentator i shquar i Kur’anit në gjuhën shqipe.

Një kontribut të tillë të madh për kombin, shtetin dhe gjuhën e dëshmojnë shumë atdhetarë të shquar, “Çobu prej gjumit more vlla”, “Mos e le udhën, o insan”, “Fjalim shqip a than”, thoshte Vesel Xh. Guta, mejtepi i të cilit gjatë viteve 1941-1945 u bë shkollë kombëtare-fetare, ku në mënyrë ilegale përveç lëndëve fetare, zhvilloheshin edhe lëndë të tjera si: matematika, astronomia, gjeografia dhe historia.

Publicistika

Shoqëritë shqiptare të themeluara nga rilindësit tanë në shumë vende të botës ndihmuan në mbajtjen gjallë të vetëdijes kombëtare shqiptare, kështu shoqëria “Drita” e themeluar nga Mulla Rexhepi kishte në programin e saj gjuhën shqipe, ruajtjen dhe mbledhjen e pasurisë gojore shqiptare. Mulla Rexhepi në derset (mësimet) e tij të zjarrta luftonte haptas shpërnguljen e shqiptarëve në Turqi, strategji kjo e ndërtuar dhe e zbatuar me vite nga sllavët. Po kështu veproi edhe Ferit Vokopola, i cili më 28 Nëntor 1912 firmosi dokumentin e Shpalljes së Pavarësisë si delegat i Vlorës. F. Vokopola njihet edhe si themelues i organizatës fetare “Drita Hyjnore”, që

pati si organ të vetin revistën “Njeriu”, e cila doli rregullisht nga korriku 1942 deri në qershor 1944.

Ndërsa ai, i cili do t’i dhurojë lexuesit shqiptar Kur’anin e përkthyer në gjuhën shqipe është edhe veprimtari dhe përkthyesi i njohur Hasan Efendi Nahi. Me një veprimtari të tillë të përkthimit dhe publicistikës shquhet edhe Haki Sarofi, nxënës i Normales së Elbasanit dhe ndër themeluesit e revistës “Zani i Naltë”, të cilën edhe do ta udhëheqë gjatë viteve 1930-1939.

Për iman e vatan

Shumëkush praninë e tri besimeve e shihte si shkas për një konflikt me përmasa të mëdha, gjë që nuk ndodhi asnjëherë, por të gjitha këto përbënin një faktor që luajti rol në zhvillimin kulturor të vendit. Të gjithë këta, pa dallim feje ishin vetëdija më e zgjuar e kombit, të prirë nga qëndrimi kritik ndaj dukurive dhe fenomeneve shoqërore e politike, nuk pajtoheshin me realitetin e hidhur dhe i kundërviheshin atij me tërë forcën e fjalën artistike, duke kërkuar raporte të reja, më të shëndosha, më të pranueshme. Kështu, Petro Nini Luarasi, ndër mësuesit e parë të shqipes do të jepte urdhër që në shtëpinë e tij të mos gatuhet mish derri, se vijnë vëllezërit mysliman. Ai do të shkojë edhe më larg duke e pagëzuar të birin me emrin Skënder. Përveç kësaj, Hafëz Ibrahim Efendiu i emocionuar nga fjalimi i At Gjergj Fishtës, me vrap kishte vajtur drejt tribunës, përzemërsisht e me lot në sy kishte përqaftuar at Gjergj Fishtën. Po kështu, Gjergj Fishta, duke e parë rrezikun nga fqinjët, te kryevepra e tij “Lahuta e Malcis” u drejtohet shqiptarëve:

“Por, pse na të vogjël jemi
Pse fis e vlla nuk kemi
Na sod shkjaout s’mund t’i bajmë
ballë

Qi po do t’na përpijë gjallë,
Prandej, thom se e lyp e mara
Qi dhe sot na, si përpara,
Të rrim njit me mbret t’Stambollit
Për me i bamun ballë Nikollit...”

Poeti i madh i kombit, prifti i lartë i Kishës Katolike, Gjergj Fishta, vetë e shikonte Mbretin, Sulltanin, Turqinë, Stambollin, në atë periudhë të vështirë për shqiptarët dhe trojet e tyre, si shpëtimtar dhe si një faktor i bashkimit kombëtar, përballë fqinjëve serbo-malazezë. Uniteti kombëtar, pa dallim feje është kushtrim edhe i Haxhi Vehbi Dibrës, i cili në bashkimin e të gjithë shqiptarëve shihte të vetmen rrugë për të siguruar të ardhmen tonë. Ai do të

thoshte në Kuvendin Kombëtar të Vlorës më 28 nëntor 1912 se “Kristiani e myslimani janë vëllezër shqiptarë të pandarë”. “Armikut të atdheut i pritët hovi e guximi në qoftë se na shef të bashkuar e të lidhur për një qëllim të naltë”.

Rezyme

Të gjitha lëvizjet kombëtare bartin me vete emra të shquar të kombit, krijues të fjalës së shkruar, të cilët sot e kësaj dite gjenden në pedestal. Kështu, një inteligjencë e pajisur me kulturë orientale, përkatësisht me orientim fetar islam jo vetëm që ndihmuan në ndërtimin dhe konsolidimin e shtetit, por ndihmuan edhe në ngritjen kulturore të popullit me hapjen e shkollave, botimin e revistave e kështu me radhë.

Literatura:

1. Myderrizi, Osman, Fjalori shqip turqisht i H. Ali Ulqinakut, Studime filologjike 4, Tiranë 1965.
2. Myderrizi, Osman, Tekstet e vjetra shqip me alfabet arab, Konferenca e parë e studimeve albanologjike, Tiranë 1965, f. 287.
3. Myderrizi, Osman, Letërsia shqipe me alfabet arab, Buletini për shkencat shoqërore 2, Tiranë 1955.
4. Historia e letërsisë shqiptare, Tiranë, 1983.
5. Pirraku, Muhamet, Gjurmë të veprimtarisë letrare shqipe me alfabet arab në Kosovë, Dituria 1-2, Prishtinë, 1978.
6. Zamputi, I., Një dorëshkrim bektashian i gjysmës së shekullit XIX (1850-1860), Buletin për shkencat shoqërore nr. 4, Tiranë, f. 64-131.

Institucionet fetare gjatë mbretërimit të Ahmet Zogut: Një vështrim të legjislacionit të kohës (1928-1939)

Prof. Dr. Valentina Duka
Universiteti i Tiranës

Abstrakt

Arritja më e prekshme e Zogut mbret, që ne historianët shqiptarë nuk guxuam t'ia vëmë në dukje asnjëherë gjatë sundimit komunist, ishte sigurimi i stabilitetit politik në vend. Ai ishte aq i mençur sa ta kuptonte që për ndërtimin e shtetit të tij, nuk mjaftonte thjesht të kopjonte modele shtetesh që mund të qenë aplikuar tjetër kund pa marrë në konsideratë realitetin politik në vend. Zogu krijoi eventualisht një sistem politik duke kombinuar idetë lindore me ato perëndimore sepse ky tip shteti i siguroi atij centralizmin e nevojshëm për të qeverisur elitën e vështirë politike shqiptare.

Arritja më e prekshme e Zogut mbret, që ne historianët shqiptarë nuk guxuam t'ia vëmë në dukje asnjëherë gjatë sundimit komunist, ishte sigurimi i stabilitetit politik në vend. Ai ishte aq i mençur sa ta kuptonte që për ndërtimin e shtetit të tij, nuk mjaftonte thjesht të kopjonte modele shtetesh që mund të qenë aplikuar tjetër kund pa marrë në konsideratë realitetin politik në vend. Zogu krijoi eventualisht një sistem politik duke kombinuar idetë lindore me ato perëndimore sepse ky tip shteti i siguroi atij centralizmin e nevojshëm për të qeverisur elitën e vështirë politike shqiptare. Një kontribut i madh i Zogut ishte edhe krijimi i një mjedisi që çoi në forcimin e ndërgjegjes kombëtare shqiptare. Pra, ashtu siç shprehet me të drejtë publicisti dhe diplomati i shquar

shqiptar Eqrem bej Vlora, Zogu nuk krijoi vetëm shtet por edhe komb. Kësaj filozofie i shërbyen edhe marrëdhëniet që ai ndërtoi institucionalisht me komunitetet fetare në Shqipëri¹.

Pothuajse gjashtë muaj pas shpalljes së monarkisë, më 16 korrik 1929 (botuar në gazetën zyrtare më 1 shkurt 1930)², Mbreti Zog, dekretoi ligjin mbi administrimin e bashkësive fetare. Por çfarë përfaqësonte ky ligj i cili u debatua aq shumë në kohën e vet?

Në radhë të parë, sipas tij, komunitetet fetare në Shqipëri ishin persona morale, që gëzonin të gjitha të drejtat përveç asaj për të marrë pjesë në veprimtari politike në mënyrë të drejtpërdrejtë, apo të tërthortë.

1. Bernd Fischer.

2. *Fletorja zyrtare*, 1 shkurt 1930, nr. 8.



Mbreti Zog me krerët e komuniteteve fetare

Komunitetet fetare, gjithashtu, quheshin të formuara dhe gëzonin të drejtat e akorduara prej ligjit, vetëm kur Statuti i paraqitur prej tyre, aprovohej prej Këshillit të Ministrave dhe dekretohej nga Mbreti.

Çdo kryetar sakti fetar zgjidhej në bazë të rregullores së vet edhe emërohej prej Kryetarit të komunitetit respektiv, përveç Kryetarëve të sekteve me rëndësi që duhet t'i paraqiteshin Qeverisë nëpërmjet Kryesisë së Komunitetit, për dekretim nga ana e mbretit.³

Sipas nenit tetë të ligjit, Kryetarët e komuniteteve fetare, ... *ndihmësat e zëvendësit e tyre, duhet të jenë shtetas dhe prej fisi e prej gjuhës Shqiptare, të dinë të shkruajnë dhe të flasin lirisht gjuhën zyrtare të jenë në një moshë të paktën mbi 25 vjet dhe të mos kenë kryer vepra antikombëtare. Kryetarët e çdo komuniteti, mbasi të zgjidheshin në bazë të Statutit të tyre, emëroheshin me Dekret Mbretinuer⁴.*

Komunitetet fetare ishin të lidhura, me Ministrinë e Drejtësisë dhe, të gjitha

marrëdhëniet e tyre me Qeverinë, kryheshin me anën e saj, e cila kishte të drejtë edhe t'i inspektonte ato.

Po sipas ligjit, Mbreti, mund të ndryshonte drejtuesit e komuniteteve fetare sa herë që ai konstatonte se ata ishin duke shkelur ligjin. Bashkësitë fetare nuk duhej të merrnin asnjë ndihmë e subvencion nga jashtë. Shpenzimet e tyre për qëllime humanitare, duhej të miratoheshin nga qeveria⁵.

Pra, siç mund të konstatohet, ky ligj, i vendoste bashkësitë fetare dhe klerikët e lartë pothuajse nën kontrollin e shtetit, prandaj dhe ngjalli mjaft pakënaqësi kundër qeverisë. Ligji disiplinues i mësipërm u kundërshtua më shumë nga drejtuesit e bashkësive të krishtera, por edhe me drejtuesit e komunitetit mysliman, Zogu pati probleme sporadike.

Megjithatë me dekretimin e tij bashkësitë fetare në përgjithësi morën të gjitha masat për t'iu përshtatur situatës së re. Bashkësia myslimane, që ishte më e madhja në numër, rreth 70

3. Po aty.

4. Fletorja zyrtare, 1 shkurt 1939, nr. 8.

5. Po aty.

% sipas numërimit të 1930-ës, më 8 gusht të vitit 1929, organizoi Kongresin e Sunitëve shqiptarë, i cili mori disa masa radikale në raport me organizimin e këtij komuniteti në zbatim të ligjit të bashkësive fetare.

Para së gjithash, Kongresi ripohoi shkëputjen e bashkësisë islame shqiptare nga Kalifati, dhe vendosi t`u jepej fund marrëdhënieve të varësisë me Sheik ul-Islamin. Gjithashtu kongresi vendosi përdorimin ekskluziv të gjuhës shqipe për lutjet dhe predikimin, unifikimin e medreseve dhe seminareve si dhe mbylljen e shumicës së xhamive të vogla me infrastrukturë të papërshtatshme duke mbajtur dy ose tri syresh kryesore në çdo qytet⁶.

*Sipas Statutit të Komunitetit Myslyman Shqiptar, të aprovuar në këtë kongres, Komuniteti Myslyman, përbahet prej myslimanëve Shqiptarë të çdo sektit që ata të ishin.*⁷ Gjuha zyrtare e Komunitetit duhet të ishte vetëm shqipja.⁸ Kryetari i Komunitetit Myslyman zgjidhej me vota të fshehta prej Këshillit të Përgjithshëm. Ky i fundit duhej të dekretohet nga Mbreti si dhe të betohej para Mbretit.⁹

Në rast se Kryetari i zgjedhur nuk pëlqehet prej Mbretit, Këshilli i Përgjithshëm, ishte i detyruar të zgjidhte një tjetër person i cili gjithashtu duhej t`i nënshtrohej formalitetit të mësipërm. Sipas nenit 11 të Statutit, Kryetari i Komunitetit Myslyman para se të fillonte detyrën betohej para Mbretit me këtë tekst betimi:

6. *Histori e popullit shqiptar.*

7. "Statuti i Komunitetit Myslyman Shqiptar", *Fletorja Zyrtare*, nr. 53, 24 shtator 1929, neni 1, 1.

8. *Po aty*, neni 4, 1.

9. *Po aty*, neni 9, 1.

*"Betohej n'emën të Perëndisë e ap besen shqiptare se, do të jem kurdoherë besnik i Mbretit të Shqiptarve, i Atdheut dhe i Statutit të Shtetit dhe, detyrohem të betoj në këtë mënyrë të gjith funksionarët që varen prej mejet."*¹⁰

Mbas kryerjes së këtij formaliteti Kryetari i Bashkësisë Myslimane do të betohej para Këshillit të Përgjithshëm sipas kësaj formule:

*"Betohej n'emën të Perëndisë se, do të mbajë besnikërinë kundrejt urdhnave fetare dhe, do të respektoj plotësisht Statutin dhe rregulloret e Komunitetit me një ndërgjegje të pastër e Kombtare."*¹¹

Myftinjtë dhe Nënmyftinjtë zgjidheshin nga Këshilli i Përhershëm dhe dekretoheshin prej Kryetarit të Komunitetit Myslyman.

Shumë interesante është ajo pjesë e statutit e cila përcaktonte të ardhurat e Komunitetit të cilat përbëheshin nga: të ardhurat nga vakëfet, ndihmat e ndryshme të shtetit si dhe ndihmat nga besimtarët. Gjithashtu ç'do shtëpi myslimane duhej të paguante një taksë fakultative në arkën e Komunitetit Myslyman. Për ato shtëpi që nuk paguanin taksën, Kryemyftiu, Myftiu, ose Nënmyftiu kishte të drejtë të ndalonte pjesëmarrjen në ceremonitë fetare. Sipas statutit nuk mund të pranoheshin dhurata ose subvencione nga shtete të huaja, vetëm me pëlqimin e qeverisë.

Sipas nenit 64 të statutit, *në rast inspektimi nga shteti, zyrrat e komunitetit mysliman detyrohen të tregonin gjithë llogaritë e tyre financiare. Në rast se konstatohet ndonji abuzim financiar, veprohej si mbas dispozitave të Kodit Penal.*¹²

10. *Po aty*, neni 11, 1-2.

11. *Po aty*.

12. *Po aty*, neni 64, 5.

Në çdo të premte sipas statutit, duhet të bëheshin lutje për shtetin, Mbretin, Kombin dhe ushtrinë.¹³

Edhe në rregulloren e Bektashinjve shqiptarë, e aprovuar më 26 shkurt 1930, në përshtatje me ligjin për komunitetet fetare, përcaktoheshin të njëjtat dispozita për funksionimin e kryegjyshit dhe teqeve si edhe për institucionet e tjera të Komunitetit Mysliman..

E gjithë filozofia e funksionimit të këtij komuniteti përcaktohej në nenin 33 të Rregullores së Brendshme të tij. Në të thuhej: *“gjihtë traditat e Shejta Bektashiane që nuk janë në kundërshtim me ligjet e Shtetit, përmbledhen prej Krye-Gjyshit, bisedohen nga të dy Këshillat, (Këshilli i Shejtë Gjyshënor dhe Mikstë) të mbledhur së bashku nën kryesinë e Krye-Gjyshit, dhe pasi aprovohet marrin emrin “Rregullore e mbrendëshme”. Gjithë Kleri Bektashian detyrohet të konformohet me dispozitat e saj”*.¹⁴

Një tjetër reformë ligjore e mbretërisë që preku funksionimin civil të Komunitetit Mysliman Shqiptar ashtu siç preku edhe komunitetet e tjera fetare ishte aprovimi i Kodit Civil Shqiptar më 1 prill 1929. Më parë marrëdhëniet familjare rregulloheshin për familjet myslimane nga Gjyqi i Naltë i Sheriatit, ndërsa tani gjithçka si martesat, trashëgimia, barazia midis burrit dhe gruas përcaktohej sipas kodit të ri civil, i cili u ndërtua sipas modelit francez, italian dhe zviceran.

Në raport me Bashkësinë Islame Shqiptare, në historinë e mbretërimit të Zogut, është edhe dekretimi prej tij i ligjit të heqjes së perçeve të femrave. Ky ligj u parapri nga organizimi i mbledhjes

së jashtëzakonshme të Këshillit të Përgjithshëm të Komunitetit Mysliman, më 1 mars 1937, i cili në mënyrë unanime mbështeti heqjen e perçes së grave, një iniciativë personale kjo e Zogut. Pas këtij vendimi, parlamenti aprovoi ligjin për heqjen e perçes, ligj i cili më 10 mars 1937 u dekretua nga Zogu. Sipas këtij ligji, femrat shqiptare ndaloheshin të mbulonin pjesërisht ose tërësisht fytyrën, në rast të kundërt dënoheshin me gjoba të rënda nga 20-1000 franga ari. Në rast të përsëritjes së fajit ligji parashikonte edhe dënime penale me burgim ose internim. Gjithashtu sipas këtij ligji, nëpunësit, si të shtetit ashtu dhe të bashkive dhe të komunave, detyroheshin të mos përdornin tjetër mbulesë në kokë veç se kapella; kontravajtësit ndëshkoheshin me gjobë të randë deri në 100 fr. ari. Në rast përsëritjeje, ndëshkimit të sipërm i shtoheshin edhe ndalimi nga organet zyrtare për një kohë nga një deri në tre vjet.¹⁵

Më 30 prill të 1937, u dekretua edhe ligji mbi caktimin e mbulesës së kokës së meshkujve. Sipas këtij ligji, mbulesa e kokës së meshkujve shqiptarë caktohej si vijon:

a) *Ata që vishen kompletisht me petka civile, detyrohen me mbajtje shapke me strebë;*

b) *Ata që vishen kompletisht me petka kombtare, detyrohen me mbajtje kësulë të bardhë të punuëm në vend;*

c) *Ata që vishen pjesërisht me petka kombtare e pjesërisht me petka civile janë të lirë me përdorë mbulesat e përmenduna në paragrafët e shënuëm me gërmën a) dhe b).*

*Kontravajtësit edhe në këtë rast ndëshkoheshin sipas këtij ligji me gjobë të lehtë nga pesë deri në njëqind fr. ari.*¹⁶

13. Po aty, neni 69, 5.

14. Fletorja Zyrtare, 26 gusht 1930, nr. 5.

15. Po aty.

16. Fletorja Zyrtare, 30 prill 1937, nr. 32.

Komuniteti Mysliman si dhe komunitetet e tjera fetare iu nënshtruan edhe dispozitave të ligjit mbi ndalimin e nxënësve shqiptarë të frekuentonin shkollat fetare private. Sali Vuçiterni, një intelektual aktiv i arsimit fetar, më 1927 hartoi një platformë reformuese për arsimin fetar islam. Thelbi i saj konsistonte në suprimimin e shkollave të dobëta të medreseve dhe krijimin vetëm të dy internanteve: një në Tiranë dhe një në Shkodër. Kjo reformë e mbështetur fuqishëm edhe nga Zogu pati kritika sidomos nga kleri mysliman i Shkodrës. Por polemika mbaroi me mbështetjen e reformës Vuçiterni.¹⁷ Shkollat fetare të drejtuara nga kleri mysliman iu nënshtruan edhe reformës më të madhe arsimore të ndërmarrë nga Nikolla Ivanaj me anë të së cilës u mbyllën të gjitha shkollat private në Shqipëri. Kjo reformë që në thelb u bë për të fuqizuar karakterin nacional të arsimit e dëmtoi së tepërmi arsimin shqiptar.

Sipas njoftimeve të diplomatëve të huaj në Tiranë, dekret ligjet e mësipërme ishin aprovuar nën presionin e vetë Zogut. Kronikanët e kohës kanë vënë re se, ndryshe nga çfarë ndodhi me komunitetet kristiane, zbatimi i reformës fetare pati vetëm disa kundërshtime sporadike nga ana e klerit mysliman, sidomos atij të Shkodrës dhe pjesërisht atyre të Korçës dhe Gjirokastrës. Kjo lidhet ndoshta me faktin se ky komunitet në këto vite nuk kishte ndonjë mbështetje të fuqishme nga ndonjë shtet i huaj siç kishin ortodoksët Greqinë dhe katolikët Vatikanin¹⁸. Por

17. Fletorja Zyrtare, 23 shtator 1932, nr. 70.

18. Jason Tomes, *King Zog Self-made monarch of Albania*, Sparkford: Sutton Publishing, 2003, f. 151.

ky qëndrim i klerit mysliman mund të lidhej edhe me vetë bindjen e tij për domosdoshmërinë e reformimit të Bashkësisë Islame Shqiptare.

Podiumi kryesor i kulturës islame ishte revista periodike “Zani i Naltë”¹⁹, revistë kjo e përmuajshme. Përveç botimeve të literaturës fetare, ajo ishte një tribunë e rëndësishme e mendimit intelektual filozofik islam. Personalitete të shquara jo vetëm fetare por edhe intelektuale si Hafiz Ali Korça, Haki Sharofi, Ismet Dibra etj, me shkrimet e tyre jo vetëm që rritën nivelin e revistës, por gjithashtu shprehnin vlerësime dhe mbështetje në forcimin e shtetit shqiptar. Një numër special u botua me rastin e 25-vjetorit të shpalljes së pavarësisë më 1937, ku i bëhej homazh kryesisht klerikëve myslimanë të cilët kishin dhënë kontribut në çështjen kombëtare shqiptare.

Mbreti Zog, gjatë viteve të monarkisë, pati kontradikta të ashpra me drejtuesit e komuniteteve kristiane. Administrata e tij hyri në debate me kishën greke, me Patrikanën e Stambollit, si dhe me disa klerikë ortodoksë që ishin nën ndikimin e tyre, të cilët ngurrnin të pranonin afirmimin e autoqefalisë së kishës ortodokse shqiptare. Pas riardhjes në fuqi, A. Zogu në vitin 1925, e mori në dorë vetë këtë çështje dhe veprroi me energji për zgjidhjen e saj. Që nga koha e presidencës, pra në vitin 1926, u zhvilluan bisedime ndërmjet përfaqësuesve të qeverisë së Zogut, nga njëra anë, dhe atyre të Patrikanës së Stambollit e të Athinës,

19. Revista “Zani i Naltë” është themeluar në vitin 1923 menjëherë pas themelimit të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë dhe ka vazhduar botimin deri në vitin 1939.

në anën tjetër. Në këto bisedime pala shqiptare këmbëngulte që të njihej autoqefalia e plotë e kishës ortodokse shqiptare. Në fillim, për arsye taktike, Zogu i bëri disa lëshime kishës greke në caktimin e klerikëve të institucioneve shqiptare nga radhët e atyre klerikëve që kishin studiuar në Greqi, në mbajtjen e liturgjisë e të meshës në gjuhën greke etj.²⁰

Megjithatë në Kongresin Ortodoks të Korçës, të vitit 1929, kisha ortodokse shqiptare miratoi statutin e saj. Sipas këtij statuti, kisha shqiptare ishte person juridik dhe trashëgonte të gjitha të drejtat e komuniteteve ortodokse.²¹

*Sinodhi i Shenjtë detyrohej që çdo vepër e paraqitur me anë botimesh, gravurash, faqjesh teatrale, ose kinematografike dhe konferencash publike të mos cënonte, çnderonte dogmat dispozitat e Ortodoksisë. Kryepeshkopi zgjidhej prej Sinodhit për gjithë jetën e tij. Në rast se Kryepeshkopi i zgjedhur prej Sinodhit nuk pëlqehet prej Mbretit, Sinodhi, detyrohej të zgjidhte një tjetër të cilin duhet t'ia paraqeste Mbretit për pëlqim dhe dekretim. Në këtë mënyrë zgjidheshin edhe peshkopët e tjerë. Kryepeshkopi, Peshkopët, zëvendësit e tyre lokalë, Sekretari i Përgjithshëm i Sinodhit etj., duhet të ishin prej gjaku, gjube si dhe të kishin nënshpëtim shqiptarë. Liturgjia duhet të zhvillohej në gjuhën shqipe dhe Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë detyrohej që në çdo meshë të bënte lutje për Mbretin, për gjithë Kombën Shqiptarë dhe për ushtrinë.*²²

Sipas nenit 55, *Kisha Autoqefale e Shqipërisë, në asnjë mënyrë nuk mund të pranojë dhurata nga shtete të huaja dhe*

sipas nenit 57, *asnjë klerik nuk mund të funksiononte në fenë ortodokse në Shqipëri pa qenë i emëruar dhe i lidhur me Kishën Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë.*²³

Sigurisht ky statut e zemëroi si Stambollin dhe Athinën. Qeveria greke e ashpërsoi shumë qëndrimin kundër qeverisë shqiptare, sidomos pas reformës Ivanaj e cila konsistonte ndër të tjera edhe në mbylljen e shkollave private greke, si të gjitha shkollat e tjera private. Greqia e hodhi qeverinë shqiptare në gjyqin ndërkombëtar të Hagës, të cilën dhe e fitoi. Por ajo që e zemëroi më shumë Mbretin e qeverinë e tij ishte ngritja e përherëshme, nga ana e palës greke të çështjes së Vorio – Epirit (të Shqipërisë së Jugut), të cilën Mbreti e konsideronte krejt absurde në atë kohë.

Si rezultat i presionit por dhe i bisedimeve të qeverisë së Zogut me Patrikanën e Stambollit, kjo e fundit e njohu më në fund, në vitin 1937, Kishën Ortodokse Shqiptare si Autoqefale.²⁴

Vështirësi më të mëdha u hasën në marrëdhëniet e Zogut me bashkësinë katolike. Kjo bashkësi ishte më e vogla në numër. Sipas statistikave të vitit 1937, ajo përbënte vetëm 10% të popullsisë. Katolikët ishin të përqendruar kryesisht në veri, në qarkun e Shkodrës. Ata kishin dhënë një kontribut të çmuar në Rilindjen Kombëtare shqiptare si dhe në përpjekjet e shqiptarëve për pavarësi.²⁵

Zogu, mbret, nuk i pati të mira raportet me klerin katolik. Ai bëri disa

23. Po aty, neni 55, 6.

24. Kastriot Dervishi, *Historia e shtetit shqiptar 1912-2005*, Tiranë : Shtëpia botuese 55, viti 2006, f. 376.

25. Edvin Jacques, “*Shqiptarët. Historia e popullit shqiptar nga lashtësia deri në ditët e sotme*”, Tiranë, Kartë e Pendë, 1995, f. 437.

20. *Historia e popullit shqiptar*, Botim i Akademisë së Shkencave, Tiranë: Toena, 2007, f. 301.

21. “Statuti i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë”, *Fletorja Zyrtare*, nr. 45, 14 gusht 1949, 1.

22. *Po aty*, neni 54, 6.

gjeste afrimi, siç ishin vizitat e tij në Shkodër më 1927 apo herë pas here edhe takime me klerikët e lartë katolikë në Tiranë.²⁶ Por Zogu ishte i vendosur të afirmonte autoritetin shtetëror përkundërt atij fetar. Kjo u duk edhe në marrëveshjen që ai lidhi me Vatikanin në fund të vitit 1927, në bazë të së cilës i njihet liri veprimi kishës katolike, por në pozitën vetëm të personit juridik.²⁷

Një konflikt i madh filloi midis institucioneve katolike dhe Mbretit sidomos pas aprovimit të ligjit të komuniteteve fetare të 1929-ës si dhe ligjit për mbylljen e shkollave të huaja dhe shtetëzimin e tyre, ndër to edhe shkollat katolike. Kisha katolike reagoi fort gjithashtu ndaj Kodit të ri Civil që ia hiqte “familjen” juridiksionit fetar.²⁸

Letërsia historiografike shqiptare dhe e huaj përmend veçanërisht qëndrimin ekstrem të peshkopit të Shkodrës, Lazer Mjeda, i cili nga katedra e kishës së tij shkoi larg kur shpalli

“shkishërimin e shtetit shqiptar dhe gjithë atyre që do t`u bindeshin ligjeve të tij”. Qeveria urdhëroi arrestimin e tij, por askush nuk guxoi të hynte në dioqezën e tij për ta arrestuar. Ligji mbeti, por në institucionet katolike të krahinës së Shkodrës ai nuk gjeti zbatim. Si rrjedhim një atmosferë e tensionuar juridike mbretëroi në marrëdhëniet midis shtetit dhe kishës katolike deri në largimin e Zogut në prill 1939. Kisha latine injoronte zyrtarisht ligjin për bashkësitë fetare, kështu që Shteti e quante atë si një organizatë ilegale, pa personalitet juridik dhe pa të drejtën që të ndihmohej nga qeveria nga pikëpamja ekonomike. Si kundër ankoheshin ipeshkvijtë shqiptarë në një promemorie të drejtuar më 1935 Lidhjes së Kombeve, ligji për komunitetet fetare ishte “një shpatë e Demokleut e varur mbi kokën e katolikëve shqiptarë”, gati për përdorim në rast se do të dëshirohej “plohtësisht disiploina katolike”²⁹.

26. Roberto Maroco della Roka, “*Kombi dhe feja në Shqipëri 1920-1944*”, Tiranë, Elena Gjika, f. 133.

27. *Po aty*.

28. *Historia e popullit Shqiptar, vep. e përmendur*, f. 302.

29. Roberto Maroco della Roka, *vep. e përmendur*, f. 136.

Mbi rishkrimin dhe rishikimin e historisë së Shqipërisë

Nuredin Nazarko

Abstrakt

Risjellja në vëmendje të shqiptarëve për një interpretim dhe vlerësim ndryshe të historisë së Shqipërisë, dubet të realizohet mbi bashkëpunimin e ngushtë të rishkrimit dhe rishikimit jo vetëm për periudha të caktuara historike, por një rishikim për rishkrim të të gjithë strukturës së zhvillimeve historike deri në detaje, larg influencës së interpretimit materialist dialektik dhe i nënshtuar përfundimisht me ndershmëri ndaj së vërtetës dhe qëllimit për të hulumtuar, deri në gjetjen e saj, apo dhe të pranimit të mosarritjes së saj, në qoftë se nuk mundet të arrijë deri tek ajo. Ky proces nuk dubet të shërbejë si instrument fshirës dhe groposës i shtrembërimeve, deformimeve qëllimore të interpretimit njëdimensional, përndryshe do të groposte të vërtetën e mashtimit, që përjetuam dhe përjetojmë, përmes papreksshmërisë së ekskluzivitetit të frymës ideologjike njëdimensionale në hartimin dhe publikimin e historisë së standardizuar...

Një nga çështjet, padyshim më të shumëpërfolura në shumësinë e çështjeve të shumëpërfolura dhe shumëdebatuara, të historisë së Shqipërisë është rishkrimi e rishikimi i vetë historisë së Shqipërisë. Ndryshimet demokratike të fundviteve '80 që prekën edhe atmosferën e zhvillimeve shqiptare, mundësuan ushtrimin e një prej të drejtave themelore, mohuar këmbëngultësisht nga regjimi monist, ushtrimin e fjalës dhe shprehjes së lirë. Në spektrin e ndryshimeve që përjetonte dhe përjeton shoqëria shqiptare, ndihet dhe do të ndihet nevoja për të risjellë në vëmendjen e

kujtesës së shqiptarëve të shkuarën e tyre, jo thjesht si narracion i mërzitshëm ngjarjesh, datash, emrash, personazhesh, por edhe si interpretim e vlerësim, nisur nga një këndvështrim ndryshe i interpretimit dhe vlerësimit të ngjarjeve, pasi historia nuk është vetëm narracion faktologjik. Nevoja për një interpretim dhe vlerësim ndryshe të historisë së Shqipërisë është thelbësore, esenciale, e domosdoshme, jo për të anatemuar dhe rrëzuar punën e historianëve të parandryshimeve demokratike, por për të qartësuar zhvillimet historike në të gjitha dimensionet e tyre.

Historia, si e mësojmë

Historia ka dy komponentë të rëndësishëm njëjtë sikurse vëllezërit siamezë, faktin dhe interpretimin mbi këtë fakt. Përshkrimi i fakteve për të njohur ngjarjet, zhvillimin e tyre, është i rëndësishëm. Misioni i historianit nuk përfundon këtu, ndryshe historiani do të fshihej pas fakteve. Pjesa më e rëndësishme e punës së tij është interpretimi mbi faktet, për të kuptuar se si lidhen faktet me njëri – tjetrin dhe përse ngjarjet historike kanë ndodhur ashtu sikurse kanë ndodhur dhe jo ndryshe. Interpretimi është hapësira ku mosrespektimi i nënshtrimit me ndershmëri ndaj së vërtetës, shkakëson përdorimin e historisë, duke i dhënë epitetin e justifikueses ndaj kujtdo. Montaigne do të deklaronte: “Qysh se gjykimi është i njëanshëm, është e pamundur që tregimin të mos e vërtitësh nga ajo anë.”¹ Duke u bazuar mbi interpretimin e njëanshëm, marksist-leninist, të historisë së Shqipërisë u sendërtua deformimi, shtrembërimi dhe qëllimi për të interpretuar çdo fakt historik, përputhshmërisht me interpretimin marksist të historisë. Ideologjizimi i historisë përmes materializmit dialektik është boshiti qendror i mozaikut historik shqiptar, gurët e të cilit dhe në mos qofshin duhet t’u jepet e njëjta ngjyrë. Përshkrimi dhe interpretimi i historisë

1. M. Bloch, Apologji e historisë, fq. 148.

* Në këtë trajtesë si referencë ka shërbyer teksti i historisë së Shqipërisë për shkollat e mesme që zhvillohej me 3 orë mësimore javore botuar nga shtëpia botuese “Pegi”, i cili ishte i vetmi tekst historie në përdorim, deri në aplikimin e alterteksit dhe reduktimit me 2 orë në javë sipas kurrikulës së re të gjimnazit.

së Shqipërisë ndjek epokat e bashkësisë primitive, skllavopronarisë, feudalizmit, feudo-kapitalizmit, diktaturës së proletariatit, socializmit si parapërgatitje për ndërtimin e komunizmit. Në themel të ndryshimeve nga një rend në tjetrin, qëndron ndryshimi i marrëdhënieve në prodhim, si rezultat i pashmangshëm i konfliktit dhe kontradiktave të pashmangshme, të vazhdueshme deri në triumfin e shoqërisë pa klasa, midis të pasurve dhe të varfërve, të ngërthyer përjetësisht në interesa antagoniste. Duhet të theksojmë se në këtë trajtesë kemi sjellë në vëmendje disa dromca historike, për të shënjuar rolin e ideologjizmit dhe frymës ideologjike në historishkruarjen e historisë së Shqipërisë.

Për historinë botërore në përgjithësi dhe materializmin dialektik në veçanti, njeriu përmes punës u shkëput përfundimisht nga bota e kafshëve dhe nga skllav i natyrës u kthye në zotërues i saj. Në tekstin e historisë së Shqipërisë për shkollat e mesme* lexojmë: “Njeriu nga skllav i natyrës, siç ishte në paleolit u shndërrua pak nga pak në zotërues i saj.”² Pyetja që shtrohet natyrshëm në këtë rast është se a ishte vërtet njeriu fëmijë i natyrës apo në rrugëtimin e tij i duhet të bashkëjetojë me të, duke qenë se nuk mund të veprojë ndryshe?

Në çdo epokë historike të Shqipërisë, në të gjitha ngjarjet e përshkruara, forca qendrore e rezistencës dhe pakompromisit, mbështetëse e aspiratave liridashëse dhe denoncuese e çdo pushtimi dhe pushtuesi shfaqet fshatarësia. Fshatarësia kishte mbajtur

2. Histori 4, tekst mësimor për shkollat e mesme, fq. 4.

peshën e rezistencës ndaj të pasurve, por edhe ndaj pushtuesve. “Lufta zhvillohej ndërmjet qyteteve e feudalëve që kërkonin t’i vinin nën sundim, ndërmjet fisnikëve dhe popullorëve, ndërmjet vegjëlisë e pronarëve të mëdhenj.”³ Për periudhën romake të sundimit lexojmë: “Roma ndoqi ndaj ilirëve politikën e shfrytëzimit të egër ekonomik dhe të asimilimit etnik. Me qindra e mijëra fshatarë u shpronësuan dhe u kthyen në skllëvër.”⁴ Për fillesat e periudhës së sundimit osman lexojmë: “Fshatarësia shqiptare i bëri qëndresë pushtimit osman. Me të u bashkuan edhe bujarët shqiptarë që kishin humbur qeverisjen.”⁵ “Skënderbeu kishte me vete fshatarësinë, kurse bujarët kishin mbi kokë osmanët.”⁶ Edhe pas vendosjes së plotë të sundimit osman, edhe pas shpalljes së pavarësisë, edhe gjatë qeverisjes së A. Zogut, edhe gjatë LANÇ, fshatarësia luan një rol qendror në rezistencën ndaj atyre që kërkojnë dominimin mbi të. Këto përshkrime, ngrenë përfytyrime antielitare, pasi roli i elitave anashkalohet, në të shumtën e herëve paraqiten si mbështetës të pushtuesve të huaj, tradhtarë të kombit edhe atëherë kur nocioni komb ende nuk ishte conceptualizuar, mbrojtës të konservatorizmit, ruajtës të mendësive të vjetruara, bastione të feudalizmit dhe mbeturinave të tij. Rrjedhimisht bazuar mbi këto përfytyrime dhe ndjesi, roli i elitave mbetet destruktiv, roli i fshatarësisë në kuptimin e proletariatit, themelor, bazik, progresist për zhvillimin dhe përparimin e kombit shqiptar.

3. Po aty, fq. 35.

4. Po aty, fq. 19.

5. Po aty, fq. 55.

6. Po aty, fq. 64.

Do të ndalemi paksa mbi figurën e Heroit Kombëtar, Gjergj Kastriot Skënderbeut, jo për të trajtuar debatet mbi figurën e tij, edhe pse ky debat nis pikërisht si rezultat i deformimit, shtrembërimit, instrumentalizimit përmes ideologjizimit. Figura e Skënderbeut është përshkruar sipas përfytyrimeve dhe ndjesive për dikë tjetër dhe jo thjesht për Skënderbeun. Teksa lexojmë përshkrimin e figurës së Skënderbeut, zbulojmë tërësisht cilësitë që i janë veshur një protagonistit tjetër të historisë së Shqipërisë. Le të lexojmë me vëmendje përshkrimin e mëposhtëm për të kuptuar qartë se kujt në të vërtetë i atribuohen të tilla cilësi. “Figura e Skënderbeut paraqet një rast kur populli gjen tek udhëheqësi aspiratat dhe vetitë e tij më të mira. Ai ishte një nga ata që kuptoi më mirë se kushdo detyrën që shtronte koha, nevojën e bashkimit politik si kusht kryesor për mbrojtjen e interesave të vendit. Me një vlerësim real, ai u mbështet te fshatarësia e lirë dhe bujarët e vegjël, për të kundërbalancuar lëvizjet separatiste të bujarëve të veçantë shqiptarë. Lufta e popullit shqiptar nën udhëheqjen e Skënderbeut u ngrit në një shkallë më të lartë e më të organizuar. Për këtë arsye Skënderbeu u bë simbol i luftës së tij. Skënderbeu ishte burrë shteti. Me mjeshtëri kaloi nga aleanca politike në një shtet të përqendruar. Kështu ai u bë themelues i shtetit të pavarur shqiptar. Kujdes i kushtoi Skënderbeu mbrojtjes së burimeve të brendshme ekonomike. Me brezin lindor të mbrojtjes ai i jepte mundësi vendit të zhvillonte një jetë ekonomike pak a shumë të rregullt. Skënderbeu ishte një diplomat i

kalibrit ndërkombëtar. Ai u përpoq të përfshinte në luftë shtetet evropiane përkrah shqiptarëve. Skënderbeu nuk binte më poshtë në fushën ushtarake, ku u tregua një strateg dhe komandant me aftësi të shquara. Në të njëjtën kohë, ai hartonte planin e luftës, udhëhiqte ushtrinë, duke luftuar vetë me krahë të shpërvjelur, si një ushtar i thjeshtë.”⁷ “Krijimi i shtetit të pavarur ishte vepra e dytë e madhe historike e Skënderbeut pas çlirimit të vendit.”⁸ (Kujtoni rolin e E. Hoxhës në Luftën e Dytë Botërore, sipas historisë zyrtare). Të tilla përshkrime padyshim që burojnë nga fryma e ideologjisë totalitare marksiste-leniniste, ku ngrihet në kult figura e udhëheqësit. Këto përshkrime më shumë se sa për Skënderbeun shkojnë për figurën e diktatorit, ashtu sikurse gjendet i përshkruar në historiografinë e paraviteve ’90 në tekstet zyrtare, apo në botime të veçanta për figurën e tij, figurë tek e cila ishin shkrirë në një simbiozë të paparë ndonjëherë më parë tek ndonjë figurë historike e popullit shqiptar, cilësitë më të vyera dhe më të arrira njerëzore. Madje theksojmë se edhe në ato raste kur është përmendur emri i diktatorit, asnjëherë nuk është cilësuar si diktator. Paralelizmat dhe ngjashmëritë në cilësi qofshin fizike, organizative, ushtarake, mendore etj., mes këtyre dy figurave edhe pse të largët në kohë nuk mendojmë të jenë një ngjashmëri aksidentale, por qëllimisht janë përafuar të dyja figurat, për të na treguar që E. Hoxha dhe Skënderbeu janë dy figurat e mëdha historike të kombit shqiptar, madje ky i fundit

7. Po aty, fq. 77 – 78.

8. Po aty, fq. 64.

çuditërisht më i ngjashëm me të parin, edhe pse kishte jetuar shekuj përpara diktatorit.

Le të kthehemi paksa tek pasazhi ku Skënderbeut i atribuohen dy vepra të mëdha, së pari çlirimi i vendit dhe më pas krijimi i shtetit të pavarur. Pyetjet që shtrojmë janë se cilin vend, komb çliroi Skënderbeu kur ende nuk ishte krijuar vetëdija për identitetin kombëtar? Çfarë shteti të pavarur krijoi Skënderbeu, kur që nga 1451-1458, pranoi vasalitetin prej Alfonsit V të Napolit, dhe një hapësirë mjaft e konsiderueshme e hapësirave shqiptare ishte nën sundimin osman dhe atë serb?

Edhe betejat luftarake, si për nga angazhimi i forcave pushtuese, po ashtu edhe nga rezistenca vendase kanë një ngjashmëri të theksuar. Në rrethimin e tretë të Krujës, 1467 “sulltani mbërriti në Shqipëri me të gjithë fuqinë ushtarake të perandorisë.”⁹ Edhe pse u sul me gjithë fuqinë ushtarake të perandorisë “në mbarim të verës sulltani u largua me ushtrinë e rraskapitur”¹⁰, ndërkohë që trupat e Skënderbeut “e përballuan luftën me forcat e veta.”¹¹ Për LANÇ lexojmë: “...angazhoi në luftë më shumë se 15 divizione italiane e gjermane dhe u shkaktoi armiqve rreth 70 mijë të vranë, të plagosur e robër si dhe humbje të rënda materiale.”¹² Po ashtu kjo luftë dhe çlirimi i vendit erdhi me forcat tona. “Ajo (*Shqipëria, N.N.*) është dhe ndër vendet e pakta që u çliruan me luftën e popullit të vet dhe të ushtrisë së tij çlirimtare, pa qenë nevoja që ushtritë e vendeve aleate të

9. Po aty, fq. 70.

10. Po aty, fq. 70.

11. Po aty, fq. 70.

12. Po aty, fq. 291.



kryenin veprime luftarake në territorin e saj.”¹³ Ngjashmëritë shfaqen akoma dhe më rrëqethëse tek përshkrimi se çfarë shkaktoi vdekja e Skënderbeut dhe sesi u prit ajo. “Vdekja e Skënderbeut shkaktoi një tronditje të thellë. Populli e vajtoi atë me gjëmë rrëqethëse.” Me atë që dimë deri më sot vdekja e askujt tjetër në historinë e Shqipërisë nuk ka shkakuar tronditje të thellë dhe vajtime me gjëmë rrëqethëse të popullit, përveç vdekjes së diktatorit, E. Hoxha. Kjo na përforcon bindjen se në përshkrimin e figurës së Skënderbeut shpërfaqet tërësisht diktatori E. Hoxha dhe për rrjedhojë nënkuptohet qartë se cili ishte dhe është *de facto* heroi kombëtar, nëpër librat e historisë së standardizuar dhe të ideologjizuar.

Periudha e sundimit osman vazhdon të përshkruhet me ngjyime ku dominon pothuajse plotësisht gjithmonë e zeza. Kjo periudhë e gjatë sundimi osman, ku padyshim shqiptarët dhe gjithë popujt e perandorisë lanë gjurmët e tyre në qeverisjen e saj, është veshur me faj për çdo të keqe, që ka përjetuar kombi shqiptar gjatë sundimit të saj dhe pas shpalljes së pavarësisë, e madje deri më sot. Ja se si përshkruhen rrjedhokat e luftimeve antiosmane të udhëhequra nga Skënderbeu: “Lufta i dha fund jetës së

pavarur politike e shtetërore dhe dëmtoi shumë kulturën. U zhdukën shumë nga veprat më të bukura të arkitekturës si kështjella, katedrale, kisha, manastire, vepra të piktorëve, dokumente e dorëshkrime, kronikat e familjeve më të mëdha. Një pjesë shumë e vogël i shpëtoi rrënimt.”¹⁴ Të tilla rrjedhoja nuk mund të vinin vetëm se prej një popullsie, “të egër”, “barbare”, “injorante”, “të pagdhundur” e “të pakulturuar”, cilësi që nënkuptohen përmes pezhorativitetit të emërtimeve, aziatik, anadollak, turkoshak, anadollizëm. Ja se si përshkruhet impakti i këtij sundimi, pas shpalljes së pavarësisë: “Pas pushtimit të gjatë shekullor turk, Shqipëria ishte zhytur në prapambetje të thellë. Shumica e popullsisë banonte në fshat. Fusha të tëra kishin mbetur toka moçalore dhe rendimentet e prodhimit bujqësor e blegtoral ishin mjaft të ulëta. Në vend mbizotëronin mbeturinat feudale. Shtypja çifligare e fshatarësisë ishte e madhe.”¹⁵ “Populli ushqehet keq dhe sëmundjet kronike bënin kërëdinë”¹⁶ “Pengesë për zhvillimin e vendit mbeteshin mbeturinat feudale. Ishte mbizotëruese forma e çifligjeve të shtetit dhe e pronave të mëdha

14. Po aty, fq. 73.

15. Po aty, fq. 182.

16. Po aty, fq. 182.

13. Po aty, fq. 291.

të tokave.”¹⁷ Fryma e urrejtjes ndaj pronarëve dhe pronës private shihet qartë. Ata janë cilësuar si pengesë për zhvillimin e vendit dhe fajtorë për prapambetjen e tij. Errësimi i çdo periudhe të mëparshme, para vendosjes së regjimit komunist në Shqipëri, synon të na krijojë bindjen se krenaria, dinjiteti dhe themelet e këtij vendi hodhën rrënjë dhe u konsoliduan vetëm përmes këtij regjimi, edhe pse janë shprehur kritika të zbehta në tekst për periudhën e këtij regjimi. Në të gjitha përshkrimet fryma ideologjike është qendrore, duke shprehur qartë urrejtjen, anatemin për çdo ide tjetër, për çdo formë tjetër qeverisjeje, të cilësuar gjithmonë si shfrytëzuese dhe gjakpirëse të popullit, i cili “shpëtoi” njëherë e mirë me marrjen e pushtetit nga PKSH.

LANÇ është vlerësuar jashtëzakonisht pozitivisht, si e vetmja lëvizje që energjitë i shfrytëzoi për të mirën e popullit dhe gjatë gjithë luftës nuk mendoi për asgjë tjetër vetëm se për të mirën e tij, gjë e cila u shpërfaq qartë gjatë viteve të regjimit monist. Ja se si e gjejmë të përshkruar LANÇ: “Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare ishte një luftë çlirimtare, një revolucion popullor, që u organizua e u drejtua nga Fronti Nacionalçlirimtar, ku PKSH kishte një peshë të konsiderueshme dhe u udhëhoq nga ideologjia kombëtare, nga idetë e çlirimit kombëtar. Ajo kishte si qëllim dëbimin e pushtuesve të huaj, çlirimin e atdheut, rivendosjen e pavarësisë kombëtare dhe ndërtimin e Shqipërisë së re demokratike.”¹⁸ Me aq sa njohim nga praktika e PKSH si

gjatë luftës, ashtu edhe pas saj, nuk na rezulton aspak, që ajo të jetë udhëhequr nga ideologjia kombëtare dhe ndërtimi i Shqipërisë demokratike. Në rast se do të ishte kështu siç është përmendur, përse u hodh poshtë marrëveshja e Mukjes, e fillimgushtit 1943, që synonte eliminimin e divergjencave dhe bashkimin e shqiptarëve në lëvizjen antifashiste? Përse në Kongresin e Përmetit, 24-28 maj 1944 u deklarua se nuk njihet asnjë qeveri që do të formohej jashtë apo brenda Shqipërisë? Cila qeveri do të njihet? Pa dyshimin më të vogël e vetmja qeveri që do të njihet do të ishte ajo që do të formohej nga PKSH, e cila qëllim themelor nuk kishte pavarësinë e vendit, apo ideologjinë kombëtare, por pushtetin politik, si diktaturë e proletarietit, të pandarë me asnjë forcë tjetër politike, pasi që të gjitha forcat e tjera u damkosën si tradhtarë të kombit. Duke vazhduar linjën e mashtrimit, pasi mashtrimi pjell mashtrimin, ja se si përshkruhet puna e Asamblesë Kushtetuese e dalë nga zgjedhjet e 2 dhjetorit 1945, që të na krijojë përshtypjen se PKSH na paskërka ngjitur shkallaren e pushtetit me rrugë demokratike, përmes konkurrencës politike: “Asamblesë iu paraqitën dy lista, njëra e propozuar nga deputetë komunistë; kurse e dyta e paraqitur nga deputetët opozitarë. Me këtë të fundit synohej që të evitohej në rrugë demokratike përqendrimi i të gjithë pushteteve në duart e Partisë Komuniste. Listat u votuan në mënyrë të fshehtë dhe me shumicë dërrmuese votash fitoi lista e parë.”¹⁹ Kush e njeh qoftë dhe sadopak praktikën e PKSH-

17. Po aty, fq. 210.

18. Po aty, fq. 291.

19. Po aty, fq. 305.

së, e di shumë mirë sesa demokratike kanë qenë këto zgjedhje dhe aq më tepër ngjitja në pushtet.

Periodha e regjimit komunist edhe pse e kritikuar për momente të caktuara, është kritikuar butë. Madje në përgjithësi është cilësuar periudhë, që janë shënuar dhe arritje në fusha të caktuara. “U botuan tekste për studime universitare, si vëllimi i parë i “Historisë së Shqipërisë” dhe vëllimi i parë e i dytë i “Historisë së letërsisë shqipe”. Pavarësisht nga metodologjia e përdorur, këto vepra ishin përpjekja e parë për të dhënë një paraqitje të historisë politike, ekonomike e kulturore të vendit.”²⁰ “Me gjithë trysinë që ushtrohej mbi krijuesit, në këto vite u krijuan një numër veprash me përmbajtje e nivel artistik. Të tilla ishin: “Komisari Memo” e Dritëro Agollit, “Kështjella” e Ismail Kadaresë, “Përsëri në këmbë” e Dhimitër Xhuvanit, poemat “Shqiponjat fluturojnë lart” e I. Kadaresë dhe “Baballarët” e D. Agollit etj.”²¹ Të perifrash të tilla zhvillime si pozitive, megjithëse ishin të deformuara qysh në origjinën e tyre pasi i nënshtroheshin kallpeve ideologjike para se të shihnin dritën e botimit, dhe të justifikosh mashtrimin me një “pavarësisht”, apo “megjithëse” dhe të mos lëshohesh në analizë të thellë se çfarë dëmi kolosal ka sjellë ky ideologjizim i jetës në tërësi, tregon qartë që doktrinarët ideologjikë nuk lëshojnë pe përballë diversioneve, siç parapëlqejnë t’i emërtojnë veprimet deviatore, dhe janë të vendosur ta çojnë deri në fund misionin e tyre si militantë të devotshëm revolucionarë.

20. Po aty, fq. 323.

21. Po aty, fq. 334.

Ndryshimet demokratike në Shqipëri nuk janë paraqitur me të gjitha tonalitetet e zhvillimeve, madje pranimi i disa të vërtetave jo vetëm këtu, por edhe për periudha të mëparshme, apo të mëvonshme është bërë thjesht për t’u paraqitur tashmë si historishkrues kritikë dhe mendjehapur. Këto ngjarje mjaft të rëndësishme për Shqipërinë dhe të ardhmen e saj nuk mund të kalohen rrëshqanthe, pa u ndalur pak më gjerësisht mbi dinamikën e zhvillimeve të atyre viteve. E njëjta procedurë shkurtse ndiqet edhe për zhvillimet e viteve ’92-’97, ku për asnjë moment nuk janë përmendur vështirësitë e panumërta dhe gjendjen katastrofike që trashëguam nga e kaluara e regjimit monist, ndërkohë që vështirësitë dhe prapambetjen, që na vinte nga regjimi osman, apo ai i paraluftës së dytë botërore nuk lihej rast pa i përmendur. Me shkurtesat e trajtesave të tematikave të rëndësishme, ku faktet nuk duhet të kenë tashmë fatin e atyre të paraviteve ’90, synohet që të lihen në harresë pasojat e pandreqshme që trashëguam nga regjimi stalinist, duke ia faturuar përgjegjësinë e problematikave deviatorëve. Përshkrimi dhe interpretimi i ngjarjeve përfundon në vitin 2000, duke krijuar zbrazëtirë njohjeje të zhvillimeve në Shqipëri pas këtij viti.

Edhe zhvillimet në trevat shqiptare jashtë kufijve politikë të imponuar të Shqipërisë, nuk i kanë shpëtuar ngjyimeve ideologjike dhe mashtrimit. Këto ngjyime dhe mashtrime evidentohen qartësisht, sidomos gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe gjithëzhvillimet e pas saj. Një moment tejet i rëndësishëm është kalimi i

partizanëve shqiptarë jashtë kufirit politik në shtator 1944, në ndjekje të nazistëve gjermanë për të çliruar Kosovën. Ja se si e kemi të përshkruar në tekst: "...pas luftimesh të përgjakshme të zhvilluara për më se dy muaj arritën të çlironin Kosovën dhe vise të tjera nga pushtuesit nazifashistë... Luftime të ashpra kundër armikut, partizanët shqiptarë zhvilluan sidomos në Vishegrad në shkurtin e vitit 1945. Në fund të këtij viti, forcat e Ushtrisë Nacionalçlirimtare të Shqipërisë u kthyen në atdhe."²² Ja se çfarë ndodhte në të njëjtën kohë në Kosovë, ndaj popullsisë shqiptare, që e gjejmë të përshkruar po në tekst: "Fushata e terrorit dhe e gjenocidit ndaj shqiptarëve filloi ende pa mbaruar Lufta e Dytë Botërore, nga shtatori i vitit 1944, dhe u intensifikua gjatë muajve nëntor-dhjetor 1944. Në të njëjtat përmasa ajo vijoi edhe më pas."²³ "Sipas të dhënave në këtë periudhë (1944-1945, N.N) në Kosovë u vranë dhe u masakruan rreth 40.000 shqiptarë. Ndërkohë mijëra vullnetarë shqiptarë të mobilizuar me forcë në brigadat jugosllave, u vranë me urdhër të Shtabit Jugosllav. Disa mijëra u pushkatuan gjatë rrugës Prizren-Tivar, kurse 1.200 veta që kishin mbetur nga ky kontigjent, u vranë në Tivar."²⁴ Çështja që nuk është sqaruar, madje as që është përmendur, është roli i PKSHE dhe i udhëheqjes së saj në këto ngjarje. Me plot të drejtë pyesim: - Përse trupat shqiptare u angazhuan në luftimet në Kosovë, për të çliruar Kosovën nga gjermanët apo për t'ua dorëzuar jugosllavëve? Përse në të njëjtën kohë që

trupat shqiptare zhvillonin luftime për çlirimin e Kosovës filluan dhe masakrat mbi popullsinë shqiptare? A nuk ishte në dijeni PKSHE dhe udhëheqësit e saj për masakrat që po ndodhnin, kur trupat shqiptare u kthyen në Shqipëri në fund të 1945? Këto pyetje apo dhe shumë e shumë të tjera kërkojnë përgjigjen e historikuesve që ngrenë tymnaja, me përshkrime politike dhe selektive, për të na bindur që vërtet u luftua për çlirimin e Kosovës nga pushtuesit gjermanë. Atje vërtet u luftua për të larguar një pushtues, por ky "çlirim" nga pushtuesit, rivendosi pushtuesit jugosllavë së bashku me terrorin dhe barbarizmat e tyre mbi shqiptarët e gënjer, nga vëllezërit e tyre. Nuk e dimë se si mund të përmendet me mburrje çlirimi kur nga ana tjetër masakrohen më dhjetëra mijëra? Kjo tregon edhe njëherë qartë që nuk mund të kritikoheshin vëllezërit ideologjikë, edhe tanimë që na është dhënë mundësia për të thënë të vërtetat e ngjarjeve sikurse kanë ndodhur dhe jo sikurse i përfytyronin të ideologjizuarit se si ndodhnin.

Përse duhet rishikuar dhe rishikuar historia e Shqipërisë

Nëse do t'i qëndronim ngultësisht, rishkrimit apo rishikimit, në mëvetësinë e secilit, nuk do të kishim për të dhënë panoramën e plotë dhe të qartë mbi atë se si do të duhej të ishte prezantuar historia e Shqipërisë.

Rishkrimi si i tillë do të sillte riformulimin e interpretimit të fakteve, apo përfshirjes së fakteve të papërfshira, duke zbutur ashpërsinë dhe dogmatizmin e interpretimit njëdimensional të historisë së

22. Po aty, fq. 291.

23. Po aty, fq. 298.

24. Po aty, fq. 299.

Shqipërisë, duke na krijuar përshtypjen dhe më pas bindjen se rishkrimi do të ndryshonte, do të spastronte dhe zgjidhte problematikën e debatit mbi historinë e Shqipërisë, me aq sa është e mundur të zgjidhet. Ajo çka në të vërtetë na shqetëson nuk është thjesht rishkrimi derisa ta kemi realizuar, por çmontimi dhe zhbërja e ekskluzivitetit të frymës ideologjike mbi rishkrimin e historisë, pasi duke na dhënë përshtypjen se duke e rishkruar historinë zgjidh problemin, kamuflohet, mimikrizohet dhe vazhdon të jetojë si e tillë. Rrjedhimisht do të jetë gjithmonë e më e vështirë për t'u kuptuar kamufliimi dhe mimikrizimi, nga brezat që gjithmonë e më tepër i largohen viteve të regjimit njëpartiak, dhe nuk e njohin perfiditetin e kamufliimit të interpretimit njëdimensional të historisë së Shqipërisë.

Rishikimi si i tillë do të ravijëzohej mbi tehun e kritikës, për ngjarje të caktuara, personazhe të caktuara, me mendimin se po realizon gjetjen e gabimeve, të metave, për t'i ndryshuar larg interpretimit të njëanshëm dhe dogmatik. Rishikimi për pjesë të caktuara edhe pse mund t'i pastrojë përmes syrit të kritikës, do të përjashtonte pjesë të tjera për të cilat do të mendohej se rishkrimi është më se i mjaftueshëm. Kështu që edhe në këtë rast fryma ideologjizuese do të gjente të çarat e nevojshme për të penetruar tek procesi i rishikimit, duke ruajtur të paprekur vetveten dhe duke vazhduar misionin e indoktrinimit ideologjik të përshtatur në kushtet e reja të zhvillimeve pasmoniste.

Risjellja në vëmendje të shqiptarëve për një interpretim dhe vlerësim ndryshe të historisë së Shqipërisë duhet

të realizohet mbi bashkëpunimin e ngushtë të rishkrimit dhe rishikimit jo vetëm për periudha të caktuara historike, por një rishikim për rishkrim të të gjithë strukturës së zhvillimeve historike deri në detaje, larg influencës së interpretimit materialist dialektik dhe i nënshtruar përfundimisht me ndershmëri ndaj së vërtetës dhe qëllimit për të hulumtuar deri në gjetjen e saj, apo dhe të pranimit të mosarritjes së saj në qoftë se nuk mundet të arrijë deri tek ajo. Ky proces nuk duhet të shërbejë si instrument fshirës dhe groposës i shtrembërimeve, deformimeve qëllimore të interpretimit njëdimensional, përndryshe do të groposte të vërtetën e mashtrimit që përjetuam dhe përjetojmë, përmes paprekshmërisë së ekskluzivitetit të frymës ideologjike njëdimensionale në hartimin dhe publikimin e historisë së standardizuar, standardizim që reflektohet qartësisht dhe kthjelltësisht edhe në tekstin e historisë së Shqipërisë për arsimin parauniversitar sot e gjithë ditën. Ky proces padyshim që nuk është një sipërmarrje lehtësisht e realizueshme, përkundrazi. Ky proces kërkon kurajë, vullnet, durim, këmbëngulje dhe mbi të gjitha nënshtrim ndaj së vërtetës me ndershmëri. Vështirësitë që shpërfaqen në këtë sipërmarrje nuk mund ta ndalojnë apo ta zhbëjnë interpretimin dhe vlerësimin ndryshe të historisë së Shqipërisë edhe pse mund ta vonojnë, sepse e vërteta nuk harron edhe pse mënon. Rishkrimi i historisë për brezat që kanë kaluar dhe do të vijnë vazhdon të jetë dhe do të tentohet të jetë monopol i atyre që e shkruan dhe vazhdojnë ta shkruajnë edhe sot e kësaj dite sipas ritmikës së të njëjtës frymë,

duke u ofruar me të njëjtat ngjyra, tonalitete e përfytyrime çdo brezi të ri shqiptarësh historinë e kombit të tyre. Jemi të vetëdijshëm se ideologjizimi përmes marksizëm-leninizmit, përdorte dhe përdor censurën si instrument të pamëshirshëm tehmprehtë për të përcaktuar se; cila ngjarje duhej përmendur e cila jo, cila figurë historike duhej përmendur e cila jo, cila figurë historike duhej anatemuar e cila jo, cilat shtresa duhej të vendoseshin në ballë të progresit e cilat në ballë të regresit, cilat burime historike ishin të vlefshme, si referenca e cilat jo, si duheshin vlerësuar sjelljet e personazheve historikë e si nuk duheshin vlerësuar, cilët kishin vepruar drejt, e cilët gabim, cilët kishin vepruar mirë e cilët keq, kush duhej kritikuar e kush nuk duhej kritikuar, kush duhej të kishte akses në burimet arkivore e kush jo, cilat burime arkivore duheshin hapur e cilat jo, cilat pjesë duhej të përktheheshin e cilat jo, cilat pjesë duhej të censuroheshin nga librat që botoheshin e cilat jo.

Ideologjizimi duke u shkrirë me politizimin prodhuan jo një histori gjithëpërfshirëse, të të gjitha zhvillimeve të fushave jetësore, por një histori tej mase të politizuar, ku hapësira për zhvillimet kulturore, zhvillimet e artit, pikturës, arkitekturës, tipare të jetës së përditshme jo vetëm që janë tmerrësisht të cinguar në raport me betejat, luftërat, antagonizmin e pandërprerë të klasave antagonistë, përplasjet politike,

dënimet politike, zhvillimet ekonomike, por edhe në atë pak hapësirë që zënë janë tepër të përgjithshme për periudha të gjata kohore dhe të shëmtuara nga tehu i censurës së ideologjizuar. Ideologjizmit, politizimit i bashkëngjitet edhe propaganda që vazhdon edhe sot e kësaj dite nga apologjetët e historisë së standardizuar dhe të ideologjizuar, që synojnë ta mbajnë gjallë përmes rreshtave që rreshtojnë vazhdueshmëritë për brezat e rinj të shqiptarëve. Përmes kësaj trojke, ngërthimit të ideologjizimit – politizimit – propagandës dhe instrumenteve në shërbim të saj, synohej indoktrinimi ideologjik i masave, jo vetëm i atyre që jetuan nën regjimin komunist, por fatkeqësisht edhe i atyre që vazhdojnë ta mësojnë historinë e kombit të tyre sipas ngjyrymeve dhe përfytyrimeve të regjimit monist, indoktrinim prej të cilit është mbytur dhe vazhdon të mbytet mendimi i lirë, kritik, bazuar në metodologjinë e nënshtrimit ndaj së vërtetës, kur provohet të preket ekskluziviteti i historishkruesve për tekstin arsimor të shkollave të mesme në arsimin parauniversitar. Arsyeja e këtij revanshizmi dhe anatemimi për të ruajtur të paprekur këtë tekst, është jo vetëm indoktrinimi ideologjik i tyre, por edhe nevoja për ta ruajtur vazhdimësinë e këtij indoktrinimi sa më shumë të jetë e mundur dhe për ta reflektuar çdo çast në jetën e këtij kombi.

Hafëz Ibrahim Dalliu dhe kontributi i tij në fushën e jurisprudencës islame (Me vështrim të veçantë në veprën: “LIBRI I SË FALMES”)

H. Resul Rexhepi - Bashkësia Islame e Kosovës

Abstrakt

Të shkruash për hafëz Ibrahim ef. Dalliun dhe kontributin e tij në fushën e jurisprudencës islame dhe në fushat tjera shkencore, është një punë sa e privilegjuar po aq edhe komplekse dhe e vështirë. Kjo për faktin sepse hafëz Ibrahim Dalliu është një personalitet i shquar i kulturës sonë, që me veprimtarinë e gjerë e të gjithanshme i solli shërbime të mëdha ngritjes së kulturës dhe mendimit shkencor shqiptar. Kjo i siguroi atij përgjithmonë vendin e merituar në historinë e kulturës sonë.

Të shkruash për hafëz Ibrahim ef. Dalliun dhe kontributin e tij në fushën e jurisprudencës islame dhe në fushat tjera shkencore, është një punë sa e privilegjuar po aq edhe komplekse dhe e vështirë. Kjo për faktin sepse hafëz Ibrahim Dalliu është një personalitet i shquar i kulturës sonë, që me veprimtarinë e gjerë e të gjithanshme i solli shërbime të mëdha ngritjes së kulturës dhe mendimit shkencor shqiptar. Kjo i siguroi atij përgjithmonë vendin e merituar në historinë e kulturës sonë.

Po të vështrohen me kujdes, veprat që na ka lënë trashëgim hafëz Dalliu, e

të cilat nuk mund të vlerësohen më pak se monumente të kulturës dhe shkencës shqiptare, atëherë s’është vështirë që të radhitet ndër dijetarët tonë më eminentë.

Pas po thuaj gjashtëdhjetë viteve nga vdekja e hafëz Ibrahim Dalliu, shtrohet një pyetje e ligjshme dhe logjike: nëse është shkruar gjithçka duhet për jetën dhe veprën e tij? Për këtë mund të përgjigjemi se, ndonëse deri në njëfarë mase për këtë figurë të njohur kanë shkruar studiues të njohur të shkencës shqiptare, megjithatë, këtij alimi (dijetari) e patrioti të madh vështirë se mund t’i dilet hakut. Për të gjithmonë

do të ketë diçka të re të thuhet e të shkruhet.

Shkaqet e mungesës për mosnjohjen e thelluar të veprës madhore të këtij alimi janë të natyrës ideologjike, po edhe njëanshmëria e qasjes së veprës së hafëz Ibrahim Dalliu.

Studiuesit tanë, kur bëjnë fjalë për veprën e hafëz Dalliu, sikur kanë synimin të “hyjnë” sa më parë në veprimtarinë patriotike të tij, duke anashkaluar atë fetare, thua se kjo e fundit nuk do të thotë patriotizëm!!!

Prandaj, duke u nisur nga ky fakt, qëllimi ynë në këtë shkrim kryesisht konsiston në:

Figurat e mëdha fetare e kombëtare të kalibrit të hafëz Dalliu, janë hulumtuar nga studiuesit tanë kryesisht nga këndvështrime të tjera, por jo edhe nga këndi dhe kontributi i tyre në fushën e islamistikës, natyrisht me ndonjë përjashtim.

Përmes këtij kontributi modest dëshiroj t'i nxis studiuesit e tjerë kompetentë që të merren me studimin e veprave nga kjo fushë, d.m.th. nga fusha e islamistikës, e rrjedhimisht edhe nga fusha e jurisprudencës islame, kurse studentët e fakulteteve islame gjithandej, kujtoj, do të mund të ishin ata që më së shumti mund të kontribuonin në këtë drejtim, qoftë përmes punimeve të diplomës, qoftë edhe përmes studimeve dhe hulumtimeve të tjera.

Kontributi i hafëz I. Dalliu në përgjithësi, e në fushën e islamistikës në veçanti është aq i konsiderueshëm, sa që i detyrohem të merremi me shqyrtimin e tyre, sepse ato ngelin të jenë prore aktuale edhe gati pas më shumë se një shekulli të daljes së tyre në dritë.

Dy fjalë për jetën e Hafëz Ibrahim ef. Dalliu

Hafëz Ibrahim Dalliu ishte një mendimtar i madh shqiptar, dijetar islam mendjendritur, pedagog i çmuar, atdhetar e patriot i dëshmuar. U lind më 1880 në Tiranë, kurse vdiq më 8 shkurt 1952. Familja e tij ishte nga familjet e njohura tiranase me traditë të hoxhallarëve. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, kurse të mesmen dhe të lartën i vazhdoi në Stamboll, duke iu bashkangjitur kështu vëllait të tij më të madh, haxhi Hysniut, i cili kishte kohë që ndiqte mësimet atje. Në Stamboll, hafëz Ibrahim do të vazhdojë të qëndrojë për pak kohë, sepse “familja e tij nuk kishte mundësi materiale sa të përballonte pagesën e dy bursave për dy djemtë e vet në dhë të huaj, prandaj hafëz Ibrahim u detyrua të kthehej në Tiranë dhe në medresenë e saj (të Tiranës) do t'i vazhdojë mësimet”- shkruan biografi i hafëz Dalliu dhe njëherazi shoku i burgut, Ibrahim Hasnaj (Hima)¹.

Që në fëmijëri hafëz Ibrahim u brumos dhe u edukua me ndjenjën e fetarit të sinqertë dhe të atdhedashësit të zjarrtë e të guximshëm. Me vullnet të fortë mësoi alfabetin shqip, kurse në moshën tetëmbëdhjetë vjeçare mori përsipër misionin e mësuesit, detyrë të cilën e kreu me shumë sukses. Pas daljes së Kushtetutës së re, në Tiranë u lejua që të funksiononin tri shkolla shqipe (dy fillore dhe një ruzhdije), kurse Hafëzi i nderuar u emërua për

1. Ibrahim Hasnaj (Hima), Hafëz Ibrahim Dalliu – jeta dhe vepra, “Dituria Islame” nr. 64-70, përgatitur nga Vehap Shita, botoi: Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës. Po ashtu: Hafëz Ibrahim Dalliu - jeta dhe vepra, (dorëshkrim) nga Ibrahim Hasnaj (Hima).

mësues dhe edukator në shkollën fillore të vajzave. Mirëpo, më vonë ftohet në Nënprefekturën e Tiranës, ku i kërcënohen dhe e urdhërojnë që të heqë dorë nga të mësuarit e shqipes, kurse ai me një krenari dhe kurajë burrërore do të refuzojë duke iu thënë: *“E drejta për të mësuar gjuhën time më është dhënë me Kushtetutë, prandaj nuk e kam ndërmend të heq dorë nga misioni im”*².

Në kohën e mbajtjes së Kongresit të Elbasanit, Hafëzi u caktua delegat nga Tirana, e kur u vendos hapja e Normales, ai u emërua një ndër mësuesit e saj të parë. Pas një viti pune, dhe meqenëse nëndrejtorit të saj Luigj Gurakuqit nuk i vajtën punët mbarë e mirë sa duhej, Hafëzi vendosi të japë dorëheqjen, mirëpo, pas insistimit me ngulm të shokëve të tij, u detyrua ta tërheqë dorëheqjen e tij.

Më pas, më 15 vjeshtë e dytë 1909, hafëz Ibrahim i boton një artikull tek organi **“Bashkimi i Kombit”**, që asokohe botohej në Manastir me emërtimin *“Nji qëndrim i çuditshëm”*, në të cilin demaskonte pa frikë atë pseudoliri e demokraci të trumbetuar me aq shumë bujë, i cili mjaftoi që ai t’iu nënshtrohej arrestimit dhe torturës. Pas disa ditësh, njëzet e dy të burgosur, në mesin e të cilëve edhe Hafëzi, i nisën në këmbë për në Elbasan, i nxorën para gjyqit ushtarak dhe i dënuan me nga dhjetë vjet burgim të rëndë, natyrisht, me arsyetim se kanë zhvilluar aktivitetet dhe propagandë patriotike. Hafëzi dënimin do ta vuante në Jedi-Kule të Selanikut së bashku me Beqir Lugën, Mahmud Fortuzin, Jusuf

Elezin e Mustafa Marën³. Mirëpo, për shkak të presioneve të shumanshme, protestave të rrepta, madje edhe në shtypin shqiptar të Bostonit, xhonturqit pas pak kohe morën vendim për lirim të tyre.

Hafëz Ibrahim pasi u kthye pranë familjes së tij në Tiranë, përsëri nuk ndeji duarlidhur, por vajti në Krujë dhe iu bashkua çetës së Sarisalltikut, e cila komandohej nga patrioti Abdi Toptani.

Edhe në ngjarjet e Nëntorit 1912, Hafëzi kishte rol flamurtar. Meqenëse ushtria serbe ishte në Lezhë dhe po marshonte në drejtim të Tiranës, ai thirri një mbledhje popullore me urgjencë në mëngjesin e 25 nëntorit në fushën e Namazgjahut, ku dhe u vendos që të nesërmen (pra, 26 nëntor 1912) të shpallej Pavarësia Kombëtare dhe të ngrihej flamuri. Edhe para dhe pas kësaj kohe, Hafëzi punoi edhe si imam, vaiz, hatib, por mbi të gjitha vazhdimisht u angazhua të shkruaj e të shkruaj, vepra këto të cilat edhe sot e kësaj dite tingëllojnë aktuale dhe janë të dobishme. Me këto detyra e veprimtari ai u bë një hoxhë i dashur dhe i nderuar në shkallë kombëtare, një propagandist i zjarrtë i fesë dhe i kulturës islame. Ligjëratat e tij ishin të përgatitura në mënyrë shembullore, me material të pasur, me fakte dhe argumente bindëse nga Kur’ani, hadithet, ngjarjet historike e shembuj nga jeta e përditshme, i nxitnin besimtarët për të zbatuar adhurimet fetare islame, për të qenë myslimanë të rregullt e të devotshëm⁴.

2. Patriotizma më Tiranë - H. I. Dalliu, Tiranë, 1930.

3. Si nën 1.

4. Faik Luli&Islam Dizdari, “Mevludet në gjuhën shqipe”, Shkodër, 2002, fq. 463.

Veprat e H. Ibrahim Dalliu

Hafëz Ibrahim Dalliu duke qenë një alim i devotshëm, mësues i palodhshëm, poet me forcë humoristiko-satirike, gazetar i guximshëm, njëri që ndër të parët hapi rrugën e satirës dhe humorit në letërsinë shqipe, pas vetes ka lënë, me sa dihet, këto vepra:

- *Texhvid i Kur'anit*- vepër origjinale e mbaruar.

- *Çasht islamizma*- vepër origjinale e mbaruar, botuar më 1935.

- *Libri i së falmes*- botimi i tretë më 1941.

- *Dhantië e Ramazanit*-

- *Patriotizma më Tiranë*- grimca historie, botuar më 1930.

- *Dokerrat e hinit*- poemë satirike.

- *Grenzat e kuqe*- poemë humoristike, botuar më 1918.

- *Triskat*- (dorëshkrim) poemë sarkastike.

- *Kreshniku i Atdheut*- vjersha patriotike, botuar më 1920.

- *E lemja e të madhit Pejgamber dhe jeta e Ati* (vepër origjinale).

- *Besimet e myslimanëve*- vepër origjinale, botuar më 1933.

- *Mësime teorike dhe praktike të moralit islam*- vepër origjinale 1939.

- *Ajka e kuptimeve të Kurani-Qerimit*- përkthim, vëll. i parë u botua më 1929.

- *Udha Muhammedane*- Tarikati Muhamedije, përkthim, 1936.

- *Hadithi-erbein* ose Dyzet hadithet, e para vepër e përkthyer e këtij lloji në shqip, 1940.⁵

Përveç veprave e përkthimeve të përmendura, Hafëzi ka botuar edhe te gazetatat e kohës, siç ishin “Xhoka”, “Dajti” etj. Madje, te kjo e fundit ka qenë edhe botues (pronar) dhe drejtor 5. Faik Kasollja te “Hëna e Re”, nr. 170, viti 2003.

përgjegjës, dhe jo rrallë herë nënshkruhej me pseudonimin “Mrrela” (një mizë e madhe që i thumbon kafshët), kurse te gazeta “Xhoka” nënshkruhej me pseudonimin “Bumalla”.

Krahas këtyre veprave dhe shkrimeve të rëndësishme hafëz Dalliu i kishte shtuar vetës edhe një detyrë shumë të rëndësishme; të shkruante edhe një vepër në fushë të jurisprudence islame, që, sikurse u tha, është përmendur më së paku - vepërën “*Libri i së falmes*”, vetë titulli i së cilës e çon lexuesin te falja e namazit.

“*Libri i së falmes*”, të cilin disponojmë, është, sikurse shkruan, botimi i tretë i vitit 1941 dhe është shtypur në shtypshkronjën “Tirana” në Tiranë. Përmbledh 112 faqe gjithsej.

Vepra “*Libri i së falmes*” është një kontribut intelektual mjaft serioz i autorit, në të cilën përmbledhen dispozitat e Sheriatit që kanë të bëjnë me dhe rreth faljes së namazit. Vepra hapet me parathënien. Në fillim jepen shpjegime të arsyeshme, të mjaftueshme se ç’është falja e namazit; kur është bërë farz falja e pesë kohëve të namazit; cilat janë dobitë shëndetësore të faljes etj, - për të vazhduar më pas për namazin dhe krejt ç’ka të bëjë me të në mënyrë të detajuar. Duke qenë se namazi është ibadet, të cilit i paraprinë pastërtia-abdesi, Dalliu sjell argumente logjike dhe shkencore, madje edhe të dijetarëve evropian, për dobitë shëndetësore të pastërtisë, të abdesit dhe të faljes së namazit. Sa për ilustrim lidhur me dobinë e dhënies mes’h kokës gjatë marrjes abdes, po sjellim një konstatim të hafëz Dalliu: “*Hiqmeti i së dhanmes mes’b kreës, asht tepër i madh; njeriu, me ç’do punë të merret, kur të marzitet e të lodhet bypset ta freskojë kokën për ta ndaluar sulmin e*

*gjakut në truët*⁶- konstaton autori. Autori vazhdon të sjellë argumente për dobite higjienike dhe shëndetësore me rastin e pastrimit të secilës pjesë të trupit me rastin e marrjes abdes, ose, - siç e quante ndryshe, - pastrimit të pjesërishëm. Gjithashtu, edhe për faljen e kohëve të namazit ai sjell edhe arsyeshmëri logjike. P.sh. për faljen e namazit të sabahut me kohë, hafëz Dalliu, thotë: *“Zotni! Si të mos jet i shëndosh ai që se ka zapë Dielli asnjëher njum, ai githmonë ngrihet para sabahit. Kjo punë asht e vërtetueme dhe ke Evropianet, të cilët kanë një proverb kështu: Në goft se bini heret dhe ngrihi para se lenë Dielli, fitoni shëndetin, pasuriën dhe gjendjen e mirë”*⁷.

Në vazhdim të veprës, autori në mënyrë të shkoqitur – e pjesën më të madhe ia kushton namazit – bën fjalë për faljen; kushtet, ruknet, synetet e namazit, për namazin e xhumasë, të bajramit, të vitrit, të teravisë, të udhëtarit, namazin kaza, namazin e xhenazes etj., për të përfunduar me një poezi – lutje pesëmbëdhjetë strofëshe kushtuar: *“Shpirtit të shejtnueshëm të Pejgamberit tonë”*.

E veçantë e kësaj vepre është se autori çdo dispozitë e ka argumentuar dhe e ka ilustruar me shembuj; shpjegimet i ka mjaft të qarta dhe për fillestarët mjaft të lehta dhe praktike.

Prandaj, ky doracak, kujtojmë, është një libër praktik shumë i përshtatshëm që besimtarëve do t’u ndihmonte shumë për faljen sipas rregullave të namazit. Aspak nuk është i ngarkuar me mendime të dy a të trefishuara të dijetarëve, por ai e zgjedh atë më kompetentin, më të qëndrueshmin, përfundimtarin (el-kaulurr rrxahih), dhe e vë në dispozicion.

6. “Libri i së falmes”, f. 13.

7. Po aty, f. 15.

Në gjysmën e parë të veprës *“Libri i së falmes”*, Hafëzi shënon edhe suret e Kur’anit nga sureja *“Ed-Duba”* deri te *“En-Nas”*, duke sjellë edhe domethënien e tyre, si dhe të gjitha duatë-lutjet dhe pjesë të tjera që nevojiten për t’u lexuar gjatë namazit, gjithnjë të transkriptuara në shkronja latine.

Mirëpo, ajo që transkriptimin e tyre e bën të veçantë dhe ndoshta të përdorur në këtë mënyrë për herë të parë ndër shqiptarët, është se ai tetë shkronjat karakteristike të gjuhës arabe që nuk janë në gjuhën shqipe i sjell të shënuara me shenja që nuk përdoren në gjuhën shqipe dhe i fut në përdorim, me të vetmin qëllim që lexuesi shqiptar t’i lexojë sa më saktë.⁸

Hafëz Ibrahim Dalliu, në veprën e tij *“Libri i së Falmës”*, mendojmë, është ndër të parët, që iu jep kuptimin e saktë e të plotë shumë terminëve që përdoren në terminologjinë e jurisprudence islame-fikhut, e sidomos rreth terminologjisë së të falmës - namazit. Për më tepër, vlerën e përkthimit të tyre që ne sot t’i kemi të gatshme, e rrit koha kur autori ka përkthyer, shqipëruar a adaptuar ato fjalë. Ai, p.sh., disa terminë i shqipëron kështu: *tavafi* - e sjellmja, *namazi* - e falmja, *iftitah tekberi* - tekberi i fillimit (çelmjes), *setri auret* – të mbuluemit, *eda* - e falme në kohë të saj, *kaza* - e falme pasi t’i kalojë koha, *kejjam* - qëndrimi në këmbë, *ruqu* – krrusje, *sexhde* - ulje, *kaadei ehire* – ndeja e mbrame, *sexhdei sehv* – ulja e gabimit, *sexhdei tilaveti* – ulja e këndimit etj.

Në anën tjetër, hafëzi i nderuar disa terminë nuk i përkthen fare, por i përdor në formën e tyre origjinale, siç është

8. “Libri i së Falmes”, f. 17-18, “Mënyra e së kënduemes arebisht me shkronjat t’ona”.

rasti me fjalët: *ruqnet e namazit, namazi i xhumaës, vitri, lutja e kunutit, vaxhib* etj., megjithëse edhe ato në brendi të temës i shpjegon gjerësisht. Duke qenë se e falmja e namazit është adhurim që veprohet, për të qenë më e kuptueshme për lexuesin dhe për ta pasur më lehtë që ta vejë atë në praktikë, I. Dalliu nuk mjafton vetëm me shpjegime teorike, por i shkoqit edhe me shembuj praktikë se si mund të veprohet gjatë faljes së namazit⁹, duke e shënuar kohën e së falmes, mënyrën e nijetit, ç'mund të lexohet në reqatin e parë e kështu me radhë, derisa jepet selam dhe kryhet namazi. Madje, edhe pas së falmes, ai i përshkruan lutjet të cilat e përcjellin atë, natyrisht arabisht të transkriptuara dhe me përkthimin e tyre.

Kur është fjala tek përkthimet duhet përmendur se ato i karakterizon një gjuhë e pastër, e qartë, dhe e pasur, ndonëse herë-herë, ai ato shprehje i sjell të adaptuara (shqipëruara).

Është e rëndësishme të theksohet se hafëz Dalliu, të gjitha normat e Sheriatit të shkruara në këtë broshurë - siç e quan ai,- janë të sistemuara sipas shkollës juridike hanefite. Kjo mbase është shumë e kuptueshme, sepse u dedikohet lexuesve të cilët kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë pasues të po asaj shkolle, pra të shkollës juridike hanefite.

Në fund edhe një veçori e hafëzimit të nderuar: Të gjitha veprat e tij fetare i shpërndante falas, pra edhe veprën "*Libri i së falmes*", dhe thotë: "Me suksesin e Perendiës m'u plotsue kjo dëshirë, shkrova diçka e po e botojë për t'a dhanë falas siç i kam dhanë edhe disa libra të tjera"¹⁰.

9. Ibid. f. 80 – 81.

10. Ibid, f. 3 tek "Nja dyë fjalë".

Gjithashtu, përmes librave të tij fetarë në viset jashtë Shqipërisë administrative, ai synonte ngritjen e vetëdijes fetare të shqiptarëve dhe njëkohësisht që ata të kenë mundësi ta mësojnë gjuhën e tyre shqipe. Për t'i dërguar librat në Kosovë, ai fillimisht i dërgonte në Ambasadën Shqiptare në Beograd me rekomandim që të njëjtat të përcilleshin për në Kosovë, natyrisht të gjitha falas.

Ambasadori i Shqipërisë në Beograd, zotëri Rauf Fico, në kujtimet e veta shkruan:

"Kur hafëz Ibrahim Dalliu nxirrte nga shtypi ndonjë përkthim a vepër origjinale fetare, dërgonte në Ambasadën Shqiptare të Beogradit një sasi të konsiderueshme ekzemplarësh për t'i shpërndarë gratis ndër viset e robnueme të Kosovës. Kështu që, duke lexue librat fetare të Hafëzimit, ata zhvillonin njëkohsisht edhe gjuhën amtare"¹¹.

Duke e përmbyllur këtë vështrim do të theksojmë se në veprën "*Libri i së falmes*", hafëz Ibrahim Dalliu, nuk ka lënë pa prekur asgjë të rëndësishme dhe të domosdoshme e që ka të bëjë me faljen e namazit.

Pikëpamjet e Dalliu për faljen e namazit mund të kuptohen të plota, sidomos pasi të lexohet vepra në tërësi. Prej saj do të nxirren mësimet e shumta edhe sot e kësaj dite.

Prandaj, të shpresojmë dhe të lutemi se një ditë "*Libri i së falmes*" i hafëz Ibrahim Dalliu do të ribotohet. Ribotimi eventual i kësaj vepre, tani me një redakturë gjuhësore të kohës së sotme, më shumë i bën nder botuesit se sa vet autorit, kurse myslimanët do të përfitonin shumë nga ajo.

11. Dituria Islame nr. 64-70.

Burimet kryesore:

- Hafëz I. Dalliu, *“Libri i së Falmës”* botimi i tretë, Tiranë, 1941.
- Ibrahim Hasnaj (Hima), *“Hafëz Ibrahim Dalliu-jeta dhe vepra”* te *“Dituria Islame”* nr. 64-70, përgatitur nga Vehap Shita, Prishtinë.
- H. I. Dalliu, *“Patriotizma më Tiranë”*, Tiranë, 1930.
- Gazmend Shpuza, *“Vëprat e Hafëz Ibrahim Dalliu”* te *“Perla”*, nr. 2-3, Tiranë, 1999.
- Faik Luli- Islam Dizdari, *Mevludet në gjuhën shqipe*, Shkodër, 2002.
- Ibrahim Hasnaj (Hima), *Hafëz Ibrahim Dalliu (dorëshkrim)*.
- Faik Kasollja, *Hafëz Ibrahim Dalliu, “Hëna e Re” nr. 170, v. 2003.*
- Dr. Ramiz Zekaj, *“Zhvillimi i kulturës islame te shqiptarët gjatë shek. XX”*, Tiranë, 1997.

Hafiz Ibrahim Dalliu (1878-1952)



Hafiz Ibrahim Dalliu, lindi më 1878 në një familje fetare, ku u edukua në frymën fetare të familjes dhe duke ndjekur këtë rrugë vendosi të studionte në Stamboll. Gjatë studimeve, Ibrahim i në frymën islame u aktivizua për çështjen kombëtare shqiptare. Ai ishte teolog, përkthyes, poet, publicist, mësues dhe aktivist shqiptar.

Në këtë drejtim Dalliu, mendonte se funksionarët e Xhamisë dhe të gjithë

besimtarët myslimanë kishin nevojë të menjëhershme për literaturë fetare në gjuhën shqipe, prandaj sapo u kthye në atdhe, mori përsipër detyrën e mësuesit në një nga shkollat e para të Tiranës (1901), së bashku me Filip Ashikun dhe Hoxhë Voglin, me gjithë vështirësitë e shumta e pa u shkëputur nga detyra e imamit në faltoret e qytetit.

Më 1908 ai hapi shkollën e vajzave në Tiranë, ku u përgatitën mësueset e para vajza myslimane, si Servete Maçi etj.

Në formimin me ndjenja patriotike tek Dalliu ndikoi bashkëpunimi me atdhetarë shqiptarë. Në librin e tij «Patriotizma në Tiranë», autori ka përmendur mbi 150 burra aktivistë e veprimtarë të vendosur të kombit. Këta qenë motivet që Hafiz Dalliu u zgjodh delegat i Tiranës në Kongresin e Elbasanit më 1909, ku u vendos hapja e Shkollës Normale (e para shkollë e mesme pedagogjike në gjuhën shqipe në Shqipëri) e ku Dalliu u emërua mësues i kësaj shkolle të re ku Aleksandër Xhuvani shkruan, ndër të tjera, që Normalja ka ne themelin e saj djersën dhe kontributin e Hafiz Ibrahim Dalliu. Mirëpo këto bindje e qëndrime «heretike» të njeriu të përkushtuar e



çuan Hafiz Dalliu në burgje mizore deri në dënim dhe përndjekje. U desh ndërhyrja e miqve dhe e shokëve si Hasan Prishtina, Mihal Grameno etj, që e detyruan gjykatën ta lironin.

Pas vitit 1912 Hafiz Ibrahim Dalliu iu kushtua publicistikës dhe letërsisë satirike. Më vonë drejtoi gazetën politike «Dajti». Duke nisur nga viti 1918 deri më 1924 botoi një varg veprash satirike, duke u bërë kështu ndër të parët poetë satirikë që çanë rrugën e humorit në letërsinë shqipe. Këto vepra janë «Grenxat e kuqe» (1918), «Dokrat e hinit» (1920), «Kabineti i Xhafer Ypit» (1922) etj. Shkroi gjithashtu edhe librin me vjersha patriotike «Kreshniku i atdheut», si dhe monografinë «Patriotizma në Tiranë» (1930). Por njohjen si poet ai e fitoi me elegjinë kushtuar Avni Rustemit, kurse popullaritetin e fitoi nga qëndrimi i tij

stoik kundër torturave që atij i bënë pushtuesit e Shqipërisë.

Burrëria dhe heroizmi i Dalliu vihet në dukje dhe në një nga këngët e «Lahutës së Malësisë», ku poeti Gjergj Fishta mbi të tjera shkruan: “a isht’ «Shqiptar» apo «Osmanli», u përgjegji me trimëni: jam shqiptar me gjuhë e fis.”

Hafiz Ibrahim Dalliu ishte një ndër mbështetësit konseguentë të lëvizjeve demokratike të viteve 1920-1924. Vrasja e Avni Rustemi e brengosi pa masë. Por ai gjeti forca dhe i thuri këtij martiri të shquar, një këngë e cila gjeti jehonë jo vetëm në Shqipërinë e Mesme, por në mbarë viset shqiptare.

Hafiz Ibrahim Dalliu u përdoq nga disa regjime dhe në fund edhe nga regjimi komunist. Ai njohu qelitë e burgut të Manastirit, Selanikut, Tiranës. Herën e fundit e akuzuan për botimin e poemës «Grenxat e kuqe», se ka sulmuar pansllavizmin. Por karakteri shumë i fortë, besimi në islam e ushqente atë për të mbrojtur të drejtën dhe lirinë. Kështu e gjithë jeta e Dalliu, është e ngjeshur me ndjekje policore si pasojë e veprimeve të tij kundrejt padrejtësitë dhe veprimeve për mbrojtjen e interesave të Shqipërisë.

Pas Luftës II Botërore u emërua mësues në Medresenë e Përgjithshme të Tiranës për lëndët e Besimit Islam.

Vendosja e diktaturës së shtetit monist cenonte interesat e të gjitha shtresave dhe të drejtat e masave popullore, prandaj Hafiz Dalliu nuk mund të pajtohej me regjimin ateist, komunist e diktatorial dhe pikëpamjet e tij i shprehte hapur qoftë edhe përpara nxënësve gjatë orës së mësimi. Ai nuk mund ta mendonte shtetin të tillë që merr nëpër këmbë të drejtat më

elementare të qytetarëve, ndërgjegjen dhe bindjet e tyre fetare. Është thënë se atje ku ishin ngjarjet e mëdha të vendit, atje gjendej dhe Hafiz Dalliu. Vetë Hafiz Dalliu thoshte: «...Përderisa në vendin tonë do të dominojnë e do të administrojnë njerëz që nuk kanë menduar në të mirë të Atdheut, unë do të jem në opozitë...» kështu diktatura komuniste e arrestoi dhe e burgosi, duke e torturuar pa asnjë argument ligjor; pas disa muaj mundimesh në duart e persekutorëve nëpër qelitë e burgut, e liruan për mungesë faktesh dhe del nga burgu i sëmurë, i dobësuar sa nuk qëndronte dot në këmbë dhe për pasojë vdes në shkurt te vitin 1952.

Ai nuk kurseu as pasurinë, as fuqitë fizike e as intelektin e tij me atë horizont të gjerë kulturor në të mirë të Islamit, në të mirë të Shqipërisë. H. Ibrahim Dalliu ishte i bindur se pa një shtet të stabilizuar, të qetë, të pasur e të sigurtë njeriu nuk mund të ushtrojë besimin fetar. Tek ai gjejmë të ngjizura në një ekuacion faktorët e binomit FE - ATDHE si zgjidhja më e mirë dhe e garantuar, ku asnjëra nga të dy kufizat nuk qëndron dot pa tjetrën.

Shkrirja në një front të vetëm të përpjekjeve për përparimin dhe konsolidimin e Islamit me luftën për çështjen kombëtare, pa zvogëluar rëndësinë e njërës në kurriz të, në këta motive konsistonte sekretin i mundit plot vetmohim i Hafiz Ibrahim Dalliu, mishërim i binomit «Fe-Atdhe» që bashkëjetojnë në të njëjtën kohë e vend e asnjëra nuk e përjashton tjetrën. Faik Konica ka thënë: «Të mos ishte islami, populli shqiptar do të ishte shume me tepër në numër por jo shqiptar».

Hafiz Dalliu me shkrimet e tij u përpoq që të hapte shtigje drite në mendjet e në ndërgjegjen e bashkatdhetarëve, në atë periudhë tranzicioni dhe tepër kritike të historisë së kombit shqiptar të mbetur pa përkrahje e pa mbrojtje, mes armiqsh të shumtë e të pangopur. Të flasësh për Hafiz Dalliu nuk është asnjëherë e tepërt, porse për të njohur më mirë këtë figurë madhore islame, këtë luftëtar trim të shqiptarizmes, këtë poet gojëmjaltë të vargut shqip, gjithsecili në mënyrën e vet do të arrijë vetëm duke njohur shkrimet e këtij mësuesi veteran. Për këtë qëllim po sjellim fare shkurt subjektet e disa prej veprave të tij fetare e letraro-patriotike:

1. «Libri i së Falmes», tregon rregullat kryesore të të gjitha namazeve ditore e periodike, dispozitat kur'anore në lidhje me këtë shtyllë të Islamit. Aty janë përfshirë pjesët kur'anore që mund të shërbejnë gjatë faljeve dhe lutjet e rastit në arabisht e të transkriptuara dhe të përkthyer në shqip. Libri është shpërndarë falas; ai ka ndihmuar për shumë kohë besimtarët myslimanë që të falen, të kryejnë këtë detyrë, të obliguar për çdo individ.

2. «Dhanti e Ramazanit», përmban rregullat e agjërimit, si e kur lejohet që të mos agjërohet, kur ndërpritet agjërimi dhe si konsiderohet agjërimi i prishur etj. Autori ka parashtruar në këtë libër edhe dobitë fiziologjike, rëndësinë e edukimit moral nëpërmjet agjërimit dhe vlerën shoqërore të tij.

3. Ilahija «Një lutje shpirtit të madhnueshëm të Resulull-llahit», botuar shumë herët, është hymn fetar i frymëzuar për dashurinë që ka

muslimani për Profetin e tij dhe për Islamin.

4. Te libri «Patriotizma në Tiranë», autori ka marrë në analizë zhvillimet e shoqërisë shqiptare dhe pjesëmarrjen e atdhetarëve të Tiranës në veprimtari patriotike, para e pas shpalljes së Pavarësisë Kombëtare, e përhapur kjo lëvizje edhe në qytete të tjera të vendit. «Patriotizma...» është një vepër dokumentare e papërsëritshme e këtij dëshmitari okular, siç ishte vetë Hafizi, pjesëmarrës aktiv i vijës së parë në veprimtaritë e kohës.

5. Poema satirike «Dokrrat e Hinit» vë në lojë ata njerëz që nuk i sjellin asnjë dobi atdheut dhe e kalojnë kohën nëpër lokale kafenesh me biseda të padobishme. Ai i ironizon pseudointelektualët që i përdorin fjalët e huaja vend e pa vend. Sidoqoftë kryevepra e Hafiz Dalliut është vepra «E lemja dhe jeta e të madhit Muhamed a.s.», vepër origjinale në vargje (6143 vargje), po nuk bie më poshtë edhe Tefsiri i Kur'anit i titulluar «Ajka e kuptimeve të Kur'ani Qerimit» përkthyer prej vetë Dalliut.

Vlen të përmendet edhe kontributi i tij i paçmuar gjatë viteve '30 për botimet e shumta që bëri në shërbim të edukimit

fetar. Numërohen gjithsej 15 vepra, përkthime, por shumica origjinale. Ndër të gjitha këto shquan «Tefsiri shqip i Kur'anit» në dy vëllime, përkthyer nga arabishtja.

Libra të tjerë me karakter fetar janë: «Udha muhamedane» (vepër afër 500 faqesh), botuar në Tiranë më 1936, «Mësime teorike dhe praktike të besimit islam», Tiranë, 1935 etj. Ai ishte gjithashtu anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë.

Kontributin e Hafiz Ibrahim Dalliut në dobi të të gjithë botës islame shqiptare e kanë patur parasysh edhe shqiptarët e të gjitha trojeve etnike, të cilët e kanë botuar dhe ribotuar të plotë të gjithë veprën e Hafiz Dalliut. Një studim me rëndësi për jetën e Hafiz Dalliut ka bërë edhe Doc. Sinan Tafaj, si dhe z. Xhemal Balla.

Dihet edhe një gjë tjetër që emri i mirë që ka gëzuar dhe gëzon në popull, janë munduar që ta eklipsojnë elitat dhe është lënë në harresë prej tyre, siç konstaton edhe z. Aurrel Plasari: «...Ka qenë prirje që figurën e Hafiz Ibrahim Dalliut për ta lënë jashtë, për ta lënë në harresë, për mos ta dashur...»

Abstracts in English

On the occasion of “ZANI I NALTË”
magazine 90-th anniversary

“Zani i Nalte” magazine thematic – 1923-1939
By Ali Musa Basha

Abstract

The 20 century is considered as the regular start of the Albanian periodical Islamic press. We can trace its existence from the beginning of the new Albanian State foundation and it can be said that it got the physiognomy and was institutionalized since the foundation of the Albanian Muslim community. From the beginnings of its foundation, by having under its command the educational and religious institutions from one part, and by being found in front of the demands of intellectual organizations, and of the Muslim preachers by the other part, this community along with the publishing of religious literature, that served for the qualification of religious staff, saw as a necessity the publishing of a proper religious magazine, that would be a tribune of the Albanian Muslim thinking and the center of the Muslim press, not only in Albania but especially during the first years, in other countries where the Albanian Muslims would be found too. This necessity turned into an immediate duty by the decisions of the first Muslim Conference held at February, 1923 and in this way, at October of that year the first number of “Zani i Naltë” magazine was published, a process that continued until the beginning of 1939, i.e. approximately 16 years.

“Zani i Naltë” on the problems of education

Prof. Dr. Vehbi Hoti
“Luigj Gurakuqi”, University, Shkodra

Abstract

“Zani i Naltë” magazine being at the same time the magazine that dealt with philosophy, morality, national literature and sociology, was entirely dedicated to the educational problems.

Initially by a few pages, narrow in problems dealing, the magazine gradually, especially in the years 30, was consolidated; it opens some long-term rubrics where were discussed the most fundamental principles of the Islamic faith, of the philosophy of that time and of the people’s education and character formation.

In many articles and rubrics such as:” What orders the Qur’an” and “The core of Qur’an,” “The messages of Prophet Mohammad” and “How did Muslimanism started?”, “The God’s light and philosophy” and “Idealism and materialism” etc, there were discussed the most fundamental problems of religious education and the general principles of the human character formation and education.

Studies

The religion seen by an intellectual

Prof. Dr. Bedri Bylyku

Abstract

The intellectual is not defined to be only a specialist or a master in its job, but it is perfectly created and endowed by guidance in order to solve the problems of this chaotic world, especially in his country by starting from his family, his relatives, the region and the place where he was born and where he will die.

But actually the man in today’s era, in the major part is dealing with himself and with his future. For this scope, he undergoes some social obligations in spite of community’s solidarity. The experience confirms that by time passing this human being is transformed into an insulated Narcise.

The modern man has experienced both liberalistic principles, individualism and pluralism that were naturally included into the Religious idea construction. Everyone who want to analyze the religious events, will be faced with a turmoil of authoritarianism and individualism inside the plurality both religiously and by means of several fractions and groups activity. For this reason, today the religion in many cases has become the mask of the non religious stances and movements. The non-religious movements have a big variety. Furthermore the scientific data

and technology from one part and the traditional mythology from the other, caused it to lose the sensitivity and its time and space actuality, because religion can be understood only through the religiosity and religion, so both the subject and object should be religious, that means the subject should experience the religiosity. The non-religious subject kills or strangles the religious object that it studies.

The religion's apologetic and juridical discussions have become disciplines that today are considered as memories. Then should it be known the essence of the religion so do we need it?

The ulema's role in political and social course during the independence proclamation period.

**Prof. Dr. Assc. Fahrush Rexhepi
Islamic studies department- Prishtinë**

Abstract

The Albanian people history is outstanding not only for its anxiety, but it also represents its life and development, its difficulties through which it has been obligated to undergo during these centuries. There are the dangers that Albanians people has surpassed in their war to protect themselves and to make progress in the path of progress; there are the great material and cultural works our people's best sons have created and have left as a heritage to their offsprings.

The contribution of religion and of the Albanian ulema in the historical, cultural and political processes of the Albania and Albanian nation, will be better understood only after having a clear view of the social, political, religious and educational reality in Albanian lands during certain periods of their territory occupation.

**Make up your mind:
Either an athlete of Christ, or a national hero?**

**M.S. Fatos Koplaku
Michigan University, Ann Arbor USA**

Abstract

The provincial has no right to and it cannot take the role of the universal, nor the universal cannot be imprisoned into regionalism without being vulgarized; the nationalist ideologies, or whatever they may be, cannot replace religion, and nor should the latter be instrumentalized for puny interests that appertain to the time-space cage.

Islamic Science

Qur'anic letters and their pronunciation

M.A. Elton Karaj

Abstract

Tajwid is the science that deals and analyze in details the reading of Qur'an, the Holy Book letters. It is one of the most deeply analyzed and elaborated sciences over the centuries, due to its importance. The reading of Qur'an is one of the fundamental aspects of a Muslim worship and furthermore, it is a worship act in itself. By this viewpoint, believers have shown a great attention in the teoretical studies and for the practical application of the knowledge that tajwid science offers.

Islam as a religion of the universal mercy

Muhammed Fethullah Gulen

Abstract

Some “natural” phenomenon or spiritual concussions initially can be considered as unkind, but we shouldn't judge them as events that don't are compactible with the mercy. They are like dark clouds or lightnings and thunders which although are fearful, bring the good news of raining to us. So all the universe praise the All-Merciful.

The violence inside the family: A paralyzing phenomenon for the Albanian family and society.

Sociology

The violence inside the family: A paralyzing phenomenon for the Albanian family and society

Doc. Ana Uka (Bulku)
BEDER University, Tirana

Abstract

The violence inside the family, is one of the most widespread phenomenon and one of the most reported crimes of the Albanian society, and this makes impossible

an accurate measurement of such a phenomenon. The violence inside the family has been mostly approached as an individual problem, which belongs only to the family members and not the entire society. It is both a state and an individual responsibility to undertake effective provisions in order to protect women and children and to stop the violence. Statistics report that only 5% of the abused women inform the violence. Studies show the violence inside the family, especially at the expense of women and girls is increased during the transition years. This complicated issue by roots in the mate relationships, has a negative impact in parental process too. The women who are victims of violence inside the family, usually experience great difficulties in concentration and to work efficiently with their children; they are more inclined to avoid or to deny the situation and they neglect the impact of violence on them or their children. It is necessary a national strategy to ensure that all types of violence inside the families to be identified, its effect to be addressed and various social politics and programs of intervention to be implemented, in order to prevent all consequences that can damage the family and the entire Albanian society.

...visit the sick people,...

Ilir Akshija, M.D., M.Sc.

Abstrakt

Everyone of us when sick, is found between the fears about the disease prognosis and the hope for healing and upturn. In such a difficult situation, the payment for benefitting the best sanitary service, still remains one of the main pillars that contribute in the final result. The duties and the rights in relation to the sanitary system, nowadays are consolidated and despite their change continually, this metamorphosis is made on a previous ground. The sanitary financing at a system level are a new concept, whereas the religious communities and especially Islam, share their stance about this major issue. Our duty remains the analyzing, conclusions drawing and the right application of all that Qur'an and Sunna have offered as a solution for us. At different times live different people and together with them, there exist also different perspectives, and namely in this context, the prophetic phrase on "visiting the sick people" should be viewed in the context of the contemporary situation, in addition to the traditional view. The article takes over to place the sick Muslim and the Muslim society in the context of the contractual situation they have with the state about health issues and the opportunities offered by their affiliation to Islam.

Native Language & Literature

The Albanian language and statehood in the Muslim Scholar works

**Doc. Dr. Ismet Osmani - “Saint Cyril and Metodi”
University, Skopje**

Abstract

The contribution of the Albanian Islamic scholars in field of Albanian language and its statehood represent an interesting field of study that has attired the attention and has been a subject of research and stuies by many scholars over the years. Such an attempt of the Islamic scholars marks the beginning of a major reform in national culture raising and the propagation of Islamic culture in the native language. In addition, the Islamic scholars, work always for our nation and country political progress.

History

The religious institutions during the reign of King Zog: An overview on the era legislation (1928-1939)

Prof. Dr. Valentina Duka – Tirana University

Abstract

The most tangible success of King Zogu, a success that we, the Albanian historians didn't dare to note during the communist ruling, was the political stability insurance in our country. He was smart enough to understand that for his state building, there was not enough to merely copy state models that could have been applied elsewhere, without taking into account the political reality in his country. King Zogu eventually created a political system by combining eastern with western ideas, because this type of state, assured the necessary centralization, in order to govern the problematic Albanian political elite.

On the Albanian history review and re-writing

Nuredin Nazarko

Abstract

The Albanian people attention recall on a different interpretation of the Albania history, should be attained on basis of a closer interaction between the history review and re-writing, not only for certain historical periods, but through a review and re-writing in details of all the historical developments structure, far from the influence

of dialectic materialism interpretation and definitively subjected by honesty to the truth and the scope of a careful research until its realization, or at least to accept the non-realization of this scope, if it cannot be reached. This process should not serve as a cancellation and veiling instrument of the distortions and one dimensional deformations of interpretation, otherwise it would veil the truth of fraud that we have experienced and still experience, by means of the untouchability of the one dimensional and ideological spirit exclusivity in the creation and publishing of the standardized history...

Personalities

Hafiz Ibrahim Dalliu and his contribution in Islamic jurisprudence (With a special view on his work “The Book of Prayer”)

H. Resul Rexhepi - Muslim Community of Kosovo

Abstract

To write about Hafiz Ibrahim efendi Dalliu and his contribution in the field of Islamic jurisprudence and in other scientific branches, is not only an eligible duty, but a complex and a difficult one. This because hafiz Ibrahim Dalliu is an outstanding personality of our culture, who through his broad and multiple work, gave a great contribution to the Albanian culture and scientific thinking raise. This granted to him an eternal deserved place in our cultural history.

H. Ibrahim Dalliu, one of the 100 outstanding personalities of the Albanian culture

Abstract

Hafiz Ibrahim Dalliu was born in 1878 at a religious family, where he was educated according to the religious spirit, and by following this way, he decided to attend the studies at Istanbul. During the school period, Ibrahim, endowed by this Islamic spirit was engaged in the Albanian national issue propagation. He was an Albanian preacher, interpreter, poet, publicist, teacher and activist.

In this regard, Dalliu thought the mosque officials and every Muslim had an urgent need for religious literature in Albanian language, so immediately after he turn home, he took on the task of the teacher in one of the first schools of Tirana (1901), along with Filip Ashiku and Hoxhe Vogli, regardless the enormous difficulties, and without leaving the duty of imam in the city's mosques.

In 1908 he established the girls school in Tirana, where the first Muslim-girl teachers such as Servete Maçi etc., were prepared.

Rregullat e shkrimit

Artikulli duhet të prezantojë një punë studimore, kërkimore, shkencore dhe të evidentojë elementë të qartë të origjinalitetit.

Çdo shkrim duhet të ketë një strukturë, që duhet të përmbajë në mënyrë të detyrueshme elementët e mëposhtëm:

1. Titulli i artikullit të jetë sintezë e problematikës që ai trajton, i organizuar në mënyrë koncize dhe të përmbledhur. Titulli të mos jetë më i gjatë se 35 karaktere.

2. Të vendoset emri i autorit me titujt shkencorë përkatës dhe poshtë emrit të jepet pozicioni zyrtar i tij/saj.

3. Poshtë këtyre, në krye të shkrimit me një paragraf të veçantë mund të jepet një abstrakt i shkurtër, duke radhitur të gjitha nënçështjet.

4. Artikulli duhet të jetë i strukturuar me disa nënçështje në varësi të tematikës që shtron.

5. Nënçështja e parë e çdo artikulli duhet të jetë “Hyrja”, në të cilën të jepet qëllimi dhe objektivat, që e kanë shtyrë autorin për të shkruar artikullin dhe rëndësia e botimit të tij.

6. Të gjithë titujt e nënçështjeve të jenë me “Bold” dhe shkrim “Italik”, “Times New Roman 12”. Datat të shkruhen sipas modelit: Data – Muaji – Viti, titujt e nënçështjeve do të paraprihen nga numrat 1, 2, 3, etj.

7. Në fund të artikullit duhet të vendoset një nënçështje e posaçme me titull: Sugjerimet apo Konkluzionet.

8. Çdo artikull duhet të ketë të evidentuar edhe Bibliografinë. Çdo artikull duhet të ketë të paktën 10 referenca dhe vepra.

9. Çdo artikull duhet të ketë footnote-a dhe referenca për çdo material dhe autor që ka studiuar dhe referuar duhet vendosur në formë citati, në thonjëza, shprehjet e marra ekzaktësisht nga materialet e tjera të botuara më parë.

10. Footnote-a duhet të shkruhet me shkrim “Times New Roman 10” dhe të përmbajë, autorin, titullin e veprës, shtëpinë botuese, datën dhe vendin e botimit, faqen nga është marrë citati.

11. Nëse autori është konsultuar me një site interneti duhet të shënohet edhe data e aksesueshmërisë: p.sh. akses më 10 Maj 2008. Në fund të footnote-s vendoset pikë dhe footnote-a jepet me «Justify».

12. Artikulli duhet të jetë jo më pak se 5 faqe dhe jo më shumë se 15 faqe kompjuterike.

13. Shkrimi i artikullit duhet të jetë “Times New Roman” me “Spacio 1” dhe i gjithë teksti të jetë “Justified”. Artikulli duhet të respektojë elementët gramatikorë dhe gjuhësorë dhe të jetë i shkruar me “ë” dhe “ç”.